

# THE USE OF STANDARD ALBANIAN IN THE SCHOOL AND UNIVERSITY TEXT-BOOKS PËRDORIMI I STANDARDIT TË SHQIPES NË TEKSTET MËSIMORE SHKOLLORE DHE UNIVERSITARE

**SHPRESA HOXHA**

Fakulteti Ekonomik

Universiteti i Prishtinës

Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

[shpprreessaa@hotmail.com](mailto:shpprreessaa@hotmail.com); [shpresa.hoxha@uni-pr.edu](mailto:shpresa.hoxha@uni-pr.edu)

## **Përmbledhje**

Përdorimi i standardit të shqipes në tekstet tona shkollore dhe universitare nuk është në nivelin e duhur dhe të kërkuar. Vërehen shpërfillje të standardit të gjuhës me gabime nga më të ndryshme, duke filluar nga ato ortografike, teknike, të rendit të fjalëve në fjali dhe madje edhe të atyre kuptimore dhe përmbajtjesore. E për gjithë këto përgjegjës nuk janë vetëm autorët e teksteve por edhe lektorët, redaktorët dhe recensentët e këtyre teksteve, të cilët lejojnë që këto tekste të botohen si të tilla. Me mbrojtjen e standardit të shqipes do të duhej të merremi më seriozisht dhe ka nevojë për një trajtim dhe përfillje të duhur. Rregullat e hartimit të teksteve duhet të jenë në pajtim me ato gjuhësore, kuptohet dhe me përmbajtje pozitive. Gjuha standarde në institucionet publike përbën, pa asnjë dyshim, një interes të përgjithshëm të shoqërisë, pra të kombit. Prandaj, përdorimi i saj në institucionet publike do të duhej të rregullohej me ligj ose me ndonjë akt tjetër nënligjor.

**Fjalë çelës:** Përdorimi i standardit, gjuha shqipe, tekstet mësimore.

## **Summary**

The use of Standard Albanian in our school and university text-books is not in the necessary and appropriate level. There is noticed a negligence of the standard with different mistakes, starting from orthographic, technical, word order and even semantic and those of content. And for all these mistakes the responsibility is not only at the authors but as well as at the editorial staff and reviewers who allow those texts to be published like that. We have to deal more seriously with the protection of the Albanian standard and there is a need for an adequate treatment. The rules of the text compiling must be in accordance to the language rules and having positive content. The standard of language in public institutions is in the interest of the society - nation. So, the use of it in the respective institutions must be regulated by law or by any other legitimate act.

**Key-words:** The use of standard, Albanian, text-books.

## **Hyrje**

Përdorimi i standardit të shqipes kohëve të fundit është nëpërkëmbur pak a shumë me një mospërfillje nga hartuesit e teksteve mësimore, si në ato shkollore ashtu edhe në tekstet universitare. Gjuha, thotë Sami Frashëri, është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut. Përveçse mjet themelor komunikimi i shoqërisë njerëzore, ajo është dhe shenja kryesore në bazë të së cilës etnitë e kombet dallohen nga njëri tjetri. [1: faqe 9.]

### **Mënyra e përgatitjes së teksteve shkollore**

Tek ne, në botimet e reja të teksteve ndeshim shpërfillje të standardit të shqipes, përkatësisht gjuhës së shkruar, përdorimi i së cilës do të duhej të ishte shembull për të gjithë. Më herët botimet e teksteve shkollore dhe universitare në vendin tonë janë mbikëqyrur, lekturuar e redaktuar më me kujdes dhe atyre që i kanë përdorur iu kanë shërbyer si model shkrimi dhe mësimi se si shkruhet një fjalë ose edhe fjalia. Ndërsa, sot edhe nxënësit e shkollave fillore mund të gjejnë dhe të dallojnë gabime ortografike dhe teknike në librat shkollorë.

Me rastin e botimit të teksteve të ndryshme, autorët në rend të parë, e më pastaj edhe lektorët,

redaktorët dhe recensentët, do të duhej të jenë më të vëmendshëm në hartimin, në korrigjimin e tyre dhe në evitimin me kohë të lëshimeve e të gabimeve të numërta gjuhësore.

Ka botime të shumta, të hartuara pa kritere të duhura ose edhe pa mbikëqyrje institucionale, duke e shfrytëzuar një liri të botimit, në veçanti në periudhën e pasluftës në Kosovë. E mbroj me këmbëngulje mendimin se duhet respektuar me rigorozitet standardi në hartimin dhe shkrimin e teksteve shkollore dhe universitare.

Po ashtu në mesin e librave shkollorë ndeshim tekste diskriminuese. Ka njësi që mësojnë keq, mësimë ku shprehet qartazi pabarazia gjinore si **“djali është djalë”** pra, favorizim i gjinisë mashkullore dhe diskriminim i asaj femërore.

Sipas ligjit diskriminimi nuk është i lejuar apo më mirë të thuhet është i ndaluar. Në këto raste pjesa e fajit dhe e përgjegjësisë bie edhe tek recensentët e papërgjegjshëm dhe lejimi i botimit të tekstit shkollor apo universitar pa një kontroll të mirëfilltë. Gabime të tilla hasim te teksti shkollor i klasës së katërt, libri i leximit: **“Leximi 4”** i Xh. Sylës, çështje, që u diskutua edhe në media. Gabimet me

përmbajtje të tilla kanë peshë më të madhe dhe rëndojnë më tepër sesa ato ortografike dhe teknike. Tek të vegjlit dhe të rinjtë janë shembull i keq dhe udhëzues negativ, rrugë për të krijuar përshtypje ofenduese ndaj gjinisë së kundërt.

Sa i përket zanores – ë –, tani më pothuajse “jemi mësuar” ta shohim shpeshherë të zëvendësuar me – e – përmes kompjuterit, duke e anashkuar përdorimin e saj të drejtë e edhe mundësinë e vendosjes së saj në tastierë si edhe të shkronjës – ç, e cila jo rrallë shpërfillet gjithashtu.

Ja disa shembuj të nxjerrë nga disa tekste, sa për ilustrim: Për të mos lejuar deshtimin e reformave, ... (F. Rexhepi, F. Demaj, Historia 6, Prishtinë 2014, 61.); ... flinte sikur të gjithë fëmijet e tjerë; perkrenare; ...shpertheu konflikti (Po aty, 61, 63, 74), në vend se të shkruhen: dështimin, fëmijët, përkrenare, shpertheu etj.

Shpërfillja e zanores ë vërehet edhe në titull të librit të leximit: IDEJA E VEPRES LETRARE (R. Petro, Xh. Sylja, Leximi letrar 6, Prishtinë 2014, 13).

...që përbëhen prej lëndësh të ndryshme.

... që përbëhen prej lëndës së njejtë.

... molekulat e lëndëve. (Grup autorësh, Fizika për klasën e VI, Pejë 2014, 10,11,13). Për: veprës, lëndësh, njëjtë dhe lëndëve.

Duhet cekur se edhe në tekstet universitare, sikur është bërë e zakonshme, nuk përdoret me rregull ose harrohet padashur dhe nuk kontrollohet sa duhet vendosja e shkronjës – ë, as nga autorët dhe as nga lektorët. Ja disa shembuj të tillë:

Pakti i stabilitetit si mekanizem... .Për: mekanizëm. (G. Qorraj, Integrimi Evropian dhe Kosova, Prishtinë, 15.)

Aspekt i rëndësishëm ... .Për: i rëndësishëm.

... i mundësojnë përfitime... . Për: i mundësojnë

Me këte mendohet... . Për: këtë.

... duhet te unifikojmë... . Për: të. (Po aty, 16).

Madje e ndeshim edhe në përdorim jo me vend dhe të panevojshëm të shkronjës ë si: Në vitin 63 para Krishtit pritej ardhja e mësisë (shpëtimtarit). Për: Mesisë.

... të cilët e konsideronin si shpëtimtarë. Emri shpëtimtarë do të duhej të shkruhej në njëjës dhe jo në shumës, meqë është fjala për një person. (F. Rexhepi, F. Demaj .....61, 63.). Elasticiteti i kërkesës në lidhje më çmimin. (B. Ceku, N. Reshidi, vep. cit., 235.) krëhër për: krehër (R. Petro, Xh. Sylja, Libër leximi 6 Prishtinë 2014, 11).

Në të njëjtin tekst ndeshet edhe gabimi në kuptim të fjalisë si: Notat e saj ngjisinin me cicërma zoqjsh. Në vend se të përdoret folja përkatëse: ngjanin ose ngjasonin.

Gjinden edhe gabime teknike, mbase pa dashje, që do të duhej korrigjuar, p.sh. Koloseumi i cili zinte arreth 50.000 spektatorë, ...; Banonin zonën e Adriatikut. (F. Rexhepi, F. Demaj, po aty, 66, 71). Në

shembullin e parë shkronja a përpara fjalës rreth është e tepërt; në të dytin mungon parafjala në. Të tilla gabime hasim edhe në Fizikën e klasës së VI si p.sh.:

Përqijqjuni sakët: (f. 51) për: saktë.

... në rruqën e shurtër, (f. 53) për: shkurtër.

... gjatë rënjes së tij në tokë. (f. 57) për: rënies.

Në fizikë kët e themi kështu: (f. 59) për: këtë.

... marrim një menzurë dhe në të derdhim një çfarëdo lëngu ... (f. 21) Në këtë shembull numërori një është i tepërt.

Merrni një lloz dhe në njërin skaj të tij varin një trup, kurse në skajin tjetër lidhni një dinamometër. (f. 54) Në këtë shembull folja do të duhej të shkruhej në vetën e dytë shumës: varni.

Se sa shumë gabime gjuhësore hasim në tekste mësimore të nxënësve shkollorë, më së miri na e dëshmojnë këta shembuj të mëposhtëm, të marrë brenda tri faqeve të një teksti:

Kur shtresat përkulën përkatësisht rrudhën ...(për: përkulen, rrudhen);

... dhe pjesën neqative përkatesisht ... (për: përkatësisht).

Dikur ka qenë e zjarrët. (zjarrtë).

... nuk është gjithku e njejtë. (për: gjithkund, njëjtë).

... e kur del në sipërfaqën e Tokës ... (për: sipërfaqen).

Treqoni prej cilve shkëmbinj ... (për: cilëve).

... instrumentit për matjen e tyre ... (për: matjen).

Kështu copat e mëdha të shkëmbinjve gjithnji dërmohen ... (për: gjithnjë).

Të gjitha këto gabime gjuhësore dhe teknike, të pakontrolluara fare, gjenden brenda faqeve 37, 38, 39, në tekstin e Gjeografisë të klasës së VI të autorit R. Çavolli, botuar në Pejë 2014.

Dëshmia se nuk janë bërë korrigjime të duhura në tekstet shkollorë shihet edhe në Matematikën e klasës së dytë të shkollës fillore, ku brenda një fjalie gjenden tri gabime, si p.sh.: Plōësoni balonat me numtra që iu përqijqjen ature në boshtin numerik: (R. Zejnnullahu, S. Bilalli, Matematika e klasës II fillore, Pejë 2014, 75)., për: plotësoni, numra, atyre. E njëjta gjë ndodh edhe me librin Gjuha shqipe për klasën e dytë fillore, ku vetëm në faqen 100 ndeshim tri gabime, si vijon:

Pse shte e mërztur miza? për: ishte.

... dhe e goditi mizën mendjelhtë. Për: mendjelehtë.

Asnjeri nuk e kishte bishtin për bukuri, ... për: asnjëri. (B. Beci, Gjuha shqipe për klasën e dytë, Dukagjini, Pejë 2014, 100.)

Në dy shembujt e parë kemi gabime teknike, ndërsa në të tretin kuptimi i fjalës asnjeri përdoret për njerëz, përderisa në këtë shembull bëhet fjalë për shtazë dhe insekte.

**Përgatitja e teksteve universitare**

Në tekstet universitare të botuara gabimet janë më të pakta krahasuar me ato të teksteve të shkollave fillore dhe të mesme. Duhet cekur se gabimet e ndryshme gjuhësore të tekstet e botuara profesionale universitare, por edhe ato shkollore, janë më tepër përgjegjësi e lektorëve dhe e redaktorëve përgjegjës se sa edhe të vetë autorëve. Megjithatë, përkundër asaj se emri i recensentëve dhe i redaktorëve gjuhësorë qëndron në këto tekste, ndodh të ndeshim gabime jo vetëm ortografike dhe teknike, por edhe të rendit të fjalive dhe atyre me përmbajtje kuptimore, si p.sh.:

Aftësia e kompanisë për të qjetur dhe të mbajtur resurse njerëzore .... (E. Kutllovci, Menaxhimi i resurseve njerëzore, Prishtinë 2014, 19.

Në këtë shembull mungon parafjala – **për** në pjesën e dytë të fjalisë.

Prandaj, kapitali i potencial njerëzor mund të jetë një çështje e rëndësishme e potencialeve njerëzore. (Po aty, 19.)

Këtu, nyja e përparme – **i** nuk paraqet ndonjë kuptim dhe fjalia nuk ka përmbajtje logjike, andaj duhet të ishte të vijon (konsultim me një profesor të fushës përkatëse):

Prandaj, potenciali njerëzor i firmës është kapital, i cili mund të jetë një çështje e rëndësishme e potencialeve njerëzore të saj. Kur personi i cili është zhvillu në kulturën individualiste duhet të punojë në aftësi të personave nga kultura kolektivistë,... (Po aty, 19), që të tre brenda një faqeje të librit).

Këtu mungon presja para përemrit pyetës – **i cili**; folja do të duhej të shkruhej: **zhvilluar** dhe në vend të – **në** do të duhej përdorur parafjalët: **me** ose **sipas**.

Kapitali njerëzor i një vendi caktohet nga disa variabla. (Po aty, 20). Ndërsa në këtë shembull emri **variabla** do të duhej shkruar pa mbaresën – **ve** ose fjalia të shkruhej: ... **prej disa variabla**.

Në një titull mësimi hasim këtë shembull:

Vërehet edhe mungesa e përdorimit të lidhëses – **dhe**, si: Burimi i rekrutimit të kandidatëve dhe të talenteve janë shkollat, fakultetet. (f, 136); ose edhe përdorimi i përsëritur pa nevojë i njëjës lidhëse **dhe**, si p.sh.: ... është e nevojshme ta çmojë vetveten **dhe** ta vlerësojë **dhe** ta përfytyrë vlerën e vet, ... (f. 194), në vend se e para të zëvendësohet me presje.

... veçori individuale të cilat kandidati e sheh të nevojshme t'i theksojë. (f. 159) për: i sheh, d.m.th. mungon nyja e përparme e gjinisë mashkullore, e cila gabimisht është zëvendësuar me njëjën **e** të gjinisë femërore.

Ndeshim në përdorimin e gabuar të foljes në njëjës, e cila do të duhej shkruar në shumës, si: Menaxherët e ndërmarrjes duhet të gjejë një zgjedhje mesatare ... për: gjejnë. (B. Ceku, N. Reshidi, Marketingu, Prishtinë 2006, 75.

Gabimet teknike janë pothuajse të paevitueshme, si: Shërben për të realizuar kushtet e transportit dhe të ruajtjes (përqatitja në paleta). (Po aty, 116), në vend se të shkruhet – paketa; të cilat i kryejnë të gjitha aktivitetet që shfrytëzohen gjatë procesit ... (f. 261) për: aktivitetet.

Edhe në këto tekste ndeshim në mospërdorimin e zanores **ë**, përkatësisht zëvendësimin e saj me **e** si: ... nuk duhet të vazhdojmë me fazat e tjera të procesit kerkimor; (f. 75) Një nga objektivat e caktimit të çmimeve që zbatohet me shpesh... (f. 215); (B. Ceku, N. Reshidi, Marketingu, Prishtinë 2006). Do të duhej: veprës, kërkimor dhe më shpesh.

Në mesin e gabimeve gjuhësore vërehet edhe përdorimi i gabuar i shkronjës – **g** në vend të - **ç**, si p.sh.:

... dhe korrespondon me Parlamentin për të gjitha qëshjtjet ... (G. Qorraj, vep. cit. 83.)

... për të diskutuar qëshjtjet të rëndësishme ... (Po aty, 17).

Konsiderohet se e një rëndësie të veçantë ... (Po aty, 70).

Me të tilla gabime dhe lëshime ballafaqohemi edhe në tekste të tjera mësimore, pothuajse të të gjitha niveleve, ku më pak e ku më shumë, vetëm se ca prej tyre janë marrë për ti paraqitur shembujt e mësipërm.

Ne kemi nevojë për një kontrollim të mirëfilltë të botimeve tona shkollore dhe universitare, ato do të duhej shkruar në gjuhë të standardizuar dhe me përmbajtje kuptimplotë, për të gjitha moshat, pa gabime ortografike, gramatikore, përmbajtjesore dhe teknike. Rregullat e hartimit të teksteve duhet të jenë në pajtim me kriteret gjuhësore dhe me përmbajtje pozitive.

Shkolla synon ta aftësojë nxënësin më tej për përdorimin e gjuhës standarde (themi më tej sepse nxënësi vjen në shkollë gjithnjë e më shumë me gjuhën shqipe standarde). [2: faqe 72.]

Duhet theksuar se çdo lëndë mësimore ka të bëjë edhe me gjuhën në të cilën është shkruar teksti, në rastin tonë – gjuhën shqipe.

Zhvillimi i gjuhës shqipe është i lidhur me zhvillimin kulturor, me pasurimin përmes leximit, në veçanti tek të rinjtë.

“Shqetësimi kryesor i gjuhëtarëve dhe i të tjerëve duhet të lidhet me shkallën e zbatimit të normës, me mënyrën se si shkruhet në shqipen standarde”, [3. faqe 70.] posaçërisht gjatë hartimit të teksteve shkollore dhe universitare prej të cilave gjeneratat e reja marrim mësim dhe shembull për të vepruar më tej. Dihet se: “proceset dhe detyrat e sotme në fushën e shqipes standarde nuk janë të thjeshta. Ato lidhen me zhvillime madhore në jetën e shqiptarëve.” [4. faqe 18.]

Zhvillimet e shpejta në fushën e teknikës moderne kanë krijuar mundësinë e përdorimit të shumë fjalëve dhe shprehjeve të huazuara angleze meqë ende për shumë sosh nuk i kemi në gjuhën shqipe ose janë në krijim e sipër.

#### **Përfundim**

Mbrojtja e standardit të shqipes do të duhej të merrej më seriozisht dhe ka nevojë për një trajtim dhe përfillje të duhur. Lidhur me këtë është prononcuar edhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Hysen Matoshi, i cili ka pohuar se: "Gjuha standarde në institucionet publike, por edhe në botimet e librave shkollorë dhe universitarë (mendimi im) pa asnjë dyshim përbën një interes të përgjithshëm të shoqërisë apo të kombit. Prandaj, përdorimi i gjuhës shqipe në institucionet publike do të duhej të rregullohej me ligj ose me ndonjë akt tjetër nënligjor" [5: faqe 24].

Mendoj se është imperativ i kohës dhe tejet i nevojshëm përmirësimi i përdorimit të gjuhës në tekste të ndryshme, në shtyp dhe në media tek ne. Në lidhje me këtë çështje shumë serioze dhe mjaft të rëndësishme ka kërkesa për reformë të thelluar, në veçanti për librat shkollorë, në mënyrë që të formohet një ekip punues për korrigjimin e

gabimeve gjuhësore dhe përmbajtjesore në tekste. Në pajtim me këtë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka deklaruar se: "Së shpejti do të formohet një grup punues që të eliminohen të gjitha gabimet që kanë dalë në sipërfaqe së fundi dhe se do të bashkëpunojë ngushtë me autorët dhe shtëpitë botuese për mos përsëritjen e gabimeve" [6: faqe 11.]

Të shpresojmë se kjo kërkesë e domosdoshme dhe mjaft e ngutshme të realizohet që në të ardhmen të ketë sa më pak gabime dhe lëshime të tilla.

Përkundër kësaj ka edhe zëra që e kundërshtojnë ligjin për mbrojtjen e gjuhës: "Prej kujt me e mbrojt gjuhën shqipe? Prej shqiptarëve?" [7: faqe 27.] Unë do të kundërpërgjigjesha në këtë pyetje: Jo kundër shqiptarëve, por kundër atyre që duan të rrënojnë atë që është ndërtuar me dekada, shpërfillësve dhe atyre që nuk e respektojnë dhe çmojnë punën e bërë ndër vite për unifikimin e gjuhës letrare shqipe, e në veçanti gjuhën e shkruar, e cila mbetet e dokumentuar për vitet që vijnë.

Punimin do ta përmbyllja me një fjalë të urtë popullore të njohur dhe të botuar në shtyp kohëve të fundit: "Gjuha bashkon kombin" [8: faqe 8.]

#### **BIBLIOGRAFIA:**

1. MEMISHAJ, rami, Gjuha shqipe në shtratin e prokrustit, Tiranë, 2013, 9.
2. SHEHU, Hajri, A duhet botuar një fjalor shpjegues shkollor i gjuhës shqipe, "Gjuha Shqipe" 1/ 2013, Instituti Albanologjik Prishtinë, 72.
3. ISLAMAJ, Shefkije, Gjuha dhe identiteti, Botimet Toena Tiranë, 2008, 70.
4. LLOSHI, Xhevat; Lafe, Emil, Shteti shqiptar dhe zhvillimi i gjuhës letrare shqipe, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, Prishtinë, 2012, 18.
5. KOSOVA Sot, 9. Mars 2015, 24.
6. KOSOVA Sot, 14 Mars 2015, 11.
7. KOHA Ditore, "Ligj për shqipen", 21 mars 2015, 27.
8. KOSOVA Sot, 6 Maj 2013, 24.

# A KA LOKUCIONE ME VLERËN E PJESËVE TË NDRYSHUESHME TË LIGJËRATËS NË GJUHËN SHQIPE?

HAREDIN XHAFERI

Universiteti „Aleksandër Mojsiu“

Durrës, Shqipëri

haredin.xhaferi@gmail.com

## Përmbledhje

Objekt i kësaj kumtese janë disa vërejtje për lokucionet me vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjëratës, duke marrë në konsideratë edhe qëndrimet dhe trajtimin e deritanishëm të tyre. Këto lokucione nuk janë trajtuar ose janë trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme në literaturën tonë gjuhësore. Në gramatikën e ndryshme të gjuhës shqipe janë trajtuar shkurt lokucionet numërore dhe ato foljore. Nga lokucionet emërore janë trajtuar kryesisht togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë. Identifikimi dhe trajtimi i lokucioneve me vlerën e një pjese të ndryshueshme paraqesin vështirësi për një sërë arsyesh, një nga të cilat është qenia e njësive frazeologjike me vlerën e një pjese të ndryshueshme. Dallimi midis lokucioneve dhe njësive frazeologjike jo në çdo rast është i lehtë, sepse mjaft nga tiparet këto njësi i kanë të përbashkëta. Lokucionet me vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjëratës kanë vlerë emërore, mbiemërore, numërore, përemërore ose foljore. Karakteristikë semantike e këtyre lokucioneve është se elementet përbërëse kanë shkallë më të ulët ngulosjeje se të njësitë frazeologjike, ndërsa karakteristikë strukturore është se, ndryshe nga lokucionet me vlerën e një pjese të pandryshueshme, në strukturën e tyre të paktën dy elemente në çdo rast janë fjalë shënuese. Këto lokucione përdoren krahas fjalëve që janë sinonime me to. Studimi i tyre paraqet interes për larmishmërinë strukturore dhe vlerat semantike që ato mbartin.

**Fjalët çelës:** lokucion, togfjalësh i qëndrueshëm, njësi frazeologjike, vlerë semantike, strukturë, tipar

## Summary

The object of this paper are some observations for locutions the value of a variable part of the discourse, taking into consideration the attitudes and their treatment so far. These locutions are treated scantily treated in our language literature. In grammar of the Albanian language are treated february numeral locutions and verbal locutions. From nominative locutions are treated mainly terminology stable phrases. Identification and treatment of locutions with the value of a variable part have difficulties for a number of reasons, one of which is the existence of phraseological units with the value of a variable part. The difference between the locutions and phraseological units is not always easy, because many of the features of these units are in common. Locutions with value of a variable part are nominative, adjective, numeral, pronominal or verbal. Semantic characteristic of these locutions is that component elements have lower degree of loss of their lexical meaning than the phraseological units, while structural characteristic is that, unlike locutions with value of an invariable part in their structure at least two elements are marker words in any case. These locutions used alongside words that are synonymous with them. Their study is of interest for structural diversity and semantic values.

**Keywords:** locution, stable phrase, phraseological units, semantic value, structure, feature

## 1. Hyrje

Lokucionet janë të pranishme në shumë gjuhë. Ato përbëjnë një fushë të veçantë studimi në gjuhën shqipe, me problemet dhe çështjet e shumta, disa prej të cilave ende nuk janë zgjidhur. Lokucioni është konceptuar në mënyra të ndryshme (Xhaferi 2015). Shpesh ai është barazuar me njësinë frazeologjike apo me shprehjen. Te lokucionet përfshihen togfjalëshat e qëndrueshëm jofrazeologjikë dhe çdo bashkim i qëndrueshëm jotogfjalësh. M. Domi ka vënë në dukje se lokucionet janë togfjalësha të qëndrueshëm, shpesh edhe njësi frazeologjike, por jo çdo togfjalësh i qëndrueshëm dhe çdo njësi frazeologjike janë lokucione (Domi 1885).

Lokucionet janë njësi gjuhësore me strukturë të hapur, që kanë si elemente a më shumë fjalë shënuese, shërbyese ose të të dy grupeve, të lidhura me bashkërenditje a nënrenditje, të cilat e kanë humbur, diku më pak e diku më shumë, kuptimin dhe mëvetësinë e tyre. Këto njësi kanë vlerën e një pjese

të ndryshueshme ose të pandryshueshme të ligjëratës.

Këto njësi gjuhësore janë pak të studiuara. Janë studiuar kryesisht lokucionet që kanë vlerën e një pjese të pandryshueshme, por edhe ato studime janë të pamjaftueshme.

Në këtë artikull kemi synuar të vëmë në dukje trajtimin e derisotëm të lokucioneve me vlerën e një pjese të ndryshueshme dhe disa veçori e karakteristika të përgjithshme të tyre.

## 2. Njohja dhe trajtimi i deritanishëm

Në gramatikën e shqipes, në buletine, në revista shkencore etj. lokucionet nuk janë trajtuar në nivelin të kënaqshëm. Edhe për çështjet që janë trajtuar, nuk është mbajtur i njëjti qëndrim. Mbi këtë bazë, numri i tyre është rritur, duke marrë si lokucione edhe njësi që nuk janë të tilla ose është zvogëluar,

duke përjashtuar mjaft struktura që janë të ngjashme a të njëjta me to.

Studiuesit e hershëm nuk i kanë pasqyruar këto njësi gjuhësore në veprat e tyre. Në gramatikën e S. Frashërit, të K. Kristoforidhit, të Gj. Pekmezit etj. ato nuk janë pasqyruar. Studiues të tjerë i kanë trajtuar ato nga këndvështrime të ndryshme, por nuk kanë arritur t'i identifikojnë plotësisht dhe të përcaktojnë saktë kufijtë e tyre.

I. D. Sheperi i ka njohur lokucionet me vlerën e një pjese të ndryshueshme dhe ka shkruar se lokucionet *emërore*, *mbiemërore*, *foljore* etj. quhen të tilla kur përbëjnë emra, mbiemra, folje. Ai ka sjellë si lokucion parafjalor *në vend* (të ...); lokucione përemërore: *ay që* (atij që etj.), *ajo që* etj.), *kushdo që*, *cilido që* etj.; lokucione foljore: *marr vesh*, *më vjen keq*, *më vjen ligësht*, *më vjen mirë* etj. si dhe strukturat e përbëra prej foljes *jam* dhe emrave *nevojë*, *punë*, *e mira*, *e drejta* etj., kur kanë si kryefjalë fjali të dytë. P. sh. Është nevojë të punojmë (Sheperi I D, 1927)

O. Myderrizi në gramatikën e tij përmend si lokucione numërore: *dy fish*, *tre fish*, *dy herë*, *tri herë*, *dy nga dy*, *tre nga tre*, *nja dy*, *nja tre* dhe lokucione lidhore (përemra lidhorë): *ky që*, *ai që*, *cilido që*, *kushdo që* (Myderrizi O, 1944).

A. Xhuvani mjaft togfjalësha të qëndrueshëm foljorë i ka marrë si lokucione, duke veçuar si tipar të tyre njësinë kuptimore, qëndrueshmërinë dhe pamundësinë për t'u përkthyer. Autori ka theksuar se në fillim lokucionet kanë qenë fraza. Struktura të tilla, si *i luejti mendja* etj. ai i merr të ndërmjetme, midis lokucioneve dhe frazave (Xhuvani A, 1980).

K. Cipo strukturat *kushdo që* dhe *cilido që* i ka quajtur përemra të pacaktuar me forcën e përemrit lidhor dhe i ka shkruar bashkë, ndërsa përemrat *i cili*, *e cila* i ka njohur si lokucione përemërore (Çeliku M, 1962).

I pari që ka folur më qartë për ekzistencën e lokucioneve me vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjëratës, është M. Domi. Ai ka pranuar ekzistencën e lokucioneve emërore, mbiemërore, përemërore, numërore, sepse, sipas tij, ekzistojnë togje fjalësh të qëndrueshme që shënojnë një nocion të vetëm dhe funksionojnë si emra, mbiemra, numërorë, përemra. (Domi M, 1985) Ai ka njohur si lokucione emërore: *lule dimri*, *lule akulli* (*lulja e akullit*), *lule dhensh*, *lule blete*, *bar ethesh*, *bar dielli*, *gjel deti*, *të ngriturit krye* (*ngre krye*), *të vënë re* (*vë re*), *të bërët ballë* (*bëj ballë*) etj.; lokucione mbiemërore strukturën *i dalë menç*; disa togje që shënojnë ngjyrë, si: *bojë kafeje*, *bojë tjegulle*, *bojë gështenje* etj., si dhe togjet me vlerën e sipërores: *borë e bardhë*, *korb i zi*, *dyllë i verdhë*. Autori mendon se duhet parë edhe çështja e lokucioneve përemërore, duke vlerësuar të tilla: *gjithë sa*, *çfarëdo që*, *çdo që*, *kush e di sa*, *kush e di* (*se*) *kush* etj. (Domi M, 1985) Më parë këto struktura ai i ka quajtur togje

përemërore, të cilat mund të merren si përemra lidhorë të përbërë me kuptim përgjithësues. Listës së mësipërme i ka shtuar edhe: *tërë sa*, *tërë ç'*, *gjithë ç'*. (Domi M, 1970). Këto njësi janë pasqyruar si shembuj edhe nëpër gramatika.

J. Thomai te njësitë frazeologjike emërore, mbiemërore, foljore ka përfshirë edhe lokucione me vlerën kuptimore të secilës prej këtyre pjesëve të ligjëratës. (Thomai J, 1981) Një pjesë të togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë ai e ka përfshirë në një grup të veçantë të frazeologjizmave emërorë. (Thomai J, 1975) Më vonë ka përjashtuar nga frazeologjia disa nga këta togfjalësha, si dhe disa ndërtime të tjera me strukturë togfjalëshi. (Thomai J, 1999) Edhe lokucionet mbiemërore *i vënë re*, *i ndarë nga jeta* etj. i ka përfshirë te frazeologjia mbiemërore. (Thomai J, 1981) Ai ka përjashtuar nga frazeologjia togfjalëshat foljorë perifrazues, njësitë barazvlerëse analitike të kuptimeve leksikore të njësuara që shprehen nga një folje e veçantë, si: *arrij fitoren*, *bëj pushim*, *kam shpresë*, *bëj shetitje* etj. (Thomai J, 1995)

A. Spahiu mospërfshirjen e këtyre lokucioneve në gramatika e ka lidhur me dy çështje: me kriterin dhe me traditën. Ai ka pranuar lokucione emërore: *Arusha e Madhe*, *Arusha e vogël*, *molla e Adamit*, *nusja e lalës*, *Qafa e Thanës*, *i zoti i shtëpisë*, *zënia besë*, *vënia re* etj; lokucione mbiemërore: *i vënë re*, *i çuar peshë*, *i ndarë nga jeta*, *i vënë në spikamë*; lokucione përemërore: *gjë që*, *ai që*, *kushdo që*, *cilido që*. (Spahiu A, 2005) Si lokucione foljore ky studiues ka pranuar të gjitha strukturat që kanë shkallë të ulët qëndrueshmërie të elementeve përbërëse, që nuk kanë kuptim të figurshëm, që barazvlerëset e tyre sinonimike përcaktohen më lehtë, mbështetur në elementet e tyre përbërëse, si: *zë besë*, *kam shpresë*, *kam dëshirë*, *ngul këmbë*, *kam qejf* etj. Te lokucionet foljore ai fut dhe njësitë idiomatike të tipit *vë re*, *bëj pallë*, *marr vesh* etj. (19)

A. Duro ka trajtuar togfjalëshat e qëndrueshëm emërorë terminologjikë, duke i dalluar nga togfjalëshat e lirë, nga togfjalëshat e lirë terminologjikë dhe nga togfjalëshat e qëndrueshëm frazeologjikë. Autori ka dalluar njësinë leksiko - semantike të elementeve përbërëse si tipar të përbashkët të të gjithë togfjalëshave të qëndrueshëm me vlerën e një emri. (Duro A, 1982)

M. Çeliku ka trajtuar gjerësisht togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë, duke i ndarë në togfjalësha të qëndrueshëm foljorë me drejtim gramatikor dhe togfjalësha të qëndrueshëm foljorë me drejtim leksikor (të leksikalizuar plotësisht ose me tendencë leksikalizimi). Ai ka vënë në dukje se togfjalëshat e të dy grupeve janë përfaqësuar me terma të përgjithshëm e të padiferencuar, pa një përmbajtje

konkrete, si “shprehje foljore,” “lokucione foljore,” “njësi frazeologjike” etj. (Çeliku M, 1962)

Xh. Lloshi ka kërkuar përpunimin e mëtejshëm të nocionit të togfjalëshit ekuivalent me një fjalë të vetme, duke përfshirë edhe togfjalëshat foljorë që fitojnë një farë specifike dhe qëndrueshmërie për shkak të nevojës së përdorimit të tyre dhe të nocioneve që japin. (Lloshi Xh, 1972)

Sh. Demiraj ka njohur shprehjet foljore *bën ftohtë, bën ngrohtë, bën freskët* etj. Disa ndërtime, si: *është e nevojshme, është e udhës, është e domosdoshme, është mirë, është keq* etj. ai i quan shprehje dhe lokucione. (Demiraj Sh, 1971)

Z. Daci (Karapici) ka trajtuar lokucionet foljore të tipit *folje + emër (me dhe pa parafjalë)*, duke evidentuar grupet dhe nëngrupet sipas formës morfologjike të emrit. (Daci Z, 1985)

Pasqyrimi i lokucioneve me vlerën e një pjese të ndryshueshme të ligjëratës mungon në veprat shkencore të Akademisë së Shkencave. Në ndonjërin prej tyre është pohuar se “lokucionet ndeshen kryesisht te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, si ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza e pasthirrma, por mjaft herë edhe te folja.” (Fonetika, 1976) Gjatë trajtimit të pjesëve të ndryshueshme vetëm te numërori dhe te folja janë përmendur shkurt lokucionet përkatëse. Te numërori janë veçuar shprehjet si një grup i veçantë, ndërsa te folja janë pasqyruar shkurt tiparet e lokucioneve me vlerë foljeje. (Gramatika, 1995)

Në Gramatikën e gjuhës shqipe II janë marrë si lokucione strukturat: *gjithë sa, gjithë ç’, gjë që* dhe janë sjellë pak shembuj lokucioneesh foljore me strukturë të formuar nga një folje dhe një emër, të tilla, si: *vë re, mbaj mend, marr vesh, jap shpirt, hedh shtat*, si dhe *vë dorë, i jap udhë* etj. (Gramatika, 1996)

### 3. Konsiderata të përgjithshme

Identifikimi dhe trajtimi i lokucioneve me vlerën e një pjese të ndryshueshme paraqesin vështirësi për një sërë arsyesh. Një nga arsyet është edhe qenia e njësive frazeologjike me vlerën e një kategorie të caktuar leksiko - gramatikore. Dallimi midis tyre jo në çdo rast është i lehtë, sepse këto njësi kanë të përbashkëta mjaft nga tiparet e tyre. M. Domi ka tërhequr vëmendjen për të mos i identifikuar lokucionet me njësitë frazeologjike. (Domi M, 1985) Lokucionet duhen dalluar edhe nga fjalët e bashkëngjitura, nga togfjalëshat e lirë dhe nga togfjalëshat frazeologjikë. Ato nuk janë kategori leksiko - gramatikore.

Lokucionet emërore janë togje të qëndrueshme me përcaktim rasor ose atributiv. Në këto struktura dallohet përcaktuesi dhe i përcaktuari, të shkrirë në një nocion të vetëm. Elementet e këtyre lokucioneve nuk kanë atë shkallë ngurosjeje që kanë elementet e

togfjalëshave frazeologjikë. Lidhjet tyre janë më të drejtpërdrejta, siç janë realisht lidhjet ndërmjet sendeve ose sendeve dhe vetive të tyre. Karakteristike për lokucionet emërore është se mjaft prej tyre nuk kanë sinonime njëfjalëshe.

Lokucionet mbiemërore kanë vlerën e një mbiemri dhe funksionojë në ligjërim si të tilla. Ato dallohen nga njësitë frazeologjike mbiemërore. Këto njësi kanë përdorim njëkuptimësh. Janë togfjalësha të qëndrueshëm me elementet të ngurosura. Në strukturën e tyre mund të futet ndonjë element tjetër, por ai shërben si përcaktor i gjithë lokucionit. Kështu, për shembull, në strukturën *bojë kafeje mbiemri i hapur* mund të përdoret midis dy elementeve ose pas tyre, por në të dy përdorimet ai shërben si përcaktor i gjithë lokucionit: *bojë e hapur kafeje* ose *bojë kafeje e hapur*. Disa nga emrat e dytë të lokucioneve të këtij tipi mund të përdoren edhe si mbiemra, pasi tiparet karakteristike të sendeve që emërtojnë, mund të kalojnë më lehtë në gjendje abstrakte. Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (FGJSSH) këto togje janë pasqyruar si një fjalë e vetme (mbiemër). Shkrimin e tyre në këtë formë e quajmë të parregullt, sepse emri i dytë i togfjalëshit ka mbaresën e rrjedhore së pashquar, e cila bëhet pengesë për njëfjalësimin. Në strukturat e tipit *akull i ftohtë, mjaltë i ëmbël* etj. emrat nuk janë desemantizuar. Në këtë përdorim, pamundësia e emrit për t’u lidhur me fjalët e tjera ose për ndryshime morfologjike shpjegohet me vlerën e tij kuptimore. Ai nuk emërton, por tregon shkallë shumë të lartë të tiparit. (Gramatika, 1995) Struktura në fjalë nuk shënon një koncept të ri, por një kategori të caktuar morfologjike (shkallën sipërore). Rëndin e pangulitur të këtyre emrave A. Dhrimo e ka quajtur dukuri shumë popullore, e cila duhet mënjanuar. (Gramatika, 1995)

Strukturat *njëzet e një, njëzet e dy, tridhjetë e një* etj. dhe dhe togjet e formuara nga një *numëror* dhe një *emër*, si: *një mijë, një milion* etj. në gramatika janë quajtur shprehje numërorësh. Këto struktura duhen konsideruar si njësi njëfjalëshe, duke u bazuar në veçoritë e komponentëve të tyre. Nëse këto njësi do të ruajnë strukturën e hapur, ato nuk hyjnë në kategorinë leksiko - gramatikore të numërorëve, sepse nuk janë fjalë. Elementet e tyre përbërëse janë shkuptimësuar dhe funksionojnë brenda një të tëre, duke sjellë kuptim të ri. Zanorja e i ka humbur lidhjet kuptimore e funksionale të mëparshme. Një tipar i rëndësishëm që i afron me fjalët, është se ato shërbejnë si tema fjalëformuese. (Fonetika, 1976) Këtë veçori e kanë fjalët. Para se këto njësi të kryejnë një funksion të tillë, duhet të kenë përfunduar në fjalë. Kjo ka ndodhur edhe te pjesët e tjera të ligjëratës. Së fundi, do të themi se sot këto struktura shqiptohen me theksin te fjala e fundit.

Në literaturën tonë gjuhësore nuk janë pasqyruar lokucionet përemërore. Ato janë grupe të qëndrueshme fjalësh me vlerë përemri. Elementet e tyre përbërëse zakonisht kanë shkallë të ulët qëndrueshmërie. Nga struktura janë të ngjashme me lokucionet e grupeve të tjera. Të tilla përmendim: *gjithë sa, një palë, çdo gjë, kush e kush, ca e ca, shumë e shumë, dhjetra e dhjetra, çmos e çnuk* etj. Por jo çdo strukturë e formuar nga dy fjalë është lokucion. Strukturat *kushdo që, cilido që, çfarëdo që, gjë që* etj. nga ndonjë studiuës janë marrë si lokucione përemërore. M. Totoni te togjet *kushdo që, çfarëdo që, cilido që* veçon përemrat si gjymtyrë (kryefjalë, kundrinorë a përcaktorë) në fjalinë e nënrenditur dhe pjesëzën *që* me vlerë aktualizuese. (Totoni M, 2000) Për togun *gjë që* (emër + përemër) ai mendon se emri *gjë* e ruan kuptimin e tij dhe kryen funksionin e ndajshimit në fjalinë kryesore ose në një pjesë të saj. (Totoni M, 1988)

Lokucionet me vlerë foljeje paraqesin vështirësi për t'u identifikuar, sepse në gjuhë përdoren edhe njësitë frazeologjike foljore. Këto të fundit kanë shtrirje më të gjerë. (Domi M, 1985) Lokucionet foljore mund të zbërthehen më lehtë semantikisht kur kanë kuptim të drejtpërdrejtë, i cili del nga kuptimi i elementeve përbërëse, të tilla si: *kam dëshirë, bëj pushim* etj. Për lokucionet me kuptim të figurshëm duhen përjashtuar tipare të tilla, si

motivimi, ngjyrimi emocionues etj., që janë karakteristike për njësitë frazeologjike. Lokucionet foljore janë formuar nga të paktën dy fjalë kuptimplota, njëra prej të cilave detyrimisht është folje. Foljet përdoren me kuptim të zbehur leksikor (si folje gjysmëndihmëse) ose e kanë humbur fare atë, të tilla si: *kam* (kam dëshirë etj.), *bëj* (bëj çudi etj.), *bie* (bie në dashuri etj.), *fut* (fut frikën etj.), *jap* (jap urdhër etj.) etj. Këto folje kanë humbur edhe funksionin sintaksor. E gjithë struktura ka vetëm një kuptim dhe kryen një funksion të vetëm sintaksor. Lokucionet foljore funksionojnë si kallëzues të thjeshtë foljorë. Foljet e këtyre lokucioneve ruajnë të plota kategoritë gramatikore.

#### 4. Përfundime

Në përfundim mund të themi në gjuhën shqipe përdoren lokucione me vlerën e secilës nga pjesët e ndryshueshme të ligjëratës. Ato kanë vlerën e një fjale, por jo në çdo rast u përgjigjen fjalë sinonime. Struktura dhe semantika e tyre është e larmishme. Deri sot këtyre lokucioneve nuk u është kushtuar vëmendja e duhur dhe kanë munguar trajtimet e posaçme për secilin grup. Identifikimi dhe trajtimi i tyre është i domosdoshëm për të lehtësuar analizën gjuhësore dhe pasqyrimin e tyre në fjalorët e shqipes.

#### Literatura

Cipo K, *Sintaksa*, 1952

Çeliku M, *Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore 2, 1962

Daci Z, *Vështrim rreth një tipi të lokucioneve foljore*, Gjuha jonë 3, 1985

Demiraj Sh, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971

Domi M, *Disa çështje të lokucioneve*, Studime filologjike 1, 1985

Duro A, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, Studime filologjike 4, 1982

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, 1976

Gramatika e gjuhës shqipe I, 1995

Gramatika e gjuhës shqipe II, 1996

Karapici Z, *Shprehje foljore të tipit folje + emër*, Studime filologjike 1, 1986

Lloshi Xh, *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, Studime mbi leksikonin dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972

Myderrizi O, *Gramatika e ré e shqipes*, Për shkollat e mesme Vëllimi I (Fonologji e morfologji), 1944

Spahiu A, *A përbëjnë lokucionet një mënyrë të veçantë fjalëformimi?* Gjuha jonë, 1 - 4, 2005

Sheperi I D, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, 1927

Totoni M, *Fraza me nënrenditje*, 2000

Totoni M, *Zhvillim i brendshëm dhe ndërtim i huaj*, Gjuha jonë 1, 1988

Thomai J, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981

Thomai J, *Çështje të identitetit të njërive frazeologjike*, Studime filologjike 1 - 4, 1995

Thomai J, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999

Thomai J, *Frazeologjizma emërorë dhe mbiemërorë në gjuhën shqipe*, Studime filologjike 4, 1975

Xhaferi H, *General Remarks on Locutions*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol. 4, No. 1, Roma, 2015

Xhuvani A, *Mbi thjeshtësinë e gjuhës*, Vepra I, 1980



## Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike Suffix article in Balkan languages

HATIXHE HOXHA  
Fakulteti i Arteve  
Universiteti "Hasan Prishtina"  
Prishtinë, Kosovë  
Email: hatixhe\_hoxha@hotmail.com

### Përmbledhje

Studiuesit e huaj dhe shqiptarë të cilët u morën me studimin e nyjës në gjuhët ballkanike, e të nyjës së prapme në veçanti u interesuan në lidhje me prejardhjen, si dhe kohën e shfaqjes së nyjës së prapme në gj. ballkanike. Studiuesi. M. La Piana, prapavendosjen e nyjës në gj. ballkanike nuk e konsideronte fenomen të pavarur, por shprehej se, shqipja mund të ishte ajo gjuhë që ndikoi mbi rumanishten dhe bullgarishten, sepse nyja në këto gjuhë ishte praqitur shumë më vonë, ndërsa në lidhje me kohën e shfaqjes së nyjës së prapme të shqipes ai mendon se ajo na del para huazimeve latine. Prof. Çabej ishte shprehur se ky dijetar kishte të drejtë, kur nyjen e prapme të shqipes e shpie në një periudhë të tillë kohore, pra para hyrjes së huazimeve latine në shqipe.

Fjalët çelës: nyja, shqipe, rumunishtja, gj. ballkanike.

### Abstract

Foreign and Albanian scholars have studied the article in Balkan languages, and especially the suffix article, specifically dealt with the origins, and the time of appearance of suffix article in Balkan languages. La Piana did not consider the suffix article in Balkan languages to be an independent occurrence, but stated that Albanian might have been the language which influenced Romanian and Bulgarian languages, because such article had appeared quite later in such languages, while in terms of appearance of the suffix article in the Albanian language, he believes it came before borrowing from Latin. Çabej was convinced that this scholar was right to put the Albanian suffix article in such a time period, before the introduction of borrowed Latin terms into the Albanian language. Bariqi agreed with N. Jokl, that the suffix article is ancient, and it belongs to the Albanian-Thracian-Armenian period.

Keywords: article, Albanian, Romanian, Balkan languages.

### Hyrje

Padyshim se çështja më komplekse në gjuhësinë ballkanike, vazhdon edhe më tej të mbetet çështja e formimit të nyjës së prapme. Studiuesit që u morën, këtyre shekujve të fundit, me çështjen e nyjës në gjuhët ballkanike, shprehën mendime të ndryshme rreth kohës dhe prejardhjes së nyjës në gjuhët si: *shqipe*, *rumanishte*, *bullgarishte*, *maqedonishte*.

U shtruan pyetje të ndryshme si:

Nyja e prapme, në cilën nga këto gjuhë ishte më e lashtë?

- Cila nga këto gjuhë kishte ndikuar në tjetrën, në lidhje me këtë çështje?

- Në një apo më shumë gjuhë të lashta, duhet kërkuar burimi i nyjës së prapme të: shqipes, bullgarishtes, rumanishtes apo maqedonishtes?

Në lidhje me kohën se kur u shfaq nyja e prapme në gjuhët si: shqipja, rumanishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, studiuesit kishin mendime të ndara.

### **Nyja në rumanishte**

Studiuesit, në lidhje me kohën e shfaqjes së nyjës në rumanishte, ishin të mendimit se nyja e prapme në rumanishte është shfaqur aty pas shek. VII, por gjithsesi para shek. X. Studiuesi, VI. Georgiev, mendonte se nyja në rumanishte është zhvilluar

ndërmjet shek. VI dhe X të e.r. Kurse, Prof. Eqrem Çabej, ishte shprehur se nyja e prapme e rumanishtes, kishte zë vend në atë gjuhë, para ndërprerjes së simbiozës, së këtyre dy gjuhëve (shqipes dhe rumanishtes), d.m.th. para shek. (X-XIII). Ndërsa, Mlladenov, shprehej se rumanishtja dhe shqipja kanë nyje të prapme, sepse rumunët dhe shqiptarët janë trakas të romanizuar, që d.m.th., shprehej ky autor, se kjo pozitë e nyjës në këto gjuhë ka burim nga trakishtja.

### **Nyja në bullgarishte**

Në lidhje me kohën e shfaqjes së nyjës në gj. bullgare, Mlladenov shprehej se nyja në gjuhën bullgare është krijuar që në "bullgarishten e vjetër", d.m.th. që në sllavishten e vjetër kishtare. Ndësa, Mirçev, Gëlëbart, shpreheshin se nyja e prapme e bullgarishtes është shfaqur para shek. (XIII).

### **Nyja në maqedonishte**

Studiuesi Bllazhe Koneski, në lidhje me kohën se kur u shfaq nyja e prapme në maqedonishte, ai shprehej se, "Edhe në shkrimet e vjetra "maqedonase", që në shek. e XIII, hasen gjurmët e një nyje të prapavendosur".

### **Prapavendosja e nyjës në gjuhën shqipe**

Në lidhje me prapavendosjen e nyjës në gjuhën shqip, studiuesit ishin marrë mjaft herët, dhe kishin nxjerrë përfundimin se nyja e prapme e shqipes i përket periudhës para shek. VII-VIII të e. r.

Marko La Piana: mendon se nyja e prapme e shqipes duhet të jetë përfutur para kontakteve të saj me latinishten. Ndërsa, Norbert Jokli: mendon se nyja e prapme e shqipes është e lashtë, por se ajo është përfutur nën ndikimin e nyjës së greqishtes. R.G.Petrovski: Shprehej se nyja e prapme e shqipes është e re e formuar aty rreth shek. XII-XV, si rezultat i ndikimit të një gjuhe sllave të Ballkanit, d.m.th. të bullgarishtes-maqedonishtes, ose të një gjuhe romano-ballkanike. Ndërkaq, Prof. Cabej: shprehej se: "Rrethanat e veçanta të fonetikës historike të shqipes na lejojnë të hedhim vështrime retrospektive e të ngjitemi në disa faza të moqme të shqipes. Aty vërtetohet se artikulli pospozitiv është i lashtë, sepse ai na shpie në periudhën prehistorike të shqipes".

Nga sa u tha më lart, shprehej Bahri Beci, se nyja e prapme është e hershme në gjuhën shqi pe dhe rumanishte, ndërsa është e re në bullgarishte dhe maqedonishte.

### **Nyja e shqipes burimi**

Për ne me shumë interes është të vërtetohet se nyja e prapme e shqipes, a ka një burim të brendshëm të prejardhjes apo është ndikim i jashtëm i gjuhëve të tjera të Ballkanit, thoshte Jorgji Gjinari.

Prof. Rexhep Ismajli, shprehej se në gjuhësinë krahasimtare, ku ishte përhapur teza për vjetërsinë e madhe të nyjës së prapavendosur në shqipen, lindën teori nga më të ndryshmet për origjinën e prapavendosjes së nyjës nga protoshqipja (ilirishtja, trako-dakishtja) e me këtë edhe përkrahet teza për vjetërsinë e madhe të nyjës së shquar në shqipen pikërisht në pozitë të prapavendosur, me përjashtim të S. Rizës, i cili krijimin e nyjës në shqipen e sheh të vjetër mbi dy mijë vjet, por në pozitë të paravendosur.

Prof. Gjinari shprehej se greqishtja e vjetër s'mund të jetë burim i mundshëm ngai i cili është përfutur nyja e prapme e shqipes sepse ka nyje të përparme dhe strukturë të ndryshme nga ajo e shqipes dhe rumanishtes.

Maqedonishtja e vjetër, Nuk vjenë në konsiderim – thoshte J. Gjinari, si burim, në këtë rast për arsye

### **Bibliografi:**

Eqrem Çabej (1977), Reth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe, STUDIME GJUHËSORE, IV, Prishtinë.  
Besim Boksh (1984), PRAPAVENDOSJA E NYJËS NË GJUHËT BALLKANIKE, Prishtinë.

historike, gjeografike, për faktin se ka rreth katër hipoteza se gjuha maqedonase ishte:

- dialekt i greqishtes;
- gjuhë me origjinë ilire;
- gjuhë me origjinë trake;
- gjuhë e afërt me greqishten.

Si burim i nyjës së shqipes mbeten të shikohen dy gjuhë të vjetra të Ballkanit, si ilirishtja dhe trakishtja (dakomyzishtja).

H. Bariq: Pajtohet me mendimin e N. Joklit se nyja e prapme e gjuhës shqipe është e vjetër, duke e menduar të kohës shqiptaro-trako-armene.

Marko la Piano- shprehej prof.: Besim Bokshi, që më 1939, thoshte se: "Është absurd të kërkohen për këtë proces morfologjik, karakteristik për shqipen, ndikime të mundshme nga latinishtja qoftë ballkanike, dhe akoma më keq, ndikimet e elementeve më të vonshme si: bullgarishtja e rumanishtja" ai u shpreh më pas se: Vetëm shqipja mund të jetë ajo gjuhë që ndikoi mbi rumanishten e mbi bullgarishten, sepse nyja në këto gjuhë është shfaqur shumë vonë (në rum. Në shek. X, në bullgarishte, në shek. XVII).

Sipas Jorgji Gjinarit: Trakishtja (dakomizishtja) nuk është ajo gjuhë e vjetër e Ballkanit ku duhet të kërkohet burimin e nyjës së prapme të shqipes. Ai sollti shembujt nga VI. Georgiev, për trakishten e që ka karakteristikë: toponimet tematike p.sh. Drizupara (Drizu+para); Scelabria (scela+bria). Siç shihet kompozitat e trakishtes kanë strukturë të tillë, ku përcaktuesi vendoset përpara elementit që përcaktohet: i mirë ujë, shqipja ujë i mirë. Kjo strukturë u tha se e largon shqipen nga trakishtja (shqipja në këtë pikë afrohet me rumanishten), sepse shqipja ka strukturë me rend të kundërt, qoftë në kompozita si: Gurakuqi; togfjalësha si: Mali i Zi, Guri i Bardhë etj.

Prof. Çabej te emri Scupi, të kohës antike, sheh mundësinë e identifikimit të –i-së fundore, të këtyre toponimeve, me nyjën e prapme –i, të shqipes.

Emrat nga fusha e onomastikës ilire, rregullisht dalin monotematik: Emra vendesh Ulcinium, Drinus, emra njerëzish Plator, Bato, ndryshe nga trakishtja dhe myzishtja ka pas emra të këtyre kompozita: Drizupara, Mesembria, etj., prandaj, Jorgji Gjinari mendon se burimin e nyjës së prapme të shqipes, duhet kërkuar te ilirishtja.

Jorgji Gjinari (1974), Mbi nyjen e prapme të shqipes në aspektin e lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare, *STUDIME ILIRE*, II, Tiranë, 1972, Tiranë.

Ismajli, Rexhep (1987), *ARTIKUJ MBI GJUHËN SHQIPE*, Prishtinë.

Bahri Beci (1996), *Seminari i XVIII Ndërkombëtar Për Gjuhën, Letërsinë Dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë.

## Breshka Dranja dhe Camaj nën zhguallin e rrëfimtariit Turtles-Dranja and Camaj under narrator's shell

Ndoj Mhilli

Universiteti i Tiranës

Tiranë, Shqipëri

Email: [ndoj\\_mhilli@hotmail.it](mailto:ndoj_mhilli@hotmail.it)

### Përmbledhje

Në Dranja-madrigal të Camajt kemi hibridizim, madje mund të flitet për shkrirje gjinore mes prozës dhe poezisë. vërejmë se hibridizimi, shkrirja – prishja e tipologjisë gjinore është fjala çelës, figura mbi qilim e shestit të këtij teksti. Qëndrimin në kapërcyell gjinor e legjitimon me qenien e breshkës si frymor i ndërmjetëm “*mes sisorëve dhe atyre që pjellin vezë*”. Breshka na del edhe si simbol i përfaqësimit të botës malësore, i mënyrave të tij të jetesës, përfaqësuese e përfytyrimeve poetike të autorit, për botën tashmë të largët dhe në bjerrje të Camajt. Cilësitë e breshkës duket sikur janë vetë cilësitë e poetit, e disa ndër to: *mos me bërtit e mos me kja*, në raste vdekjeje, burrat, veçori këto të malësorit. Nën zhguallin e breshkës fshihet e bashkëjetojnë në simbiozë me të femra, emri i një vajze të vendlindjes dhe breshka. Pra aty bashkëjetojnë në harmoni breshka dhe njeriu. Shpesh zhguallin e breshkës e vesh rrëfimtari-autori dhe nëpërmjet këndvështrimit të saj përdhes, na flet vet, autori. Rrëfimtari na flet nga këndvështrimi i breshkës, e cila krahasohet vazhdimisht me qenien njerëzore. Rrëfimtari herë flet-shpreh nën zhguallin e saj, herë zhvishet dhe merr tiparet njerëzore, pra herë shikon horizontalisht, herë vertikalisht, e herë flet mbi atë çka i ngjet asaj si një kundruese e epërme. Nëpër re tymi që lëshohen nga rrëfimtari nuk merret vesh qartë nëse breshka është njeri i çfarëdoshëm si përfaqësues i racës njerëzore, është Dranja si përfaqësuese gjinore, femra; dhe i përveçëm, nëse breshka është autori, nëse breshka është kujtesa dhe skota (fisi).

**Fjalë çelës:** breshka, narratori, madrigali, metamorfizimi, formëhibride, fisi, kujtesa.

### Abstract

In Dranja-madrigal of Camaj have hybridization, and can talk about gender mergers between prose and poetry. We note that hybridization, the melting - breaking the gender typology is the key word, figure on the carpet of The drafting of the text. Staying between the genders legitimise also being of the turtle as a spiritual being intermediate “between mammals and those that lay eggs.” Turtle qualities seem poet's own qualities, and some among them: the men *mustn't cry and mustn't weep*, in the occasions of deaths, these were the qualities of the highlanders. Under the turtle's shell is hidden and coexist in symbiosis with it the female, the name of a native girl and the turtle. So there coexist in harmony the turtle and the man. Turtle's shell often is worn by narrator-author and through her view, is the author that speaks. Under the shell, the narrator speaks from the point of view of the turtle, which is constantly compared with the human being. The narrator often speaks under turtle's shell, sometimes undressed and takes human features, so once you see horizontally, sometimes vertically, the time talking about what's going on it as an upper contemplative. Through the cloud of smoke that issued from the narrator not agree clear if the turtle is man whatsoever as representatives of the human race, gender representative is Dranja, woman, and, if the turtle is the author, if the turtle is the memory and *skota* (the tribe).

**Key words:** turtle, narrator, madrigal, hybridforme, tribe, metamorphic, memory.

### Hyrje

Te Dranja-Madrigale e Camajt kemi te aplikuar shkrirjen gjinore mes prozës dhe poezisë. Me sa duket shkrirja gjinore është një ndër fjalët çelës që i shkon për shtat shestit të kësaj vepre - të këtij teksti. Nën zhguallin e breshkës fshihet e bashkëjetojnë me të në simbiozë femra. Emri i një vajze të vendlindjes dhe breshka. Këtu bashkëjetojnë në harmoni breshka dhe njeriu.

Shpesh zhguallin e breshkës e vesh rrëfimtari-autor dhe nëpërmjet këndvështrimit të saj përdhes, na flet vetë, autori. Njeriu, femra, lashtësia, e sotmja, e shkuara dhe e tashmja, vendlindja, breshka, tradita dhe autori qëndrojnë në simbiozë nën zhguallin e breshkës.

### Breshka përfaqësues i jetës malësore

Qëndrimin në kapërcyell gjinor e legjitimon edhe të qenit e breshkës si frymor i ndërmjetëm “*mes sisorëve dhe atyre që pjellin vezë*”.

Dranja – breshka ngërthen në vetvete një simbolikë tansore:

1. Breshka

11. ndeshtrashja (shqetësimet e mëdha)

- |                           |  |
|---------------------------|--|
| 2. malësori               | 12. Dranja- dëshmitare                                     |
| 3. femra                  | 13. Dranja- ndërgjegje                                     |
| 4. kujtesa historike      | 14. Dranja-ndodhi  |
| 5. folklori               | 15. Dranja si mungesë-vetmi                                |
| 6. poeti                  | 16. Dranja si tëhuajsim                                    |
| 7. teksti letrar          | 17. Dranja si tempull i lashtë i Apolit dhe Afroditës etj. |
| 8. Vendlindja             | 18. Dranja –gjarpri.                                       |
| 9. skota (fisi)           | 19. brengat  |
| 10. lashtësia (pergamena) |  |

Breshka na del edhe si simbol i përfaqësimit të botës malësore, i mënyrave të tij të jetesës, përfaqësuese e përfytyrimeve poetike të autorit, për botën tashmë të largët dhe në bjerrje të Camajt. Veçorit/virtytet e breshkës duket sikur janë vetë karakteristikat e shkrimtarit. Disa ndër ato virtyte të botës malësore janë: “*mos me bërtit e mos me kja*” në raste vdekje sidomos burrat. Veçori këto të etnokulturës së malësorit. Tek madrigali *Fis i panjoftun* na rrëfhet: “*Ai fis nuk pati nevojë për tragjedina dhe art skenik: lindja e jeta e popujve buzë detit që për atë një lojë. Fëmijët në djep i mësuen me njohë dhe me emnue barnat mirëbamëse, yje e sheje në qiell për ndërrime stine e moti.*

*Ai fis zotave të huej u la emnin e vet për të mos e përlye gjuhën me ta! Më duket se përpara se me hapë sytë ai popull përvetësoj parimin:*

*Me qenë gurë i latuem përgjysmë për mos me hy kurrë në shtylla madhështore për të mëkambë ndoj tempull, dhe fjala e tij vetëm tingull ndër dhambë të thyem për të mos lanë kund hije në rrasë, as në pergamënë.*

*Ai fis ashtë i vetmi që shikoj diellin kokërr e pau një pikë të kuqe në një disk: dritëzën e syve të vet”* (Camaj 2005: 18).

### Breshka njeri – njeriu breshkë

Nën zhguall, rrëfimtari na flet nga këndvështrimi i breshkës, e cila krahasohet vazhdimisht me qenien njerëzore. Rrëfimtari herë flet nën zhguallin e breshkës, herë zhvishet dhe merr tiparet njerëzore, duke rrëfyer në vetën e parë, pra herë shikon horizontalisht, herë vertikalisht, e herë flet mbi atë çka i ngjet asaj si një kundruese e epërme. Nëpër re tymi që lëshohen nga rrëfimtari nuk merret vesh qartë, nëse breshka është njeri i çfarëdoshëm si përfaqësues i racës njerëzore, është Dranja si përfaqësues gjinor, femra, ose i përveçëm, nëse breshka është autori, nëse breshka është kujtesa dhe skota (fisi). Kësisoj teksti na çon drejt krijimit të rrëfimitarit – narratorit anonim. Narratori i cili rrëfen në vetën e parë, e megjithatë të krijon përshtypjen e një rrëfimtari anonim, është një strategji tekstore - narratologjike mjaft e veçantë, e cila meriton vëmendjen e studiuesve të cilët

merren me poetikën e prozës. Megjithatë mendojmë se një dukuri e tillë është specifik e mjeshtërisë artistike të Camajt, e cila nuk di ndonjë rast tjetër që të jetë aplikuar në letërsinë shqipe. Shkrirja gjinore mes prozës dhe poezisë është një ndër fjalët çelës, ndoshta figura kryesore e qëmtimit të kësaj vepre. Një dukuri e tillë e kanë trajtuar edhe studiues të tjerë si: Ernest Koliqi, i cili që i pari që e ka vërejtur një dukuri e tillë te romani *Diella*; mandej e gjemë të shqyrtuar nga Arshi Pipa dhe Shaban Sinani. Ernest Koliqi ka theksuar: “*Auktori, pa u kujdesue për gjinit letrare dhe tue lanë mbas dore mësimet e marruna në shkollë, e derdh landën në ni kallep sui generis. Kjo tregon se, i rrëmbyem prej diçkahit të përbrendëshem qi don të shpërthej jashtë, kalon sipër modeleve të zakonshme edhe i shtjellon mendimet e ndjesit në trajtën ma t’udobët dhe të vetvetishme”* (Koliqi 1996: 9). Nga ana tjetër studiuesi A. Pipa shprehet se “*hibridizimi i heroinës si zvarranik dhe qenie njerëzore përkon me hibridizimin e gjinisë letrare”* (Pipa 1996: 15). Siç kemi vënë në dukje edhe në punime të tjera të bëra për krijimtarinë letrare të Martin Camajt, prishja e tipologjisë gjinore – qëndrimi në kapërcyell ndërmjet gjinive letrare është një ndër tiparet më qenësore të poetikës së Camajt, e cila ndeshet e aplikuar/materializuar që tek romani i parë *Diella* deri te vepra dramatike *Loja e mbasdrekës* (Mhilli 2015). Me të drejtë studiuesi Sh. Sinani tek *Camaj i paskajuar* thekson se: “*Në veprat e Camajt shpërfillen përkufizimet e Platonit në dialogjet e tij kritike për kufijtë e tragjedisë me poemën dhe llojet e tjera të artit dhe konceptet e “Poetikës” së Aristotelit, ashtu siç kishte bërë më parë Charles Baudelaire me 51 “Poetits poems en prose” (Le Spleen de Paris, 1869) etj., si: Oscar Wilde, Tomas Eliot, Stefan Mellarme, Montale Ungareti, Saramago etj. Prishja e tipologjisë së llojit është një dukuri që e sundon letërsinë e Camajt prej romanit “Diella” deri në fund të jetës”* (Sinani 2011: 96-97).

### Femra

Nën zhguallin e breshkës fshihet e bashkëjeton në simbiozë me të femra, emri i një vajze të vendlindjes dhe breshka, e madje edhe vetë autori, i cili si nëpër tym e ngre kryet aty-këtu: “*Brshka paza, send i gjallë i pavlerë, zen vendin ma të mirë*

nën lirin e madh dhe ka pakëz simpati njeriu në kohën e vetmisë dhe emrin e një vajze të bukur nga vendlindja e vet” (Camaj 2005: 27). Kjo breshkë e paza, send i gjallë i pavlerë na ndërmend menjëherë vargjet e poezisë *Korbi*. Edhe këtu autori ndjehet i huaj dhe në vetmi të plotë, megjithëse zë një vend të rëndësishëm në shoqërinë ku jeton. Është pikërisht emri i kësaj vajze të bukur, që ja “le-dhaton” vetminë shqetësuese, pra autori kërkon që nën zhguallin e Dranjes të arratiset, së paku ndër kujtime, në vendlindje. Këtë mendim e përforcon edhe më shumë përcaktimi te madrigali *Një botë në vete*: “Poeti që e vëren Dranjen po në këtë timtë s’i shkon mendja te punët e saj të brendshme: në vetmi ai përtyp në tru si breshka na qenka kozmopolite e mirëfilltë vetëm sepse kupa e rrashtës së saj i përngjet gjymës së rruzullit me njolla dhenash të çdo ngjyre, si racat e ndryshme në të” (Camaj 2005: 20). Por ai është edhe i zoti ta ndreqë rrëhimin e vet, kur ndalet dhe e vëren Dranjen nën çmueshëm e thotë: “dam, që askush s’e ditka se një rruzull i tillë na paska në thelb po një zemër breshke!” (Camaj 2005: 20). Me shumë gjasa Dranja është një vajzë nga vendlindja e autorit, e cila ka mundësi të ketë gëzuar pëlqimin/dhënien e tij. Shpesh zhguallin e breshkës e vesh rrëfimtari-autor dhe nëpërmjet këndvështrimit të saj përdhes na flet me nota tragjike, kujtesa në zgrip dhe nevoja e rrëfimit, e cila duket se buron së brendshmi.

### Vendlindja – fëmijëria

Nevoja rrëfimore, e cila vjen si rrëhim në kujtesën e largët, siç vërehet edhe në citimin e më sipërm është një ndër elementet më të spikatura, që e ndeshim në vijimësi të jetësuar te vepra e Martin Camajt. Metaforikisht vendlindja është guri sizifian, të cilin e mbartë me vete autori, kryqi të cilin e mbart mbi shpinë në Golgotë, lirimi prej saj në mënyrë psikoterapeutike gjendet vetëm nën peshën e rrëfimt. Aty shpirti i arratisur i shkrimtarit duket se gjen të vetmen strehë çlirim-shpëtimi. Një gjë e tillë dëshmohet – përligjet ndër të tjera edhe nga notat tragjike që e përshkojnë fund e krye *Dranjën madrigale* të Camajt: “*fatin e një frymori të papërsosur*” (në fund të veprës do të shohim se autori ndjen si një liri shpirtërore). Brenga e shkrimtarit është dheu i të parëve, mbijetesa e tyre tragjike e shoqëron kudo, madje edhe te romani i parë *Diella*<sup>1</sup>. Sipas studiuesit A. N. Berisha:

<sup>1</sup> Me këtë dua të them se Camajn brenga e vendlindjes, prapambetja intelektuale, mosshkollimi, jetesa në rrethana mbinjerëzore dhe tragjike, pamundësia për t’u përshtatur me qytetërimin madje edhe atë shkodran tek romani *Diella*, tëhuajsimi i tij dhe i dheasve të tij – skotës do ta kishin shoqëruar edhe po të kishte jetuar brenda kufijve të Shqipërisë. Camaj ndjehet i huaj në dheun e të parëve edhe kur

“*Braktisja e atdheut dhe e vendlindjes iu shndërrua Camajt në një ide e ngacmim të pashuar, të vijueshëm që mori përmasa tragjike brenda qenies së tij*” (Berisha 2010: 104). Pikërisht kjo mendojmë se është një ndër fjalët çelës që ndihmon në interpretimin dhe receptimin e veprës së Camajt. Shkrimi i parë dhe i fundit fillon dhe mbaron me dheasit e tij: vendlindjen. Më tej tek madrigali *Era e borës* rrëfimtari artikulon: “*Dështim për Dranjen ashtë me lanë kryet dikund, fitore, me mbetë veç gjallë si frymorët tjerë të përvujtë e zvarranikë*” (Camaj 2005: 26). Togfjalëshi “*me mbet veç gjallë*” është dëshmi e një mbijetese në zgrip të ekzistencës për brezni me radhë, të një harrrese që lë shije të vrazhdë, dhe të një masdorësie shekullore, në të cilën gjalloi skota e Dranjes: “*Por gjithë këto rrethana nuk e lirojnë breshkën prej zanit të keq si parazite, e për ma tepër dritë-shkurtë dhe e lanun mbas dore gjithsesi*” (Camaj 2005: 10). Camaj është lindë e rritë me zanin ndër veshë të kumbimit të fjalës së urtë popullore: “*hadh me dekë e gjyq me rrune*”, të cilën e përdorin mjaft shpesh edhe sot malësorët dukagjinat. Vetë Camaj është pergamena e brezive të kamotshme, të cilat gjallojnë në nënvetëdijen dhe presonin e tij. Ai duket se është shëmbëllesa më besnike e tyre, siç vetë rrëfimtari-autor thekson te madrigali *Në tempullin e Afroditës*: “*Më në fund, i kënaqur se cik më cik përkonin as me qenë binjoke, dëshmoi se skota e Dranjes atje nuk ishte ardhacake, por dheas*” (Camaj 2005: 23).

### Dranja – tempull i lashtë i Apolit e Afroditës

Camaj ndjehet i huej dhe i lanun mbas dore, ai ndjehet në udhëkryq mes Lindjes dhe Perëndimit, mes njerëzve që flasin si ai dhe atyre që flasin një gjuhë të ndryshme prej tij: “*Tash unë dhe Dranja këqyremi ballë për ballë kokërr ndër sy, të dy të ngimë, por ndërdyzash si të huej mbi dhe nga se asnjëri nuk di kah me ia mbajtë përpara territ, në lindje apo në perëndim?*” (Camaj 2005: 13).

Siç vërejmë në citimin e më sipërm veta e parë (unë-autori) rrëfen mbi vetën e dytë, Dranjen/personazhin/breshkën; në pamje të parë duket se rrëfen mbi të, por me sa kemi arritur të hulumtojmë në fakt rrëfen mbi vetveten më së shumti, sigurisht edhe për të. Nga ana tjetër edhe kur flet për veten e dytë – Dranjen, rrëfen mënyrën se si e sheh ai atë, pra nga këndshikimi i autorit apo dhe i skotës së tij. Ky këndshikim vende-vende përmbysset dhe kalon nga kahu i Dranjes, pra nga mënyra e këndshikimit të personazhit/breshkës. Ky ndërkëmbim i pozicioneve të këndshikimit të rrëfimtari, i vetave dhe i kohës, që duket se shkon

jeton jashtë tij, në mërgim. Kjo vërehet qartë tek romani *Diella*.

nga e sotshmja tek lashtësia (Tempulli i Afroditës), përtejkohësisë, shkrirja gjinore, teknika rrëfimore, strategjia e autorit etj., e bëjnë këtë vepër të ndër më të arrirat e letërsisë shqipe si strukturë rrëfimore dhe si kompozicion tekstual në tërësi. Si rezultat i elementeve të sipërpërmendura rrokja e tekstit, çkodifikimi i tij sa vjen e mjugullohet, duke u bërë gati-gati i parrokshëm në tanësinë strukturore, por ama vende-vende vërehen edhe pika orientuese që bëjnë të mundur rrokjen e tekstit – kumteve që ai përcjell te lexuesi. Kjo dukuri mendojmë se vjen si rezultat i teknikës së thurjes së tekstit dhe strategjisë rrëfimore që sendërton veprën.

### Dranja – ndodhi

Dranja-breshka merr cilësitë dhe tiparet e vajzës malësore, një gjë e tillë del e qartë te madrigali *Miqësi e ligshhtë*: “*verën e kalueme ndërroi gjendja. Si vajzë që rritet shpejt, dhe shpejt don me i qitë fat vetes e me dalë nuse, ajo më lëshoi një shikim të shkriftë. U mat dy-tri herë, nxori kambë prej rrashtës, prap u rudh; dhe kur i pati nxjerrë të dyja, mbylli ashkëzën e syvet me pjekët e veta prej lëkure së gjallë, e uli kryet si me dashtë me më thanë: jam në dorën tande, më pre, po deshe!*” (Camaj 2005: 33). Te ky pasazh përçohet ndjesia e ndrojtjes së vajzës malësore kur takohet me të dashurin, apo më mirë të themi me mëtonjësin për të qenë i tillë. Mirëpo, menjëherë rrëfimtari këtë ndjesi e mjugullon nga ngjyresa që merr fjala breshkë në kundërvënje me fjalën femër - vash. Femra i dorëzohet ndjenjave të ndërsjella të dashurisë, duke e lënë veten të prehet sikletshëm por me andje në krahët e mashkullit. Kësisoj tiparet njerëzore përcillen përmes breshkës-Drane. Në pjesën e parë të veprës rrëfëhet nga këndshikimi i autorit më së shumti, ndërsa në pjesën e dytë *Mprehje shqisash* merr përparësi këndshikimi rrëfimor përdhës i breshkës - Dranjes. Gërshetimi i këndshikimit të rrëfimitarit vërehet shpesh: “*Dranjes s’i kalbet ashti dhe mishin s’ia ha askush ndër ne. Prandej, kur na sheh, sa do lëkurë murmë të jemi e të parruem, s’i ngjethet shtati puçërrizë nga frika. Por akulli i dimnit të papritur në gjumë, nji herë në gjymtyrë, mandje në qafë e krye e deri në zemër, ia qet kesi dheu mbarë farën! Ashtu edhe Drini*” (Camaj 2005: 46). Më lart vërejmë se brenda dy fjalish realizohet ky ndërkëmbim i roleve të rrëfimitarit, e shprehur kjo edhe me karakterin fragmentar të veprës, e cila qëndron e lidhur në një strukturë unike, falë tematikës që shtjellohet dhe frymës së përgjithshme të saj. Në fjalinë e parë rrëfëhet nga këndshikimi i autorit, ndërsa në fjalinë e dytë nga ai i Dranjes - breshkës.

Ndjesitë erotike theksohen tek madrigali *Dranja në kashnjët*: “*doli prej dushku Dranja breshkë dhe e kundroi djalin si vajzat. Shiu ish ba ma i shpeshtë, e pika sa lendi i binin atij në ballë e i kullonin për faqe e mjekërr, as me qenë lotë të idhët. Dranja i merr anën e mrekullohet qysh edhe ai farë djali qenka i lanë e i trishtë. Në të vërtetë breshka kishte ndie erën e gështenjave të pjekuna*” (Camaj 2005: 47-48). Ndjesitë erotike, vetitë njerëzore ndërkëmben në kaq pak lëndë gjuhësore, në nuhatje dhe në qëllimet e breshkës, sa që mund të themi pa ngurrim se një gjë e tillë ndeshet rrallë në letërsinë shqipe. Mirëpo, nga ana tjetër kemi ndërkëmbimin e vetave nga veta e parë te veta e dytë dhe anasjelltas gjatë rrjedhës rrëfimore. Siç shihet më lart kemi kalimin nga veta e dytë te veta e parë, duket se narratori mban – ka qëndrimin – fokusimin apo ndryshe pikëshikimin e Zotit, pra i sheh gjërat prej së larti me një shikim shpesh disi të mjugullt/turbullt, dhe me një farë distance disi objektive. Studiuesi A. N. Berisha vëren se: “*Tema ose motivi, situata ose personazhi nuk e kushtëzojnë gjuhën, por gjuha i kushtëzon, asaj i nënshtrohet çdo gjë. Objektet e trajtuara nuk ekzistojnë për hir të tyre vetë, por për hir të gjuhës*” (Berisha 2010: 106).

### Përsëritja e motiveve në funksion të ndërlimit të kuptimit

Dranja njësohet me vajzën e vendlindjes, me breshkën, me gjarprin, me mitin, me dheun etj. Tiparet e Dranjes (ndoshta vajzë nga vendlindja) me ato të breshkës, poetit: “*Breshka Dranje ndërroi disa herë në jetë plang e vise. E sa ma shumë endet, vendi s’i zen vend. Të kish mbet ndër kodrat e Rrencit atë mot!*” (Camaj 2005: 55), dhe malësorëve, mbruhen së bashku nën një tis mjugullimi e errësimi kuptimor, duke e bërë tepër të ndërlikuar perceptimin tërësor të veprës. Veçori kjo e poetikës së Camajt që në krye të herës. Me të drejtë studiuesi A. N. Berisha ka shkruajtur: “*Breshka apo Dranja ngërthen në vete një simbolikë shumëzore; shenjëzon një varg çështjesh e dukurish, ndjesish e vlimesh shpirtërore, që nuk thuhet drejtpërdrejt e qartë, por dalin nga mënyra e shtjellimit të tekstit dhe nga konteksti i strukturës tekstore poetike; është një mozaik simbolesh, që kushtëzon ndërsjellëtas dhe bashkëjetojnë në rrafshin mitik e real*” (Berisha 2010: 102-103). Vërejmë se secili prej madrigaleve-rrëfimeve mund të perceptohet apo interpretohet edhe më vete edhe në marrëdhënie me të tërën si strukturë. Gjë e cila përligjet nga struktura e veprës, stili dhe tematika e kësaj proze poetike. Megjithatë ajo që të bie në sy është se edhe brenda veprës ndeshemi

me përsëritjen e motiveve. Te *Dranja madrigale* kemi disa linja dhe shtresa që i shërbejnë ndërtimit të strukturës së veprës. Në këtë mënyrë struktura e prozës poetike bëhet edhe më e ndërlikueshme.

Një ndër tiparet shkrimore të veprës së Camajt në vijimësi janë shtresat e ndryshme historike, niset nga e sotmja dhe përfundon tek lashtësia, duke ndërkallur mitiken me realen, si rrjedhim përfton një ndërveprim kohor të pacaktuar (përtej kohës, pakoshmërinë).

Tragjikja dhe mbijetesja e bashkëkombësve të tij nën zgjedhën e diktaturës shtjellohet tek madrigali *Udha e breshkave*, ku ai pohon se: “Kur një brezni apo popull i tanë e humb drejtimin, s’ka zot që e ndih” (Camaj 2005: 63), sepse tashmë udha e mbrapsht e tyre kalon nëpër një shteg të pa krye, i cili çon drejt rrënimin vdekjesjellës.

Tek madrigali *Zani i mirë* rrëfimtari na zbulon një vend ndodhje të re të Dranjes-femër, tashmë grua, duke na përshkruar disa nga virtytet e saj morale: “Mbas verimit në maje të Barcodhës Dranja u nis andej pa e sjellë kryet kah unë. Prit se po kthen, por ajo u dorgj brijave për vërrije, kah viset e shtrejta sa jeta vet. Ma vonë ndëgjova ndër katunde të rranzave se kudo i kishte shkelë kamba asaj kishte tregue gjithkund urti e qindresë në sende e punë të vogla. Ndonëse pa zotësi fjale, me sheje e sjellje kish dhanë me kuptue se çdo grimë thesari dije e përvoje nuk e qitka në treg, po e mbajtka për vete, thellë ndër kthinat e rrashtës, fshehë. Gjindja që mirë e paskan njohë Dranjen, e thirrën me krenari: tharm toke dhe Ora e gurit tonë” (Camaj 2005: 64). Tashmë na flitet për Dranjën e vërtetë, e cila na rezulton se është martuar diku në një zonë fushore. Nga kjo mundë të hamendësojmë se breshka i shërben strategjisë shkrimore dhe fshehjes së fillit të vërtetë të ngjarjeve reale, duke i nënkuptuar ato nëpër re tymi. Dranja na prezantohet gjatë rrëfimit vende-vende breshkë, vende-vende vajzë-grua, e vende-vende frymor i ndërmjemë gjysmë femër gjysmë breshkë: “Mandej erdhi muzgu e fjeti edhe ajo si Dranja dikur, e qetë në djepin e vet ashti, pakëz nën majen e Helikonës” (Camaj 2005: 65).

Filli dhe lajtmotivi i veprës duket se nxjerr krye tek madrigali *Luledielli i vendit tonë*, ku Camaj shprehet: “Atëherë isha edhe unë i ri, e u dashurova në të. Kur desha ta marr me vete, ajo shtërngoi dhen e vet ndër thundra me epush dhe shtini kërcikët në plasa, përpajnë, as me qenë ato rrënjë të forta bungu dhe mbeti aty” (Camaj 2005: 73-74). Vasha të cilën ka dashur në rini, kur ai ishte ende në vendlindje shndërrohet në lajtmotiv të veprës, megjithëse tepër i kamufluar dhe i pa dukshëm në lexim të parë – nga një lexues empirik. Ajo, dikur nuk ka pasur guximin të ndërmarrë së bashku me të aventurën e arratisjes me sa vërehet në këtë madrigal.

## Breshka - fisi

Diku më tej kemi një krahasim mes Dranjes dhe gruas së vërtetë: “Vetëm Dranja, që i përngjan ma shumë se asnjën shoqesh grues së vërtetë” (Camaj 2005: 76).

Një motiv i ngjashëm me poezinë Korbi dhe i përsëritur edhe brenda kësaj vepre e ndeshim tek madrigali *Pjesa e dytë e kocertit*: “Breshka posa vuni atje kambë në rrasë, me gërvishje të thonjeve e prishi harmoninë e u shuen dhe tingujt e muzikës klasike” (Camaj 2005: 76). Autori i nënkuptuar – rrënimtari apo iluzor po të përdorim një term të Zherar Zhenet bën një paralelizëm mes vetes dhe breshkës, i cili me thonjtë e tij, me fortësinë e tij prej malësori-shqiptari nuk puqet dot me finesën e muzikës klasike, pra e ndjen veten të tëhuajtuar, në një vend të huaj, të cilit së paku me shpirt nuk i përkret thellë brenda vetes: “Çfarë bote kjo për Dranjen, fare e huej!” (Camaj 2005: 71). Bota shqiptare dhe ajo malësore me shumë gjasë është fillimi dhe sosja Camajt. Për studiuesin A. Berisha: “Në ‘Dranja’ është sublimuar bota tematike e kuptimore e krijimtarisë letrare të Camajt në prozë dhe në poezi. Ndeshim këtu tema e dukuri që janë bërë objekt trajtimi në përmbledhjet ‘Nji fyell ndër male’, ‘Kanga e vërrinit’, ‘Lirikë mes dy moteve’, ‘Legjenda’, ‘Rrathë’, ‘Shkundullima’, ‘Karpa’. Në ‘Dranja’ këto jipen vetëm në elemente qenësore dhe, të shkrira brenda një tërësie të veçantë, marrin vlerë e funksion krejtësisht tjetër – rrjedhojë e strukturës së re shprehëse artistike” (Berisha 2010: 100-101).

## Breshka – mishërim i kujtesës kolektive

Breshka mishëron në mënyrë simbolike tiparet e fisit, veset, varfërinë, trimërinë, mbijetesën në zgrip dhe virtytet e larta të malësorit dukagjinas. Një dukuri e tillë vërehet dhe receptohet mjaft qartë te ky pasazh: “Dranjen e qiti shtegu në një vend guror, vise ku skamja kish lëshue rranjë ma tepër se asnjë lis. Kur e ngulte njena sosh kërbaçin e thundrës mbi rrasë, nuk kishte gjallnes që ia bante fjalën dysh. Ndonëse frymorë të panjohur u përpoqën t’i qesin fare, askush s’ia doli. Kjo rrethanë i egërsoi tejet...Dranja ndër to zbuloi edhe cilësina të tjera, si pirje të qindrueshme dashamirësie me frymorë të ndryshëm” (Camaj 2005: 78).

## Nevoja rrëfimore si domosdoshmëri vetanake dhe artistike

Kujtesa si nevojë dhe dobi për të rrëfyer mbi të dhe nëpërmjet saj: “Tue thanë kështu tres në kujtime e kundroj sendet që ishin e janë, përzieshëm, si në një



*pasqyrë të gërrisun, plot njolla*" (Camaj 2005: 84). Një kujtesë në zgrip, e cila del përzishëm edhe në këtë prozë poetike, ku shpesh motivet, apo nevoja rrëfimore si domosdoshmëri, në këtë rast përsëritet, por edhe kur ndodhë një gjë e tillë ajo është funksionalizuar në një kontekst të ri, dhe merr vlerë të re kumtuese. Siç kemi pohuar edhe më lart gjatë këtij punimi tipar i veprës së Camajt është edhe poetika e ndërtuar mbi bazën e kujtesës dhe rrëimit të ethshëm mbi të. Këtë veçori ideoartistike të krijimtarisë letrare të Camajt e ndeshim dendur në veprën e tij (si psh., te tekstet dramatike Loja e mbasdrekës dhe Kandili i argjandit etj.)

### Koha reale – koha mitike

Një tipar tjetër i veprës së Camajt është aplikimi i nocionit kohë, ku e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja përthihen duke shkërmoqur kohën reale, duke dhënë mbarëkohësinë, të sotmen dhe lashtësinë. Koha është për të një palimpsest që mbart mbi vete kujtesën historike, kolektive dhe vetanake. Çkodifikimi i së shkuarës, i lashtësisë në të tashmen dhe me anë të së tashmes është një qëllim dhe strategji autoriale.

Studiuesi i mitologjisë Erns Kasirer pohon: *"For myth time does not take the form of a mere relation, in which the factors of present, past, and future are persistently shifting and interchanging; here, on the contrary, a rigid barrier divides the empirical present from the mythical origin and gives to each its own inalienable "character." Thus it is understandable that the mythical consciousness despite the fundamental and truly constitutive importance which the universal intuition of time possesses for it has sometimes been called a timeless consciousness. For compared with objective time, whether cosmic or historical, mythical time is indeed timeless.*"<sup>2</sup>

Breshka-palimpsest, pergamenë e lashtë, kujtesa kolektive, mbart mbi të shkrimet dhe historinë e të

<sup>2</sup> Për herë mit nuk ka marrë formën e një lidhje të thjeshtë, në të cilën faktorët e tashmja, e kaluara dhe të ardhmen janë vazhdimisht zhvendosur dhe ndër-këmbyer; këtu, në të kundërtën, një pengesë e ngurtë ndan të tashmen empirike nga origjina mitik dhe i jep secilës patjetërsueshmërinë e "karakterit" të vet. Prandaj është e kuptueshme që vetëdija mitike pavarësisht rëndësi themelore dhe me të vërtetë konstituive të cilën intuita universal e kohës posedon/zotëron për të, është quajtur nganjëherë një vetëdije e përjetshëm. Për ta krahasuar me kohën objektive, qoftë kozmike apo historike, koha mitike është me të vërtetë e përjetshme. [Përkthim i yni, N. M.]. (Crasier 1995: 105).

shkuarës, ku e tashmja dhe e shkuara ndër-këmbehen, duke dhënë realen dhe mitiken. Karakteristik e kohës mitike është pakohësia dhe mospasja e kufijve të përcaktuar gjeografik. Këtë kohë – këto dy tipare i gjejmë të mishëruara te Dranja madrigale. Studiuesi A. N. Berisha vëren se: *"Breshka, e quajtur Dranja, qenie e papërsosur, simbolika e së cilës shtrihet e funksionalizohet në nivele të ndryshme të dy rrafshve kryesore – mitike dhe konkrete – shpreh në qenësi jetën; qëndresën, fatkeqësinë dhe tragjiken e njeriut tonë nëpër kohë (Dranaja kalon nëpër gërmadha dhe rrënoja të qyteteve të lashta); shpreh ëndrrën dhe zhgjëndrën, fatin nëpër udhëkryqe dhe shtigje të gjallimit; dështimet e pasojat"* (Berisha 2010: 101). Në kahjen rrëfimore përfshihet gjithëkohësia. Dranja përfaqësuese simbolike e skotës së saj që nga lashtësia deri në kohët e sotme, mbart mbi vete si zhguall historinë, tragjiken fatkeqësinë e visit dhe të llojit të saj: *"një ditë pashë në kopshtin e pallatit të lashtë përballë se Dranja ulej"* (Camaj 2005: 85).

### Dranja – ndërgjegje

Në pjesën e tretë të veprës *Fryma e ngujueme në asht*, autori-rrëfimtari fillon të na rrëfejë për Dranjen mbi bazën e kujtesës tashmë të identifikuar prej lexuesit, madje të pranuar edhe prej rrëfimtari, megjithëse krejt shtjellimi është i strukturuar mbi të. Nëse në dy pjesët e para të veprës Dranja është e pranishme dhe vende-vende reale, e prekshme, në pjesën e tretë rrëfimtari i drejtohet kujtesës edhe për Dranjen, sepse: *"Mbrendë, ndër rranjë të ndërthyme sa llana e krahut, zbulova ashtin e Dranjes"* (Camaj 2005: 86). Dranja, tashmë hajmali, qëndron mbi libra: *"kundër kujtimit të fyerjeve e ankthit kudo që më shkeli kamba, me më mbetë gjithmonë para syve të mi si hana me fëtyrë tjetër, gjithnjë e re ose e vjetër, në andërr dhe rëmime"* (Camaj 2005: 87).

Përshkrimi i Dranjes na vjen i ndryshëm në kohë e stinë të ndryshme sipas ndjesive dhe këndshikimeve të autorit-rrëfimtari, si tek madrigali *Metamorfozë: "Kur ktheva, pashë se kishte ndërrue fare Dranja"* (Camaj 2005: 91).

**Humbja e vetëdijes së kohës** ndeshet tek madrigali *Plogësia në gjak: "gjithë marsin atje mbetën të ngrime ndër sytë e mi"* (Camaj 2005: 94). Ndalimi i kohës në një shej vendi është element-tipar, strategji e poetikës së Camajt. Njëpërmjet kësaj dukurie – ideoartistike shprehet thellësia dhe pesha e tragjikes së eksistencës. Tragjikja, vendlindja, tëhuajsimi, harresa bëhen element i shfrimeve poetike: *"Hutimi i prin brengave përpara rrugës që shkon në shkamb"* (Camaj 2005: 95). Uni poetik mbizotëron në pjesën e tretë të kësaj vepre letrare.

Një brengë që e shoqëron autorin, duke u transfiguruar në shprehje poetike është nevoja **për të qenë i pranuar** prej skotës dhe vendit të tij: *“fryma e saj pranon çdo ndeshtrashë në këtë rreth, jo vetëm pluhurin përmbi asht, harresën njerëzore, si mbi çdo libër të mirë, por edhe zjarmin”* (Camaj 2005: 96); nevojë autoriale për të qenë i lexuar dhe i pranuar prej lexuesit të pritshëm. Të tijtë e kanë mohuar e nëpërkëmbur, siç rrëfen tek madrigali *Qindresa: “Dhe s’ka si të jetë ndryshe, kur njeriu të tëhujet dita-ditës edhe prej farefisit”* (Camaj 2005: 86).

### **Dranja – gjarpri brejtje e ndërgjegjes**

Rrëfimtari në një shej vendi dhe kohe narrative kërkon – orvatet ethshëm të lirohet nga brengat dhe ndërgjegjja e breme: *“Solla shikimin përtej e pashë larg, si në ranën e detit nisi me bulue bima e ndërgjegjes së breme, mrekullia keqbamse, gjarpri tue qitë avull si ta kisha nxjerrë at minut prej fundit të zemrës”* (Camaj 2005: 106). Gjarpri simbol i së keqes në këtë rast, i bremsës së ndërgjegjes, tashmë del nga thellësia e zemrës, duke e liruar rrëfimtarin-autorin gjatë procesit shkrimor. Me gjasë një element tjetër i veprës është edhe procesi shkrimor, si terapi vetanake.

Ka gjasë – mund të aludojmë minimalisht që rrëfimtarin ta ketë brejtur ndërgjegjja për faktin se mori dhenat e huej, duke e braktisë e humbur përgjithmonë Dranjen (vajzën e vendlindjes), por siç vërehet në madrigalin *Shlirimi: “aty për aty, fill*

*mbas dëshirës së flaktë buloi edhe fjala e preme me u nda prej frymës së Dranjes për jetë”* (Camaj 2005: 107), pra me këtë vepër me sa duket kushtuar kujtimit të saj, rrëfimtari-autor vendosë të shlirohet e të ndahet për jetë, duke e shti siç shprehet ai në *strajcë Dranjen* – duke e fshehë artistikisht. Ka gjasë që vepra të jetë ngjizur, në zanafillën e saj si bremje ndërgjegjeje ndaj braktisjes së bërë kundrejt Dranjes, në rini.

### **Përfundim**

*Vepra zë fill me përcaktimin e tipareve të Dranjes-breshkës e vazhdon me ballafaqimin me të, shoqërohen në shtegtime të përbashkëta, rrëfen mbi bazën e kujtesës në bjerrje mes reales dhe mitikes dhe në dy madrigalet e fundit të veprës ‘Shlirimi’, ‘Dhe e shtina në strajcë’ e përmbyllë atë me shkrimin psikoterapik prej saj.*

*Rrëfimi realizohet shkallë-shkallë dhe mjaft i natyrshëm. Ai zë fill me prezantimin dhe njohjen me Dranjen, personazhit që do të trajtohet, shtjellohet në këtë prozë poetike, më pas përcaktohet vendi ku zhvillohen ngjarjet (i turbullt aty këtu) dhe vendveprimi i Dranjes-autorit – rrëfimtari, e së fundi bëhet përcaktimi mitologjik dhe real i saj.*

*Stili, strategjia shkrimore, gjuha e përzgjedhur deri në detajet më të imta, sintetizimi gjuhësor, imazhet poetike, figuracioni artistik, shumësia kuptimore, shtresat e shumta të strukturës së veprës e bëjnë këtë vepër një nga veprat më të arrira të letërsisë shqipe, dhe jo vetëm.*

### **Bibliografia e shfrytëzuar**

- BERISHA, Anton Nikë (2010). *Vepra letrare e Martin Camajt*. Botimet "Princi" Tiranë.
- CAMAJ, Martin (2005). *Dranja madrigale*. Sh. Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër.
- CRASIER, Ernst (1995). *The philosophy of symbolic forms – volume two*. New Haven: Yale University Press, London Geoffrey Cumberlege Oxford University Press.
- KOLIQI, Ernest (1996). Arti i Martin Camajt: "*Jeta e Re*", nr. 1-3, Prishtinë.
- PIPA, Arshi (1996). Poezia dhe poetika e Camajt: "*Jeta e Re*", nr. 1-3, Prishtinë.
- SINANI, Shaban (2011). *Camaj i paskajuar, rreth tipologjisë së llojeve në veprën e M. Camajt*. Shtypshkronja "KRISTALAINA-KH", Tiranë.
- ZHINET, Zherar (2014). Diskursi i ri i rrëfimit. Përktheu: Mirela Shella. Sh. Botuese "Dy lindje & dy perëndime", Tiranë.

## **Të burgosurit politikë në Gjakovë me rrethinë në vitet 1945-1966 në dritën e burimeve arkivore**

### **The political inmates from Gjakova and its vicinity in 1945-1966 based from the gleam of archive sources**

SHEFQET DINAJ  
QSA Tiranë  
Gjakovë, KOSOVA  
Email: shefqetdinaj@gmail.com

#### **Përmbledhja**

Objekti i kumtesës sime do të jetë veprimtaria atdhetare e të burgosurve politik të Gjakovës me rrethinë në vitet 1945-1966 nën dritën e burimeve arkivore. Në kumtesën time do të ndalem në një proces të përsëritur dhune që kaloi popullit shqiptar i Kosovës nga Shteti Jugosllav në Federatën Jugosllave, e pikërisht në procesin e gjyqimit dhe të burgosjes së individëve dhe të grupeve të shqiptarëve të Gjakovës me rrethinë në vitet 1945-1966. Mund ta veçoj “Grupin e Gjakovës”, i cili u gjykua dhe u burgos në vitin 1957. Për tematikën që unë trajtoj, sillen prurjet e deritanishme të literaturës historike si dhe burime të pa publikuara deri më sot, të cilat i kam gjetur gjatë hulumtimit tim në Arkivin Historik Regjional të Gjakovës, në Shoqatën e të burgosurve politik të Gjakovës me rrethinë si dhe në disa arkiva familjar dhe komunal të Kosovës.

**Fjalë çelës:** Burgosurit politik, Gjakovë, Arkiv, Grupi i Gjakovës, burime.

#### **Abstract**

The matter of my theme will be the patriotic activity of political inmates from Gjakova and its vicinity during period of time 1945-1966 based from the gleam of archive sources. In the matter I am working on, I will make a survey of a repeated process of the violence that Kosovo Albanian people experienced from the former Federative Yugoslavian country especially during the trials and imprisonments of individuals and groups of ethnic Albanians from Gjakova and its vicinity during the period of time 1945-1966. I can point out “The group of Gjakova” who were judged and sentenced in 1957. As for the topic I am working on, while searching at the Regional Archive of historical matters for Gjakova with its vicinity and as conducting other researches to some family and municipal archives, I was able to get historical records and other sources which so far were not published.

**Key words:** Political inmates, Gjakova, Archive, Group of Gjakova, Sources.

#### **Hyrje**

Lëvizja politike e rezistencës shqiptare në ish-Jugosllavi nga viti 1945 e deri më 1981 mund të kuptohet vetëm atëherë kur kemi një pasqyrë të qartë për lëvizjen ilegale, organizimin, strukturën dhe udhëheqësit kryesor të saj.

Meqë, kjo lëvizje veproi në kohë dhe rrethana të vështira, është e natyrshme se një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme nuk është ruajtur, gjë që e bënë më të vështirë studimin shkencor të kësaj veprimtarie. Prandaj, mbledhja e të dhënave dhe dokumenteve për lëvizjen politike të rezistencës shqiptare në ish-Jugosllavi në përgjithësi dhe veprimtarinë atdhetare të të burgosurve politikë në Gjakovë me rrethinë në vitet 1945-1966 në veçanti, sot është punë e rëndësishme për opinionin dhe historiografinë shqiptare. (Dinaj 2009: 136).

Asnjë ngjarje në histori nuk është e rastësishme. Atyre iu prijnë një mori shkaqesh dhe rrethana. Edhe formimi i Grupit të Gjakovës i vitit 1957 i ka shkaqet e forta dhe të argumentuara të veprimit. Në

bazë të koncepteve themelore politike, në bazë të formave e mënyrave të organizimit dhe në bazë të metodave të veprimit, lëvizja ilegale në Kosovë kalon nëpër katër faza themelore, që nga viti 1945 e deri në vitin 1981 e tutje.

Këto faza edhe pse janë të veçanta, janë të lidhura organikisht në mes veti, qoftë me konceptet politike, qoftë me njerëzit që kanë udhëhequr (Çeku 2003: 266)

“Faza e parë përfshinë periudhën që nga viti 1945 e deri në vitin 1952”. (Çeku 2003: 267; Dinaj 2009: 267);

Faza e dytë përfshinë periudhën kohore në mes viteve 1958-1968.

Grupi i Gjakovës parqet ndërlidhje të rëndësishme në mes të fazës së parë dhe të dytë të lëvizjes ilegale në Kosovë.

Faza e tretë përfshinë periudhën kohore në mes viteve 1968-1981 dhe

Faza e katërt fillon në vitin 1981 dhe përfundon në fillim të viteve '90, me fillimin e pluralizmit në Kosovë dhe në viset shqiptare në ish-Jugosllavi.

Për shkak të kufizimit kohorë të trajtimit të kësaj teme në konferencë përveç të dhënave statistikore të nxjerra nga arkivi i Shoqatës së burgosurve

politikë dhe nga arkivat e ndryshëm si ai i Zagrebit, Kosovës etj. që do t'i japi në formën tabelare si më poshtë, do të përqendrohemi më tepër te Grupi i Gjakovës i vitit 1957, i cili dallon për nga specifikat e veçanta që ka në këtë periudhë kohore.

Të burgosurit politikë në Gjakovë me rrethinë në vitet 1945-1966

<b>Viti</b>	<b>Personat e dënuar</b>	<b>Vitet e burgut</b>
1945	2 vetë	8 vjet e 6 muaj (njëri i vrarë)
1946	5	46 vjet 11 muaj e 15 ditë
1947	8	20 vjet 11 muaj e 18 ditë
1948	2	8 vjet 2 muaj e 24 ditë
1949	14	67 vjet e 7 ditë
1950	4	12 vjet 6 muaj e 13 ditë
1951	4	14 vjet 8 muaj e 3 ditë
1952	11	50 vjet e 13 ditë
1953	11	62 vjet 9 muaj e 22 ditë
1954	6	16 vjet e 20 ditë
1955	8	54 vjet 4 muaj e 25 ditë
1956	4	13 vjet
1957	6	37 vjet 11 muaj 12 ditë
1958	1	1 vit
1959	4	10 vjet e 8 muaj
1960	1	3 vjet
1961	3	8 vjet 4 muaj e 26 ditë
1962	1	11 muaj
1963	5	5 vjet 6 muaj e 24 ditë
1964	8	37 vjet 6 muaj e 26 ditë
1965	1	2 vjet 11 muaj e 29 ditë
1966	1	7 muaj
<b>Gjithsej</b>	<b>110 vetë</b>	<b>483 vjet e 10 muaj</b>

#### **Rrethanat politiko-shoqërore që quan në krijimin e “Grupit të Gjakovës (1957)”**

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912), gjatë dhe pas Luftës së parë Botërore, Kosova u pushtua nga ushtri të ndryshme pushtuese, deri sa në vitin 1918 ra përfundimisht nën juridiksionin dhe pushtimin e mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, ku u çintegrua në disa banovina. Në mbretërinë e Jugosllavisë, pas vitit 1918, u hartuan projekte për copëtimin e shtetit shqiptar dhe në këtë kuadër për zhdukjen e qendrës tërheqëse për Kosovën e kosovarët. Përpjekjet për zbatimin e këtyre projekteve rezultuan për shumë arsye të pa suksesshme. Megjithatë ata nuk kaluan pa lënë gjurmë në mbijetesën e popullsisë shqiptare, për më tepër që shumë nga rrugët e mjetet për realizimin e tyre u përsëritën nga dhjetëvjeçari në dhjetëvjeçar: terrori, aneksimi, masakrat masive, dëbimi me

dhunë (shpërngulja) nga trevat e tyre për në Turqi e gjatë.

Nën pretekstin e shuarjes së “kundërrevolucionit” në Kosovë, Josop Broz Tito vendosi administrimin ushtarak më 8 shkurt 1945. Këtë veprim Tito e bëri me qëllim që ta fusë Kosovën nën një robëri të re dhe këtë e bëri duke e vendosur në krye të administrimit ushtarak Sava Dërleviqin një çetnik të tërbuar serb.

Në kohën kur forcat jugosllave zhvillonin operacionet më të përgjakshme në Drenicë, më 8 shkurt 1945, komandanti suprem i UNÇJ-së J.B.Tito me urdhër të veçantë nr.31 vendosi administrimin ushtarak në Kosovë. Këtë vendim Titoja e mori më 7 shkurt 1945 në Beograd, në një takim me ushtarakët serb: Savo Dërleviqin, Gjuro Medenicën dhe Kërsto Filipoviqin. Me këtë urdhër, i tërë pushteti në Kosovë do t'i kaloi një grupi të caktuar

ushtarakësh serbo-malazez, të cilët do të ushtronin pushtetin politik, ekzekutiv dhe atë gjyqësor.

Në këto ndërrime Fadil Hoxha si udhëheqës i Shtabit Operativ të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit zëvendësohet nga Sava Dërleviqi, detyra themelore e të cilit ishte ripushtimi i Kosovës nga ana e forcave jugosllave. (Çeku 2004: 26) Në këtë kohë Fadil Hoxha për një kohë ishte si të thuash i "burgosur shtëpiak" për rreth 6 muaj, prandaj ishte i pafuqishëm për të ndërmarrë diçka. (Koshi 2009, deklaratë)

Sava Dërleviqi, në pranverë të vitit 1945 me njësitet partizane vranë e masakruan mbi 4000 vetë dhe dogjën mbi 20 fshatra në Drenicë. Në Tivar, më 1 prill 1945, gjithashtu u vranë dhe u masakruan mijëra shqiptarë të cilët ishin të mobilizuar. Kjo ngjarje në histori njihet me emrin "Masakra e Tivarit".

Rreth numrit të shqiptarëve të vrarë në masakrën e Tivarit kemi të dhëna kontradiktore. Sipas raportit të Shtabit të Divizionit të 46 të Serbisë, i datës 8 prill 1945 numri i të masakruarve është treguar shumë i zvogëluar, rreth 450 të masakruar dhe rreth 120 të plagosur. (Pirraku 1992: 132; Dinaj 2010: 53).

Shqiptar vrasësi Aleksandër Ranković në Kongresin themelues të PK të Serbisë, në maj të vitit 1945 këtë numër e tregoi edhe më të vogël afër 300 vetë. (Pirraku 1992: 132).

Burimet shqiptare flasin për një numër tjetër, shumë më të saktë. Në raportin e Imer Berishës për Hadsonin, më 22 tetor 1945, vihej në dukje se në Tivar serbosllavët komunisto-çetnikë, masakruan për një ditë dhe një natë gjithsej 1670 veta. (Pirraku 1992: 132) Kështu del se Tivari është varri më i madh në Ballkan i hapur vetëm për një orë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Serbia aneksoi Kosovën në Konferencën e KNÇ të Kosovës e të Dukagjinit të mbajtur më 8-10 korrik 1945 në Prizren. Në këtë konferencë morën pjesë 142 delegatë të ftuar, shumica e të cilëve ishin serbë e malazezë. Kuvendi i filloi punimet në rrethana të jashtëzakonshme me ç'rast miratoi Rezolutën, e cila u hartua kohë më parë, në Beograd. Të gjithë ata që patën guxim të kundërshtojnë një akt të tillë u likuiduan ose u dënuan me burgime të gjata e të rënda.

Sipas dëshmive të Fadil Hoxhës, Xhavit Nimanit, Ymer Pulës, Shaban Kajtazit dhe Xhevdet Hamzës të dhëna më 25 dhe 26 qershor 1990, delegatët e Kuvendit të Prizrenit u caktuan "nga lartë", zgjedhja e këtyre për këtë seancë u bë pa procedurë zgjedhore, në rrethana të administrimit ushtarak e policor. Po ashtu sipas tyre, ishte vendosur që Seanca të mbahej pa u diskutuar fare çështja dhe

pa procesverbal, përkatësisht pa deklaram personal për Rezolutën por vetëm me aklamacion dhe nënshkrim të Rezolutës veç e veç. (Nimani, 1990, informatë. Dinaj, 2010: 56).

Rreth pjesëmarrjes në Kuvend kemi vetëm një dokument burimor, të publikuar nga Dr. Jusuf Bajraktari i cili në fakt është një listë e shkruar serbisht, me titull: "Mysafirët dhe delegatët", ku figurojnë 137 emra.

Prej tyre 32 janë shqiptarë. Në dokument thuhet se prej numrit të përgjithshëm (137 veta) 22 ishin "përfaqësues të popullit"- që mund të konsiderohet se ishin ish-anëtarë dhe këshilltar të "Kuvendit Themelues të KANÇ-së së Kosovës dhe Dukagjinit në Bujan 31 dhjetor 1943- 1,2 janar 1944. (AIHK, LNÇ-KK, dokument)

Aksioni i mbledhjes së armëve filloi në dimrin e vitit 1955 dhe vazhdoi deri në pranverë të vitit 1956. Aksioni për mbledhjen e armëve ishte pjesë e platformës për dhunimin e dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre. Duke qenë se kjo platformë nuk ishte e lehtë për t'u realizuar ndër shqiptarët, të cilët për kurajo civile e ndjenja të forta kombëtare, e donin Kosovën dhe ishin të gatshëm të sakrifikonin dhe jetën për të, qarqet ekstremiste serbe fabrikuan shpifjet dhe përdorën dhunën **për të krijuar ankth, frikë e pasiguri të përhershme te popullsia shqiptare e Kosovës**. Thashethemnjaja se "shqiptarët po përgatiteshin për një kryengritje të madhe për t'u bashkuar me Shqipërinë" u shndërrua në akuzë shtetërore ndaj nënshtetasve jugosllavë me kombësi shqiptare në Kosovë. U deklarua zyrtarisht se Kosova ishte "një ndër rajonet më të rrezikshme në vend", ku "përgatitej puçi" dhe prandaj "duhej të çarmatosej armiku" (Rilindja, maj, shtator, tetor, 1966). E që akuza të bëhej më e besueshme për opinionin publik, në shënjestër u vunë shqiptarët e atyre krahinave që ishin shquar për ndjenjat e tyre patriotike, për qëndresë ndaj regjimit komunist serb e ndaj pushuesve të huaj. Nuk është e rastit që fillimisht aksioni i mbledhjes së armëve filloi në malësinë e Rugovës, dhe u shtri në rajonet e spikatura për qëndresë kundër dhunës serbe, si në Smirë, Logjë, Vrellë, Rakoshë, Suharekë, Sërbicë, Krushë, Kllokot, Shalë etj. (AHRGJ: Raporti i Komisionit)

Një qëllim tjetër i Aksionit të mbledhjes së armëve ishte **nxitja e shovinizmit etnik në Kosovë**. Duke i paraqitur shqiptarët si një popullsi e rrezikshme, nxitej te serbët e malazezët në Kosovë urrejtja ndaj shqiptarëve dhe frika ndaj tyre.

Së fundmi, por jo së paku, shqiptarët e keqtrajtuar apo të tjerë që ishin dëshmitarë të ngjarjeve dhe atmosferës së rënduar e armiqësore, **të detyroheshin të largoheshin nga Kosova**. Pikërisht

ky ishte qëllimi final i Aksionit të mbledhjes së armëve.

Aksioni i mbledhjes së armëve është nxitur, organizuar e zbatuar nga ana e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror në Krahinë me dijeninë dhe pëlqimin e organeve republikane federative të sigurimit shtetëror, por deri në njëfarë shkalle edhe strukturave të larta politike, të cilat janë mbajtur në informim të vazhdueshëm e të plotë. Fillimisht eksponentë të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror mbajtën mbledhje me të gjithë komandantët e policisë së komunës së Gjakovës, siç ishin Mirk Iliqi, Milaim Gazetoviçi etj.; me policët dhe punonjësit operativë; hartuan planin operativ; dhe përcaktuan gjithë hapat konkretë për implementimin e tij. Në këtë ndërmarrje famëkeqe u thirrën policët fizikisht më të fuqishëm e më të pamëshirshëm. Ata i kishin duart e lira të bënin ç'të donin me popullsinë e akuzuar shqiptare.

Pasi u mor pëlqimi edhe i klasës politike në nivel komune, aksioni filloi në Gjakovë e në fshatrat rreth saj njëkohësisht. Fillimisht u organizuan mbledhje me shqiptarët për dorëzimin e armëve, që u shoqëruan menjëherë me kontrollet e bastisjet nëpër shtëpi. Në stacionet e policisë u thirrën shqiptarët më markant (të njohur), prej të cilëve është kërkuar të dorëzohen armët. Ata që kanë kundërshtuar janë keqtrajtuar, disa më shumë e disa më pak. Ky ishte momenti fillestar paralajmërues për të frikësuar të tjerët që të kuptonin se nuk mund të fshihnin armët.

### **Veprimtaria e Grupit të parë ilegal në Gjakovë**

Pikërisht në këtë kohë kur qeveritarët jugosllavë mendonin se ia kishin arritur qëllimit të tyre që me metoda dhe mjete dhune të detyronin shqiptarët të ulnin kokën dhe të mos guxonin as të flisnin ndonjë fjalë kundër atij sistemi dhe asaj dhune antishqiptare, megjithatë një grup intelektualësh dhe punëtorësh në Gjakovë u bashkuan dhe u morën vesh për të vepruar dhe për t'ia bërë të njohur jo vetëm popullit të tyre, por edhe Jugosllavisë e me gjerë se shqiptarët kurrë nuk mund të pajtohen me një dhunë të tillë dhe ndjenja për liri dhe bashkim kombëtar kurrë nuk është shuar e as që do të shuhet ndonjëherë prej tyre.

Si pasojë e këtyre rrethanave në vitin 1956 u formua grupi ilegal në Gjakovë prej pesë anëtarëve aktiv dhe disa të tjerë që iu jepnin ndihma të ndryshme. Anëtarët e atij grupi ishin: Muhamet Brovina, kryetar, Adem Krasniqi, Besnik Koci, mësues, Gjon Shtufaj dhe Hyda Dobruna, mësues. Gjatë asaj kohe, siç tregonte në një bisedë Besnik Koci para dy vitesh, "ne e kishim hartuar programin tonë për punë dhe veprim. Si bazë për programin tonë na shërbente Programi i Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit, sipas të cilit kërkohej bashkimi kombëtar. Pas bisedave dhe konsultave të shumta, kishin vendosur që ta kryenin një aksion që do të bënte jehonë jo vetëm te ne por edhe më gjerë për t'iu bërë të ditur pushtuesve dhe më gjerë se populli shqiptar kurrë nuk do të pajtohej pa u zgjidhur përfundimisht çështja shqiptare në Ballkan". (Koci 2010, deklaratë)

Si datë të aksionit kishin caktuar 1 majin e vitit 1957. Kishin blerë dy topa pëlhurë, një të kuqe dhe një të zezë dhe Muhamet Brovina në shtëpinë e tij i kishte qepur disa flamuj. Në mes të natës 30 prill dhe 1 maj të gjithë anëtarët e grupit ishin mobilizuar për t'i ngritur flamujt kombëtar nëpër vende të dukshme të qytetit të Gjakovës. Adem Krasniqi dhe Gjon Shtufaj e vendosën një flamur në Fushë të Sahatit, në qendër të qytetit. Besnik Koci dhe Hyda Dobruna e vendosën një flamur përballë stacionit të ndërtesës së vjetër të policisë në Gjakovë. Ashtu si shënohet edhe në aktakuzë, flamujt ishin ngritur edhe në Mëhallë të Vokshit, në Mëhallë të Hadumit, në Mëhallë të Gërçarëve, në Mëhallë të Qerimit si dhe në përmendoren e Heroit të popullit Mustafa Bakia, në Mëhallë të Sefës.

Rreth përmendores së Mustafa Bakisë i kishin shkruar edhe gjashtë parrulla "armiqësore", me këtë përmbajtje:

"Poshtë Partia Komuniste e Jugosllavisë!"

"Rroftë Partia Komuniste e Shqipërisë!"

"Rroftë flamuri shqiptar i cili është rrënjësor në zemrat e çdo shqiptari"

"Popull shqiptar, zgjohuni dhe kërkonit të drejtat tuaja!"

Poshtë PK e RFSJ-së okupatore e popullit të Kosovës e Metohisë!"

Vlen të theksohet se vëllai i Adem Krasniqit, më 18 qershor të vitit 1957 kishte vendosur një flamur kombëtar në trenin që shkonte nga Peja në drejtim të Fushë Kosovës dhe kjo ishte bërë për ta përcjell mesazhin e tyre edhe nëpër viset e tjera të Kosovës ashtu sikurse ndodhi në realitet; në të gjitha viset e Kosovës formoheshin grupet ilegale, që nuk pushuan deri në çlirimin definitiv të Kosovës.

Përmbajtja e këtyre parullave tregonte se ky grup ishte i vendosur për veprim dhe kishte një program të qartë kombëtar.

Pas aksionit, pjesëtarët e këtij grupi shpejt u hetuan nga organet e sigurimit shtetëror jugosllav dhe më 17 dhe 18 qershor të vitit 1957 u burgosën. Pas hetimeve të gjata, më në fund më 20 shkurt të vitit 1958 u organizuan gjykimi i tyre në Gjykatën e qarkut në Pejë. I tërë trupi gjykues përbëhej nga gjyqtarë serbë: Vidak Petroviq, si kryetar kolegji.

Trupi gjykues iu shqiptoi dënime mjaft të rënda grupit në fjalë:

1. Muhamet Brovina, i lindur më 1920, u dënua më 12 vjet burg të rëndë
2. Adem Krasniqi, i lindur më 1929, u dënua me 7 vjet burg të rëndë
3. Gjon Shtufaj, i lindur më 1932, u dënua me 7 vjet burg të rëndë
4. Besnik Koci, i lindur më 1934, u dënua me 9 vjet burg të rëndë
5. Hyda Dobruna, i lindur më 1933, u dënua me 5 vjet burg të rëndë

Siç tregonin Besnik Koci dhe Hyda Dobruna, rruga e burgjeve të tyre tregon një odisejadë të tërë vuajtjesh dhe peripecish. Në fillim i fusin në burgun e Gjakovës, pastaj në bodrumet e burgut të Pejës, në Mitrovicën e Sremit, në burgun qendror (të njohur si CZ) të Beogradit, në katin e tretë të nëndheshëm të atij burgu, nëpër burgjet e Kroacisë dhe më në fund edhe në burgun famëkeq të Nishit. Edhe pas kryerjes së dënimit, anëtarët e këtij grupi ishin të dënuar edhe me nga pesë vjet pa të drejta qytetare. Kjo nënkuptonte heqjen e të drejtës së punës, nuk guxonin të lëviznin apo të takoheshin me qytetarë. Prandaj i kaluan edhe nga pesë vjet si të burgosur shtëpiak.

Edhe pas kryerjes së dënimeve dhe daljes nga ato burgje, anëtarët e këtij grupi jo vetëm që nuk ranë në dëshpërim, por përherë ishin aktiv për realizimin e idealeve të tyre, prandaj edhe shumë herë të tjera kanë kaluar nëpër burgje të ndryshme. Ata me veprimtarinë e tyre shërbyen si shembull frymëzimi edhe për shumë breza që erdhën pas tyre.

### **Bibliografia**

#### 1. Burime arkivore.

Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës. Fondi- Sekretariat OK PK SK Kosova od 1966-1967g., fascila broj 121, Kutia nr.15, dosja nr. 18.

Arkivi Historik Regjional i Gjakovës. Fondi 88, Kutia Arkivore nr. I, (material intern), 1966 AIHK, LNÇ-KK-Dokument.

Arkivi i Shoqatës së burgosurve politikë të Kosovës, dega në Gjakovë, (dokumente relevante në vitet 1945-1966)

Arkivi Shtetëror i Zagrebit- Aktgjykime në vitet 1945-1966.

Arkivi i Beogradit,-Dokument aktgjykimi.

#### 2. Literatura

DINAJ, Shefqet (2009), Vështrime Historiografike shek. XIX-XX: *Lidhja e Historianëve të Kosovës 1945*. Prishtinë.

DINAJ, Shefqet (2010), *Skivjani- Historiku dhe trashëgimia kulturore*. Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Prishtinë.

ÇEKU, Ethem (2003), Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981: *Brezi 81*, Prishtinë.

ÇEKU, Ethem (2004), Shekulli i ilegales, (proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë- Dokumente): *Brezi 81*, Prishtinë.

NIMANI, Xhavit. (1990) Informatë në tribune e SHHK. Prishtinë.

PIRRAKU ,Muhamet. (1992) Ripushtimi jugosllav I Kosovës 1945. Prishtinë.

#### 3. Shtypi i kohës

Rilindja- 1966 (maj,shtator,tetor)

Vlen të theksohet se edhe dasma e martesës së Hyda Dobrunës u përdor si shkas nga qeveritarët e kohës për burgosjen e disa dhjetëra aktivistësh dhe veprimtarësh të çështjes kombëtare.

Më vonë kjo veprimtari vazhdoi. Më 28 nëntor 1963, i riu Ali Haxhi Hajdari-Nimanaj nga Skivjani vendosi flamujt kuq e zi në ambulancë, shkollë dhe në zyrën e vendit në Skivjan.

Gjatë ngritjes së flamurit në ambulancë, ishte i përcjell nga roja, i cili, shtiu me armë zjarri në Aliun por shpëtoi pa u plagosur. Flamujt i kishte siguruar nga Shqipëria.

Të nesërmen më 29 nëntor 1963 Aliu arrestohet në Gjakovë nga zyrtari i SPB-së Mirk Iliqi, i cili dënohet me dy vjet burg të rëndë.

Në shkurt të vitit 1964 arrestohet babai i Aliut, Haxhi Hajdari-Nimonaj po ashtu nga Mirk Iliqi i cili kurrë më nuk u kthye në familje. (Ahmeti, 2013,deklaratë)

### **Përfundim**

Të njëjtat dënime për "Grupin e Gjakovës (1957)" u dhanë edhe nga Gjyqi i Lartë Popullor i Republikës së Serbisë në Beograd, i përbërë nga gjyqtarët: Dragomir Miljković, si kryetar i gjyqit, Milke Jovanović, Vitomir Vashić, Dushan Arangjelović dhe Ljubivoje Dimitrijević, si anëtarë të gjyqit dhe referentit gjyqësor Dushica Stanishiq. (Dobruna 2013, dokument).



#### 4. Intervistat

- Koshi, Xhevat. Gjakovë 2009.
- Koci, Besnik. Gjakovë 2010.
- Rugova, Muhamet. Gjakovë 2010.
- Ahmeti, Sylejman. Gjakovë 2013.
- Nimonaj, Niman. Gjakovë 2013.
- Dobruna, Hyda. Gjakovë 2013.

## Çështje të përkthimit të eufemizmave dhe disfemizmave në tekstet letrare

Mirela PAPA  
Departamenti i Gjuhës Italiane  
Universiteti i Tiranës  
e-mail: [papamirela@yahoo.com](mailto:papamirela@yahoo.com)

### Hyrje

**Eufemizmi** është një figurë retorike, një fjalë apo shprehje që përdoret në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, të cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë. (Napoli 1995: 159)

**Disfemizmi** është edhe kjo një figurë retorike që konsiston në zëvendësimin, shpeshherë për shaka, të një fjalë me një tjetër që ka një konotacion negativ, por pa i dhënë ton fyes (p.sh. pleqtë për prindërit). (Blanco 1990: 192)

Natyrisht që janë arsyet psikologjike ato që e pengojnë dikë të shqiptojë një fjalë të caktuar dhe e bëjnë të kërkojë një fjalë a një shprehje më të zbutur. Ndonëse përdorimi i eufemizmave dhe disfemizmave është një fenomen jashtëgjuhësor, ato studiohen edhe në gjuhësi duke qenë se ushtrojnë veprimin e tyre edhe në gjuhë.

Në këtë studim kemi kërkuar të bëjmë një analizë semantike të eufemizmave, domethënë, pasojat dhe karakteristikat e një fenomeni të tillë në fushën e kuptimeve dhe mënyrën se si ato kuptohen nga ana e përkthyesit dhe jepen edhe në tekstet e përkthyer. Për të ilustruar shembujt se si janë përkthyer eufemizmat dhe disfemizmat e përdorura në tekstet letrare kemi marrë në analizë shembujt të nxjerrë nga tregimet dhe novelat e shkrimtarit italian Luixhi Pirandelo.

### Ndalimi gjuhësor

Me **ndalim gjuhësor** nënkuptojmë pamundësinë për të folur për një gjë të caktuar. Kjo pamundësi mund të jetë e imponuar nga jashtë apo mund të jetë edhe një faktor i brendshëm. Në njëfarë mënyre është një moment psikologjik. Ndërsa **eufemizmi** është fenomeni gjuhësor sipas të cilit shmanget përdorimi i disa fjalëve dhe ato zëvendësohen me të tjera.

**Tabuja** ka një përdorim të veçantë: bëhet fjalë për një ndalim për të kryer një veprim të caktuar, për të zënë në gojë një fjalë, për të përdorur një send etj., që zbatohet te fiset primitive dhe që nuk duhet të shkelet, sepse, sipas besëtytnive, ndëshkohet nga fuqitë e mbinatyrshme. Tabuja është, pra, një ndalim fetar primitiv.

Origjina e pengesave që e çojnë folësin tek autocensura e të shprehurit është gjithnjë e jashtme dhe shoqërore, rezultat i jetës në shoqëri. Pa dyshim, këto bëhen më pas pjesë përbërëse e personalitetit të individit.

Ndryshojnë nga një shoqëri tek tjetra dhe brenda fazave të ndryshme të zhvillimit të tyre. Ndryshojnë gjithashtu edhe sipas klasave shoqërore në ndikimin e kulturave dhe traditave. Ekzistojnë gjithashtu diferenca mes gjuhës mashkullore dhe femërore, ndonëse këto ndryshime zvogëlohen gjithnjë e më shumë me përfshirjen e gruas në botën e punës.

### Leksiku eufemistik

Për sa i përket klasifikimit të materialit të mbledhur i kemi ndarë termat në pesë grupe, që u korrespondojnë ndalimeve të llojit të ndryshëm në planin psikologjik: *ndalimi seksual*, *i mirësjelljes*, *magjiko-fetar*, *shoqëror*, dhe së fundmi *grindjet dhe goditjet*. Të gjitha këto kanë në bazë motive psikologjike që shpeshherë mund të përkojnë. (Blanco 1990: 194)

#### 1. Ndalimi seksual

Është ndoshta, së bashku me frikën magjiko-fetare pengesa më e fortë mes atyre që ndeshen në bazë të fenomeneve të ndalimit gjuhësor. Vepron në subkoshencën e individëve duke qenë rrënjësisht e ngulitur brenda individit. (Blanco 1990: 195)

#### 1.1 Bota e gruas

Historiku i fjalëve që rrotullohen rreth konceptit të «gruas» është plot me shprehje eufemistike. Virgjëria, përdhunimi, menstruacionet, shtatzania, lindja dhe aborti janë koncepte mbi të cilat ekzistojnë shumë terma ndalimi gjuhësor.

Në tregimet e Pirandelos del shpesh tema e polemikës kundër moralit seksual si edhe protesta kundër konceptimit primitiv dhe materialist të gruas. Për asnjërën prej protagonistëve Pirandello nuk do të përdorë fjalë qortuese, as edhe për ato që duken më fajtoreshë dhe egoiste, të gjitha viktimat të goditjeve të fatit, të paragjyqimeve të shoqërisë apo të mirësisë së ndjenjave të tyre.

Tema kaq të thella në veprën e Pirandelos si: nëna, familja (një ndër mitet e tij më të mëdha), prika, xhelozitë, nuk mungojnë as në tregimet e tij: «Janë me të vërtetë të pakta veprat e Pirandelos në të cilat në një mënyrë a në një tjetër të mos jetë trajtuar problemi i dashurisë, i familjes, i fëmijëve, i martesës» (Munafò 1968: 60)

Ferdinando Virdia (1993: 148) thotë: «Është e dyanshme sjellja e shkrimtarit tonë kundrejt gruas: në sfond ndihen paragjykimet më antike të shpirtit

ishullor, xhelozia e tërbuar dhe ndonjëherë teatrale, gruaja si objekt dhe si pronë (...). Me fjalë të tjera një sjellje tipike seksofobike e tetëqindës... dhe nga ana tjetër vihet re mosbesimi në aftësinë e rezistencës së vetë gruas ndaj sulmeve të mashkullit (dhe në fakt gruaja në narrativën dhe në teatrin e Pirandelos është gjithmonë e dorëzuar (e mundur).»

### 1.1.1 Shtatzania

Termi *shtatzani* (gravidanza), ndonëse me origjinë të lëvruar, është shumë i përdorur në gjuhën e përditshme. Në këtë mënyrë përdoret edhe në tregimet e Pirandelos ndonëse na del gjithashtu edhe termi *me barrë* (incinta). Ka gjithashtu raste edhe kur hiqet plotësisht termi:

- Non uscì più di casa, dacché comincì a parere... lei m'intende... (*In silenzio*)
- Nuk doli më nga shtëpia qysh kur nisi t'i dukej barku... Ju më kuptoni... (*Në heshtje*, f. 62, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)
- Ma rimasi incinta. (*L'altro figlio*)
- Por mbeta me barrë. (*Djali tjetër*, f. 165, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Po të vëmë re përkthimin e këtyre termave mund të themi që në rastin e parë kur termi i referuar shtatzanisë është shmangur nga ana e autorit, përkthyesi duke mos kuptuar qëllimin mospërdorimit të termit e ka shtuar duke bërë kështu një sqarim të tepërt dhe duke mos nxjerrë në pah synimet e shkrimtarit. Shprehja *të presësh një fëmijë* përdoret gjithashtu shumë shpesh.

### 1.1.2 Lindja

*Të lindësh* (partorire) është një term shumë i përdorur, ndonëse Pirandelo preferon ta zëvendësojë me *të nxjerrësh në dritë* (dare alla luce).

- Fui per morire quando lo misi alla luce... (*L'altro figlio*)
- Sa s'vdiqa kur e nxora në dritë... (*Djali tjetër*, f. 166, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
- Dopo il parto, però, ella non era voluta tornare in Calabria... (Nel segno)
- Mirëpo pas lindjes ajo nuk desh të shkojë në Kalabri... (*Në shenjë*, f. 33, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)

Për sa i përket përkthimit, përkthyesi e ka respektuar mënyrën e të shprehurit të shkrimtarit kur ai ka dashur të shmangë përdorimin e termi **1.2.2** «partorire».

### 1.1.3 Aborti

Është fjalë e ndaluar dhe lehtësisht e zëvendësueshme me të tjerat. Variante të zakonshme janë: *të ndërpresësh shtatzaninë, të çosh dëm një shtatzani*. Një mënyrë zëvendësimi është edhe i mëposhtmi:

- Intendeva ella forse di cancellare ogni traccia della colpa? (*In silenzio*)

- Mos kish ndër mend të shlyente çdo gjurmë të turpit? (*Në heshtje*, f. 63, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)

Ka raste kur gjejmë edhe shprehjen e mirëfilltë:

- (...) vedendo già in pericolo il podere, se la nuora abortiva... (*Scialle nero*)
- (...) duke parë tashmë në rrezik pasurinë po të dështonte nusja... (*Shalli i zi*, f. 34, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Për sa i përket përkthimit duhet të themi se përkthyesit i kanë dhënë saktësisht në gjuhën shqipe shprehjet që përdor shkrimtari për të shprehur idenë e abortit.

## 1.2 Organet seksuale

Një konstatim i parë është tepria e termave të cilët emërtojnë këto pjesë të trupit, emrat e të cilave, nga turpi, zakonisht aludohen përmes perifrimeve, metaforave dhe deformimeve fonetike, përdorimit të përemrave dhe emrave të përgjithshëm etj. Lidhur me këtë Martara Garavelli e cituar nga Blanco (1990: 199) thotë se: «perifrazimet eufemistike kanë një traditë të fortë, të rrënjosur te mirësjellja dhe tek respektimi i ndjeshmërisë së gjithsecilit, që përbëjnë edhe bazën e censurës verbale për fjalët të konsideruara të papërshtatshme.»

### Organet femërore

Mund t'i ndajmë në dy grupe: ato që kanë një ton shkencor dhe të lëvruar, të përdorur kur jane të domosdoshëm dhe termat që konsiderohen vulgare. Të parët nuk lënë gjurmë në veprën pirandeliane që kemi marrë në shqyrtim, duke qenë se janë shumë më të përdorur termat e ndaluar që u referohen pjesëve konkrete të trupit femëror, duke lënë disa pjesë të tjera tërësisht të harruara dhe të papërmendura.

Fjala *mammella* (sisë) nuk është fjalë vulgare megjithatë vuan pa dyshim nga njëfarë ndalim përdorimi kur flitet për gratë:

- Lo squallor di quella stanza, (...), dove balocciano tentatrici, a perpetuare l'inconcludente miseria della vita, due mammelle di donna (*Niente*)
- Pamja e shpëlarë e asaj dhome (...) dhe ku, për të përjetësuar mjerimin e pa fund të jetës, përhidhen grishëse dy sisë femre (*Hiç asgjë*, f. 88, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)

### Organet mashkullore

Një vërejtje e parë është mungesa në veprën e Pirandelos e emërtimeve të ndryshme për organet seksuale mashkullore.

Në shembullin e mëposhtëm, efekti tërësisht evokues i fjalës *cazzo* reduktohet përmes ndryshimit të disa fonemave.

- Cazzica, che testa! – esclamò lo Zirafa. (*La giara*)
- Djall o djall, ç'kaptinë! – thirri Xirafa. (*Qypi*, f. 263, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Fjala *corno* ndeshet në shprehjet tashmë të fiksuara në gjuhë:

- Non tirano un corno! (*La rallegrata*)
- Tërheqin gjë ata? (*Kërcim i hareshëm*, f. 142, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)

Në të rastin e parë gjatë përkthimit humbet aludimi ndaj organit seksual mashkullor. Në fakt është i saktë përkthimi nga ana e përkthyesit duke qenë se shprehjet italiane të cilat përmbajnë fjalën *cazzo* nuk përkthehen me ekuivalentin e këtij termi në gjuhën shqipe.

Në rastin e dytë shprehja e cila përmban fjalën *corno* duke qenë shprehje frazeologjike përkthehet me kuptimin e saj dhe jo me komponentët përbërës të shprehjes. Si rrjedhim në përkthim nuk gjejmë fjalën *bri*.

### 1.3 Marrëdhëniet seksuale

Kur bëhet fjalë për marrëdhënie seksuale më shumë sesa një ndalim verbal duhet të flasim për një ndjenjë turpi. Përveç turpit shihet edhe dëshira për të fshehur gjithashtu edhe disa ngjyime sentimentale. Dashuria, pasioni, butësia janë disa nga këto ngjyime sentimentale.

Ka raste kur nuk përdoren terma të qartë, por aludohet rreth marrëdhënieve seksuale. Një rast i qartë i heqjes së termit jepet në shembullin e mëposhtëm ku emërtohet marrëdhënia pa e përmendur direkt, në rastin e parë duke e hequr fjalën dhe në rastin e dytë duke e zëvendësuar me një përemër të vetës së tretë:

- E quei compagni d'ufficio, coi loro sudici discorsi e certe sconce domande che avrebbero volute avvilirlo di vergogna: "se e come faceva? se l'aveva mai fatto?" (*In silenzio*)
- Dhe ata shokët e zyrës, me bisedat e tyre të pahijshme, me thumba e me pyetje të poshtra mundoheshin ta ngacmojnë e ta turpërojnë; e pyesnin në i njihte femrat, në kish rënë ndonjëherë me ndonje femër. (*Në heshtje*, f. 69, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)
- No, non avrebbe potuto mai farlo, lui... (*In silenzio*)
- Jo. Kurrë nuk do të guxonte të shkojë me një femër... (*Në heshtje*, f. 70, «Jeta lakuriq», Çabej, Tiranë 1997)

Në tekstin e përkthyer vëmë re se përkthyesi duke mos e kuptuar qëllimin e autorit nuk mbetet thjesht tek aludimi, por shton fjalë për të sqaruar më tej situatën.

### 1.4 Prostitucioni

*Prostitucion* është fjalë e lëvruar dhe si e tillë nuk ndeshet në tregimet e Pirandelos. Ndeshemi në fakt me disa shprehje të tjera ekuivalente. Për fjalën *prostitutë* gjejmë sinonimet e mëposhtme:

- e le parve che non lei col suo atto violento avesse rotto il vetro della cornicetta, ma la stridula

risata di quella donnaccia. (*La maestrina Boccarmé*)

- dhe iu duk se nuk e kishte thyer ajo xhamin e kornizës së vogël, por e qeshura e çjerrë e asaj gruaje të ligë. (*Mësuesja Bokarme*, f. 134, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
- Scappa, scappa in chiesa, va' a chiederlo a quella tua Vergine parata come una sgualdrina! (*Dono della Vergine Maria*)
- Shko, shko në kishë, shko e lypi asaj virgjëreshës sate që më stoliset si lavire! (*Dhuratë e të Virgjërës Mëri*, f. 162, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- dove fino a tarda notte certe così dette canzonettiste (*Lo scaldino*)
- ku deri vonë natën, disa të ashtuquajtura këngëtare (*Mangalli*, f. 39, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)

Në shembullin e parë fjala *donnaccia* është përkthyer me tofjalëshin *grua e ligë*, tofjalësh që në gjuhën shqipe nuk i referohet domosdoshmërisht një *gruaje të përdalë* siç do të kishte qenë më mirë që të ishte përkthyer.

Në shembullin e dytë Pirandello e përdor shumë shpesh fjalën *sgualdrina* me një ngarkesë të fortë negative nga pikëpamja morale. Përkthimi i kësaj fjale me fjalën «lavire» në gjuhën shqipe e jep shume mirë këtë ngarkesë negative edhe në tekstin e përkthyer.

Në rastin e tretë fjala *canzonettiste* është përkthyer drejt me termin shqip *këngëtare*, por fjala këngëtare në gjuhën shqipe nuk e mbart edhe aludimin për një grua jo të mirë nga ana e moralit. Mbase futja e termit «*këngëtare*» mes thonjzash do ta kishte dhënë më mirë idenë e shkrimtarit.

### 2. Ndalimi i mirësjelljes

Së bashku me atë seksual, është ndalimi më i fortë që reflektohet në shoqërinë pirandeliane (në fakt ende sot në shoqërinë bashkëkohore). Pirandello, në përgjithësi i shmang emërtimin dhe përshkrimin e funksioneve organike si tretja dhe jashtëqitja, si edhe vendet ku ndodhin këto procese. Përdor normalisht shprehje të përgjithshme të llojit:

- (...) o scende a fare i suoi bisogni dietro al muro (*Il tabernacolo*)
  - (...) apo zbret për të kryer nevojat pas murit (*Tabernakulli*, f. 89, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
  - Perché è pure un piacere, (...) attendere tranquillamente, così, alla soddisfazione d'un piccolo bisogno naturale (*Niente*)
  - Sepse është kënaqësi të përmbushësh tërë qetësi një nevojë të vockël krejt të natyrshme... (*Hiç asgjë*, f. 78, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)
- Duke ekzistuar ky lloj ndalimi edhe në gjuhën shqipe është e lehtë për përkthyesin të kuptojë dhe

të japë edhe në tekstet e përkthyer idenë e shmangies së përdorimit të këtyre fjalëve nga ana e shkrimtarit. Shprehje eufemistike është dhe kjo më poshtë:

- Era ogni volta una terribile esplosione da tutte le parti; e spesso, tutto sgocciolante, doveva correre ai ripari con una mano davanti e l'altra dietro. (*L'Avemaria di Bobbio*)
  - Sado herë që teshtinte dëgjohej një shpërthim i llahtarshëm nga shumë anë dhe shpeshherë, plot qurra e jargë, duhej të nxitonte drejt ndonjë vendi të veçuar, duke mbajtur një rëndë dorë para e tjetrën mbrapa. (*Urata e Bobios*, f. 127, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Në këtë rast situata e përshkruar nuk është kuptuar siç duhet nga ana e përkthyesit dhe si rrjedhim nuk është krijuar i njëjti imazh i krijuar në tekstin original.

Këto shprehje mund t'i referohen gjithashtu disa funksioneve të kafshëve:

- i colombi e i piccioni della moglie s'affacciano titubanti a curiosare; grugano impauriti, scrollano il capo, a scatti, per sbirciarlo di traverso; poi si voltano, gli lasciano un segno della loro disapprovazione, e via. (*Acqua e li*)
  - pëllumbat e së shoqes vinë e afrohen mëdyshas për të vështruar ç'po ndodh; gugatin të trembur, shkundin kryet me lëvizje të prera, për ta vështruar vëngër, pastaj i kthejnë shpinën, i lënë një shenjë të mospëlqimit të tyre dhe ikin. (*Ujë dhe pikë*, f. 184, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
  - E di quelle disapprovazioni lí sono incrostate tutte le travi; ma sono il meno; (*Acqua e li*)
  - Dhe me ato mospëlqimet janë mbushur plot trarët, por janë e keqja më e pakët. (*Ujë dhe pikë*, f. 184, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Për qeniet njerëzore përmenden gjithashtu funksionet organike ku përemri tregues «atë» zëvendëson në mënyrë të qartë funksionin organik:
- Il vetturino intanto, rimasto fuori, smonta da cassetta e vuole prendersi la soddifazione di sbottonarsi i calzoni per far lí apertamente, al cospetto della vasta piazza deserta tutta intersecata dai lucidi binarii delle tramvie, quel che di giorno non è lecito senza i debiti ripari. (*Niente*)
  - Ndërkohë, karrocieri, që ka mbetur jashtë, zbrit nga karroca dhe bëhet gati të zbërthejë pantollat që ta bëjë aty krejt haptazi, mu në mes të sheshit të gjerë të shkretuar, të cilin e përshkojnë binarët e shkëlqyer të tramvajeve, atë që njeriu nuk mund ta bëjë ditën pa gjetur ndonjë cep të përshtatshëm. (*Hiç asgjë*, f. 78, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)

Në të gjithë shembujt e mësipërm përkthimi është i saktë dhe imazhi i krijuar është i njëjtë me atë të tekstit original.

Ndalime të tjera të mirësjelljes janë edhe *të vjellët* dhe *të vjellësh*, për të cilat gjejmë zëvendësimet e mëposhtme:

- Ora non poteva veder neanche da lontano un pezzo di zolfo che subito, con rispetto parlando, non si sentisse rompere lo stomaco. (*Il fumo*)
  - Tani as së largu nuk shikonte dot një copë squfuri, sepse, menjëherë, - me nder me thënë – i pështillej barku e i vinte për të vjellë. (*Tymi*, f. 55, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
- Në këtë rast përkthyesi në tekstin e përkthyer nuk e ka shmangur, ashtu si Pirandello, përdorimin e fjalës së ndaluar *të vjellët*.
- Gromësira*, gjithashtu është objekt ndalimi:
- (...) accomodò la bocca ad o, come fanno le scimmie, e mandò fuori un po' d'aria (*L'Avemaria di Bobbio*)
  - Bobio mbylli sytë, rrumbullakoi gojën siç bëjnë majmunët, dhe mori frymë. (*Urata e Bobios*, f. 131, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Në shembullin e mësipërm shprehja e përdorur nga Pirandello për të zëvendësuar fjalën *gromësi* nuk është kuptuar nga ana e përkthyesit dhe është përkthyer gabim në gjuhën shqipe.

### 3. Ndalimi magjiko-fetar

Pirandello, përpos protestës kundër mënyrës së jetesës siciliane, e shtrin kritikën e tij kundër të gjithë sistemit borgjez të epokës dhe në mënyrë të veçantë të shoqërisë siciliane, e cila është shndërruar në pre e skemave, e traditave dhe konvencionalizmave të saj. (Blanco 1990: 211)

Në këtë kritikë ka një vend edhe për fenë, jo vetëm për atë katolike. Kisha është vendi i gënjeshtreve, konstaton Pirandello që nga fëmijëria e tij e hershme *Zoja prej dylli* (La madonnina) dhe në të predikohet hipokrizia më e pabesueshme *Besimi* (La fede). «Nuk mund të thuash se Pirandelos i ka munguar besimi; por Zoti është për të ajo Gjithçkaja misterioze dhe e papërcaktuar e botës, që njerëzit nuk do të arrijnë kurrë ta njohin, ajo Rrjedha jo materiale dhe e përjetshme e Jetës, që njerëzit e vrasin kur pretendojnë ta burgosin në Forma, domethënë në besimet e ndryshme, të cilat pikërisht për këtë janë aspekte «jo të vërteta» të Zotit dhe iluzione të mjerueshme – si ato të Krishtërimin – (...) (Munafò 1968: 56)

#### 3.1 Ndalimi fetar

Është një fenomen i përbashkët për të gjitha besimet ajo që të mos e përmendin emrin e Zotit. Në italisht, ndonëse ekziston urdhëresa katolike që e ndalon këtë gjë, është përkundrazi diçka e shpeshtë dhe e përhapur. *Signore* në vend të *Dio* është një metaforë që ndeshet në gjuhë dhe kultura të ndryshme. Ka shumë pasthirrma në

gjuhën italiane që shoqërohen nga fjala *Dio* (Zot). (Blanco 1990: 212). Këto pasthirrma drejtuar Zotit, Virgjëreshës, ëngjëjve, shenjtorëve janë pothuajse gjithmonë shprehje habie, frike, gëzimi, shqetësime, dhimbjeje, ku ndjenja fetare në një pjesë të mirë është harruar. Të shikojmë të ilustruara disa nga këto shprehje:

### 3.1.1 Shprehje inati, zemërimi:

- Ti dico che non mi posso calare, santo Dio! (*Marsina stretta*)
- Të thashë që nuk mund të ulem, dregi e mori! (*Fraku i ngushtë*, f. 175, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- ne afferrò uno per la gola e lo impiccò al muro gridando: - Sangue della Madonna, me la pagherete! (*La giara*)

- mbërtheu njërin për gryke dhe e ngjeshi në mur, duke u çjerrë:  
Për giakun e Zonjës Shën Mëri, do të ma paguani shtrenjtë! (*Qypi*, f. 261, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Në të dyja rastet përkthimi është i saktë në gjuhën shqipe dhe vihet re mirë se në shembullin e parë shprehja e përdorur nuk e ka brenda fjalën *zot*.

### 3.1.2 Shprehje frike, druajtjeje

- S'inchinò goffamente. – Oh Dio! Daccapo la marsina (*Marsina stretta*)
  - U përkul me siklet. (O Zot, setra iu shqep edhe më shumë...) (*Fraku i ngushtë*, f. 171, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
  - Oh Dio, Titti, ch'è stato? (*Filo d'aria*)
  - Zot, ç'ka ndodhur, Titi? (*Një fill ere*, f. 192, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
  - Madonna! – gridò Mamm'Antò. E che avete fatto, santo cristiano? (*Prima notte*)
  - Shën Mëri! – thirri nëna Antò. – Ç'paske bërë, o i bekuar? (*Nata e parë*, f. 19, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Në të tre shembujt përthimi është i saktë nga ana e përkthyesit.

### 3.1.3 Shprehje shqetësimi:

- Dio, Dio, mi sento mancare il fiato! (*La maestrina Boccarmé*)
  - Zot, më duket sikur më zihet fryma! (*Mësuesja Bokarme*, f. 124, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
- Në këtë rast në tekstin e përkthyer nuk është dhënë përsëritja e fjalës *Zot*.

### 3.1.4 Shprehje habie, çudie:

- per l'amor di Dio, signor Trockley, che vi è accaduto? (*Il capretto nero*)
- Pash hatrin e Zotit, ç'të ka ndodhur, zoti Trokli? (*Keci i zi*, f. 152, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
- Apriti cielo! (*Acqua e li*)

- Hapu qiell! (*Ujë dhe pikë*, f. 185, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)

Përkthim i saktë për të gjithë shembujt e mësipërm.

### Shprehje të tjera

- Dio ti paghi la carità, e la Bella Madre Santissima. (*L'altro figlio*)
- Zoti dhe Zonja Shën Mëri, e bukura dhe e shënjta Shën Mëri, ta shpërblefshin mundimin. (*Djali tjetër*, f. 151, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
- No! che dice mai! - scattò la vecchia signora, stupita, offesa. - Oh Signore Iddio! Con la morta in casa? (*Marsina stretta*)
- Jo-o. Ç'thoni ashtu? – kërceu e tha zonja plakë, e habitur dhe e fyer. – O Zot i madh, me të vdekurën në shtëpi? (*Fraku i ngushtë*, f. 173, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Nove figliuoli, Cristo sacrato, nove figliuoli che mi piangono per il pane! (*Il fumo*)
- Nëntë fëmijë, Krisht i shenjtë, nëntë fëmijë që më qajnë për bukën e gojës! (*Tymi*, f. 70, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

### 3.2 Ndalimi si pasojë e bestytive

Ky lloj ndalimi është subjekt ndryshimesh si pasojë e evolucionit të traditave, zakoneve. Edhe në një moment kronologjik të përcaktuar ndryshon sipas shoqërive. Te Pirandelo është shumë më frekvente prania e këtij ndalimi verbal në tregimet e tij të ambientuara në zonat rurale, sidomos ato siciliane, sepse bëhet fjalë për një shoqëri e cila është e rrenjosur në traditat e saj, në frikërat e saj dhe bindjet magjiko-fetare. Mortara Garavelli e cituar nga Blanco (1990: 218) pohon: «Një tjetër instrument i fuqishëm që bën të shpërthejë censura verbale është frika, e lidhur me bindjet fetare të fuqisë së fjalës: frika e evokimit të ndikimeve të këqija nëse përmend qenien apo ngjarjen të cilës i druhesh. Këto lloj perifrazimesh i përkasin, apo janë ngushtësisht të lidhura me përgjërimitin dhe mallkimin.»

Një rast ndalimi që vepron ende në realitetin aktual është ai i foljes *mallkoj* (dhe fjalët që rrjedhin nga ajo *i mallkuar, mallkim*), të zëvendësuara përmes një rasti antiteze me foljen *bekoj*:

- E allora andate a farvi benedire. (*Il fumo*)
- Atëherë i kini larë duart! Ç'kërkoni prej meje? (*Tymi*, f. 89, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Vihet re se në përkthim përkthyesi ka bërë një përkthim të kuptimit semantik të shprehur përmes këtij eufemizmi. Semantikisht përkthimi është i saktë, por ka humbur antiteza e shprehur nga shkrintari.

Në shoqërinë fshatare ky lloj ndalimi është më i përdorur se në atë qytetare. Bëhet dëshmi e mallkimeve drejtuar dikujt:

- Signor giudice, non mi tocchi! Se ne guardi bene! Q lei, com'è vero Dio, diventa cieco! (*La patente*)
- Mos më prekni, zoti gjykatës! Ruajuni! Përndryshe, Zoti që është një, do të verboheni! (*Dëshmia*, f. 35, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)

### 3.3 Vdekja

Frika nga vdekja është pasqyruar gjithmonë në një mospërdorim verbal që në shoqëritë më të lashta. Është, padyshim, më e përdorura nga Pirandelo për arsyet e shpjeguara më lart dhe që lidhen me bestytnitë. Mes kritikëve të Pirandelos ka ndonjë i cili vëren se personazhet e Pirandelos vdesin papritur në mënyrë të dhunshme. Fjalët *vdekje*, *vdes* dhe *i vdekur* përdoren shumë në veprën e Pirandelos. Sinonimet e saj ndonjëherë janë eufemizma të qartë që shërbejnë për të zbutur idenë e vdekjes përmes përdorimit metaforik të kuptimit të saj:

- (...) questo fulmine a ciel sereno (*Marsina stretta*)
- (...) por kjo rrufe në mot të kthjellët... (*Fraku i ngushtë*, f. 171, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- (...) fatalità crudele (*Marsina stretta*)
- Një fatalitet zemërgur... (*Fraku i ngushtë*, f. 172, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- (...) grave sciagura (*Marsina stretta*)
- (...) kjo mynxyrë e rëndë (*Fraku i ngushtë*, f. 173, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)

Janë dhënë shumë bukur në tekstet e përkthyer të gjitha eufemizmat e përdorur nga shkrimari. Kjo sepse edhe tek ne ekziston ky lloj ndalimi verbal dhe ekuivalentet shqip të fjalëve të përdorura nga Pirandello e bartin aludimin ndaj këtij fenomeni të trishtë ndonjëherë të pashmangshëm të jetës njerëzore.

Në shumë raste, bëhet fjalë për shprehje tipike të njëfarë gjuhe zyrtare dhe burokratike. Gjejmë gjithashtu edhe kontekste më modeste kur nuk mund të përdoren fjalë të ashpra në rrethana të trishta.

Në kundërshtim me këto eufemizma Pirandelo përdor edhe disa disfemizma, ndonjëherë cinike:

- Anche lui... eh, poco più potrà tirare (*L'imbecille*)
- S'e ka të gjatë edhe ai. (*Teveqeli*, f. 25, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
- ...e quella brutta bestiaccia non si risolveva a crepare (*Il fumo*)
- ...dhe ajo kafshë e shëmtuar nuk i ipte karar të ngordhë (*Tymi*, f. 68, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Janë dhënë saktë edhe në tekstet e përkthyer këto disfemizma të përdorur.

Për fjalën *varr* përdoret *fossa* (gropë).

- Don Lisi, chino su la fossa della prima moglie, singhiozzava: (*Prima notte*)

- Don Lizi, i përkulur përmbi varrin e gruas së parë, po dëneste: (*Nata e parë*, f. 25, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)

*Cimitero* (varrezë) përdoret shpesh, dhe ndonjëherë zëvendësohet nga fjala *camposanto*:

- Ella stette con gli occhi nascosti nel fazzoletto, finché la vettura non si fermò davanti al cancello del camposanto. (*La corona*)
  - Ajo ndenji duke shtrënguar sytë me shami, derisa karroca ndali para portës së varrezave. (*Kurora*, f. 146, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
- Në gjuhën shqipe nuk kemi dy fjalë për të emërtuar varrezat, prandaj të dy termat do të përkthehen në të njëjtën mënyrë.

### 3.4 Sëmundja

Frika se mos bëhesh viktimë e një sëmundjeje është, në shumicën e rasteve, shkak që të mos duash të përmendësh emrin e kësaj të keqeje. Mëtohet të mos thirren me emrin e tyre faktet negative, të dhimbshme; fatkeqësitë, sëmundjet, vdekja dhe bëhen, kështu, objekt i perifrimeve eufemistike. (Blanco 1990: 223)

Vetë fjala *sëmundje* ngjall shpesh alarm dhe frikë. Për ta evituar do të përdoren terma të tjerë si: *pamundësi* (indisposizione), *e keqe* (male) etj. Në të njëjtën mënyrë për një person të sëmurë do të thuhet *nuk është mirë ose i pamundur ose pa qejf* etj.

Të përmendësh sëmundjet vdekjeprurëse është thujse një sfidë për atë që guxon ta bëjë. Si e keqe endemike vazhdon të tregohet fjala *kancer*, ndonjëherë e zëvendësuar nga term tjetër më pak i ndaluar *tumor*:

- Ce grand saint Augustin attesta, o diciamo, autentica d'aver veduto, su le reliquie di San Gervasio e Protaso a Milano, un fanciullo cieco riacquistare la vista; una donna a Cartagine, guarire d'un cancro col segno della croce fattovi sopra da una donna di recente battezzata... (*L'Avemaria di Bobbio*)

- Ce grand Saint Augustin na pohoka, apo më mirë na vërtetoka se paska parë një fëmijë të verbër, të cilit i qenkej kthyer të parit; pastaj edhe një grua nga Kartaxhine që qenkej shëruar nga kanceri meqë, mbi vendin ku kishte të keqtë, na i paskësh bërë shenjën e kryqit një grua e sapopagëzuar... (*Urata e Bobios*, f. 131, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)

Lidhur me sëmundjet mendore ekziston gjithashtu një ndalim verbal. Të konsideruara shumë të rënda, prodhojnë gjithashtu një ndjenjë tmerrri dhe frike. Kështu, në vend të *i çmendur*, do të gjenden zëvendësues më zbutur nga ana semantike:

- (...) era una povera svanita di cervello (*La Madonnina*)
- ...një qyqares që i kishte marrë koka erë (*Zoja prej dylli*, f. 30, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)

- (...) l'innocenza della povera scema (*La Madonnina*)
  - ... pafajësinë e budallaqes së shkretë (*Zoja prej dylli*, f. 31, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)  
Në tekstet e përkthyer janë dhënë shumë mirë të gjitha këto shprehje eufemistike të përdorura nga shkrimtari.
- 4. Ndalimi shoqëror**
- Ankthi për t'u ngjitur në shkallën shoqërore, për t'u dukur më shumë se sa je, reflektohet në ndryshimet e profesioneve, detyrave, karrierave. Kështu për fjalën *shërbëtore* preferohet të përdoret *gruaja e shërbimeve* apo thjesht *gruaja*.
- (...) mandate per la donna di servizio (*Acqua e li*)
  - ... që m'i dërgonte me shërbëtoren (*Ujë dhe pikë*, f. 186, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)  
Në tekstin e përkthyer nuk është mbajtur parasysht nga shkrimtari kjo mënyrë të shprehurit e Pirandelos, por është zëvendësuar me atë që fjalë që shkrimtari ka dashur ta shmangë.  
Në këtë lloj ndalimi verbal mund të përfshijmë edhe atë që u referohet disa defekteve apo veseve njerëzore, si ato fizike ashtu edhe ato morale. Kështu, gjejmë zëvendësues eufemistikë për «qorr» apo «shurdh» me «i privuar nga shikimi» dhe «që nuk shikon (apo nuk dëgjon) mirë» etj. Herë të tjera disfemizmi është i egër:
  - Mandate për Sidoro l'orbo... Chitarre e mandolini!" (*Prima notte*)
  - Dërgoni e thërritni Zidor qorrin... Duam kitarra e mandolina! (*Nata e parë*, f. 20, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)  
Mosha e një personi mund të fshihet me zëvendësuesit eufemistikë. Kështu nuk preferohet të përdoret fjala *plak*, por zëvendësohet shpesh nga *i moshuar*, *me njëfarë moshe* etj.  
Ndër të ashtuquajturit *defekte morale* shohim se si imoraliteti seksual, veçanërisht tek gruaja, gjen eufemizma të shumtë dhe të ndryshëm:
  - fuggito due anni dopo in America per ragioni delicatissime, di cui è meglio non far parola. (*Un "goj"*)
  - dy vjet më vonë, ia mbathi në Amerikë, për arsye fort delikate, për të cilat është më mirë të mos bëjmë fjalë. (*Një "goj"*, f. 136, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)  
Në këtë shëmbull aludimi ndal imoralitetit seksual bëhet shumë i qartë pas njohjes së përmbajtjes së tregimit. Në përkthim është dhënë shumë saktë eufemizmi origjinal.
- 5. Grindje dhe goditje**
- Do të përfshijmë këtu diçka që e konsiderojmë të rëndësishme duke parë numrin e madh të shprehjeve që ka italishtja për t'iu referuar zënkave dhe pasojave të tyre. Në shumë raste bëhet fjalë për disfemizma që i përkasin të folurës familjare. Për grindjet kemi të përdorura disa fjalë:
- Ma sí, scusi! Un ferimento in rissa, una tegola sul capo, una disgrazia qualsiasi... prestare aiuto, chiamare il medico, lo capisco. (*Niente*)
  - Ja ashtu! Një plagosje gjatë një zënke, një tjegull në kokë, një fatkeqësi gjithsesi... t'i japësh ndihmë, të kërkosh mjekun, e kuptoj. (*Hiç asgjë*, f. 82, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)
  - L'appaltatore dell'illuminazione è in lite col Comune: da piú mesi non gli danno un soldo (*Certi obblighi*)
  - Sipërmarrësi i ndriçimit po grindet me Komunën, ka disa muaj që s'i ka dhënë asnjë dysh (*Disa lloj detyrimesh*, f. 161, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)  
Për goditjet:
  - Mi venne di prenderlo a schiaffi. (*Le sorprese della scienza*)
  - Më erdhi t'ia këputja turinive. (*Befasitë e shkencës*, f. 103, «Tregime dhe novela», Dituria, Tiranë 1999)
  - ...le ha dovuto dare col piede, per giunta, una buona acciaccata sotto il banco. Basta. Un gran pugno allungato dentro la tuba, che per miracolo non la sfonda (*Niente*)
  - ...do ta ketë shkelur me këmbë poshtë banakut. Mjaft. Një grusht kapeles, që nuk shqyhet për mrekulli (*Hiç asgjë*, f. 81, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)
  - Un gridare, un accorrere di gente in capo a Via Nazionale, attorno a due che s'erano presi: (*Mondo di carta*)
  - Të thirrura, njerëz që po grumbulloheshin në krye të Rrugës Kombëtare për qark atyre që ishin kapërthyer njëri me tjetrin (*Botë letre*, f. 58, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)  
Në përkthim janë dhënë bukur të gjitha shprehjet e mësipërme.
- 5.1 Sharjet**
- Janë zakonisht mbiemra dhe emra përkeqësues, të marrë në kuptim të drejtpërdrejtë. Në përgjithësi marrin formë thirrës përpara vetës së dytë dhe herë tjetër funksionojnë si thirrës të vetës së tretë.
- Non hai visto, imbecille, che ho cercato dappertutto tranne che nello stipo a muro, dietro la cortina? (*Certi obblighi*)
  - S'e vure re, o tevegele që kërkova gjithandej me përjashtim të dollapit të futur në mur, pas perdes? (*Disa lloj detyrimesh*, f. 165, «Zoja prej dylli», Toena, Tiranë 2008)
  - Ottenuta la laurea, s'era subito buttati al lavoro, come due bestie (*Scialle nero*)
  - Me të marrë diplomat u dhanë shpejt pas punës, si dy kafshë (*Shalli i zi*, f. 15, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
  - E tutta la colpa era del padre, il quale, per quella maledetta fissazione della scuola, lo aveva fatto



trattare al modo d'un ragazzaccio stupido e in-  
tto dalla signorina, venuta in villeggiatura,  
abilitandola a certi scherzi che lo avevano ferito.  
(*Scialle nero*)

- Dhe tërë fajin e kish i jati, të cilit i qe ngulitur në tru ai mendim i mallkuar për shkollën dhe ish bërë shkak që zonjusha, e ardhur për pushime, ta trajtonte si djalë mendjelehtë, si leshko, duke u tallur me të, me ca tallje që e kishin therur mu në shpirt. (*Shalli i zi*, f. 24, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
- E poi, non si doveva aver da fare col cognato, domani, uomo di legge, imbroglione? (*Scialle nero*)
- Dhe mandej, nesër, pak kokëçarje do të kish me kunatin, njeri i ligjës dhe ngatrrëstar? (*Shalli i zi*, f. 39, «Jeta lakuriq», Naim Frashëri, Tiranë 1963)
- Che? Quella canaglia, - pruruppe allora Spatolino, sforzandosi di parlar basso, - quel farabutto, quel nemico di Dio... (*Il tabernacolo*)
- Çfarë kam? – shpërtheu atëherë Spatolino, duke u përpjekur të fliste me zë të ulët. – Ai maskaraj, ai edepsëzi, ai i pafe... (*Tabernakulli*, f. 77, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)
- Ma che può volere da me un uomo come quello, me lo dici? Porco, salvo il santo battesimo! porco, e dico poco! Aria! aria! (*Il tabernacolo*)
- Ç'punë mund të ketë me mua një njeri si ai, a mund të ma thuash? Derri i dërrit! Derr dhe e ka pak! Ajër se u mbyta! (*Tabernakulli*, f. 77, «Nata e parë», Toena, Tiranë 2008)

Në të gjithë shembujt shikohet se si sharjet përsëriten në shumicën e rasteve dhe shoqërohen edhe me përemra dëftorë. Në tekstet e përkthyer

janë sjellë bukur në gjuhën shqipe të gjitha shprehjet.

#### **Përfundime**

Përdorimi i eufemizmave dhe i disfemizmave nga ana e Pirandelos nuk është e rastësishme në veprën e tij. Si pasojë e pengesave psikologjike ka mjaft fjalë që njerëzit nuk i shqiptojnë ose e shmangin sa më shumë të jetë e mundur shqiptimin e tyre. Siç i pamë këto lloj pengesash apo ndalimesh reflektohen edhe në gjuhën që ata përdorin. Për të karakterizuar sa më mirë të folurën e personazheve të tij (personazhe shumë të larmishme: fshatarë, qytetarë, njerëz të shkolluar dhe njerëz pa asnjë ngritje arsimore, borgjezë të vegjël dhe punëtorë etj.) dhe epokën në të cilën vetë shkrimtari jetoi dhe prodhoi veprën e tij ai i risjell këto ndalime (pengesa) ashtu siç ndodhnin (dhe ndodhin) në jetën reale. Prandaj themi që përdorimi i këtyre eufemizmave dhe disfemizmave bën pjesë në stilin bisedimor të tregimeve, prandaj dhe si të tilla duhen dhënë edhe në tekstet e përkthyer. Në rastet e analizuara vumë re se në shumicën dërrmuese këto shprehje, terma, perifrastime janë sjellë bukur nga ana e përkthyesve edhe në gjuhën shqipe. Ka padyshim edhe raste kur nuk janë kuptuar nga ana e përkthyesve dhe janë sjellë gabim, apo edhe raste kur duke shtuar ndonjë fjalë më tepër shkrimarët e kanë humbur imazhin e krijuar në tekstin origjinal. Si përfundim duhet thënë se përkthimi i pasthirmave në rastin e Pirandelos është jashtëzakonisht i domosdoshëm për të respektuar kështu stilin dhe qëllimin e shkrimtarit.

#### **Bibliografia**

- BASSNETT Susan, 1993. *La traduzione teorie e pratica*, Bompiani, Milano.
- BATTAGLIA S., 1967, *Pirandello narratore* në *Atti del Congresso Naz. di studi pirandelliani*, Firenze, Le Monnier, f. 25-36.
- BLANCO Antonia Navarro, 1990, *La lengua y el estilo de Luigi Pirandello*, Sevilla (teze doktorate).
- BORZI I., ARGENZIANO M., (1993), (nën kujdesin e) *Luigi Pirandello Novelle per un anno*, Neëton&Compton Editori, Roma.
- ÇUÇKA Shpëtim, 1989, *Metodologia della traduzione*, shblu, Tiranë.
- DEVOTO G., 1950, *Studi di linguistica*, Firenze.
- GARAVELLI BICE Mortara, (1989), *Manuale di retorica*, Bompiani.
- GALLI Nora, (1969) *Le brute parole. Semantica dell'eufemismo*, Modadori.
- KOSTALLARI A., (hartues) (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- LEKA F., SIMONI Z., (2000), *Fjalor italisht-shqip*, Infbotues, Tiranë.
- MUNAFÒ Gaetano, (1968) *Conoscere Pirandello*, Le Monnier.
- NENCIONI G., (1977), *L'interiezione nel dialogo teatrale di Pirandello*, në *Studi di grammatica italiana*, VI, f. 227-283.
- NAPOLI Marisa, 1995, *I linguaggi della retorica*, Zanichelli Editore, Bologna.
- OSIMO Bruno, 2004, *Manuale del traduttore*, Hoepli, Milano.
- PIRADELLO Luigi, 1994, *Uno, nessuno e centomila, Testo integrale, schede storiche e letterarie, note al testo*, Meravigli Editrice, Vimercate.

- PIRANDELLO L., (1999), *Tregime e Novela*, Dituria, Tiranë.
- PIRANDELLO L., (2008), *Nata e parë*, Toena, Tiranë.
- PIRANDELLO L., (2008), *Zoja prej dylli*, Toena, Tiranë.
- PIRANDELLO L., (1997), *Novela për një vit. Jeta lakuria*, Çabej, Tiranë.
- PIRANDELLO L., (2010), *Teze Mikelina*, Toena, Tiranë.
- SPITZER L., (1922), *Italienische Umgangssprache*, Bonn-Leipzig.
- SPITZER L., 1954, *Critica stilistica e storia del linguaggio*, Bari.
- SHEHRI Dhurata, *Retorika*, Cikël leksionesh për studentët e fakultetit Filologjik, Dega Letërsi.
- TERRACINI Benvenuto Aronne, *Analisi Stilistica, Teoria, storia e problemi*, Feltrinelli, Milano.
- TERRACINI, 1982, *Analisi stilistica*, Feltrinelli, Milano.
- TERRACINI B., *Considerazioni sullo stile delle novelle di Pirandello*, në *Atti del Congresso Internazionale di Studi Pirandelliani*, f. 729-734.
- VIRDIA Ferdinando, (1993), *Invito alla lettura di Pirandello*, Mursia, Milano.
- ZINGARELLI N., (2002), *Vocabolario della lingua italiana*, Zanichelli, Bolonjë.

**TOGFJALËSHAT E QËNDRUESHËM TERMINOLOGJIKË NË FUSHËN E SË DREJTËS TË  
PASQYRUAR NË FJALORË  
FIXED TERMINOLOGICAL WORD-COMBINATIONS IN THE LEGAL FIELD REFLECTED IN  
DICTIONARIES**

**EDA SHEHU**

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti i Tiranës,  
Tiranë, Shqipëri  
[edashehu\\_2006@yahoo.com](mailto:edashehu_2006@yahoo.com)

**Përmbledhje**

Në këtë kumtesë trajtohen probleme të togfjalëshave të qëndrueshëm në fushën e së drejtës, si njësi emërtuese mbizotëruese leksiko-sintaksore, që krijojnë një shtresë të veçantë të leksikut terminologjik të kësaj fushe dhe që karakterizohen nga veçori të caktuara. Këtu vështrohen mënyrat, sesi realizohen në këta togfjalësha, aftësitë kombinuere të gjymtyrës kryesore të termit dhe të gjymtyrës përcaktuese të tij (*ligj i së drejtës, kod penal, e drejta penale*), si edhe pasqyrohen këto mënyra në fjalorin e së drejtës. Vend të veçantë zënë gjithashtu problemet e marrëdhënieve të termit fjalë me termin togfjalësh, si edhe marrëdhëniet ndërmjet gjymtyrëve brenda togfjalëshit. Dallimi dhe veçimi sidomos i togfjalëshave të qëndrueshëm terminologjikë nga togfjalësat e lirë terminologjikë, që përdoren në fushën e së drejtës kanë rëndësi jo vetëm në procesin e hartimit të fjalorëve terminologjikë, por edhe të fjalorëve filologjikë, në të cilët ata shërbejnë si lëndë ilustruese.

**Fjalë çelës:** *togfjalëshi i qëndrueshëm terminologjik, fusha e së drejtës, aftësia kombinuere*

**Abstract**

In this paper there are treated in the legal field, as prevalent denominative lexical and grammatical units, forming a special stratum of the terminological lexis of this field and characterized by certain specific features and traits. It will also delve upon how the combination properties of both the primary (modified) element of the terms as well as its modifier is realized (*ligj i së drejtës, kod penal, e drejta penale*) (*legal law, penal code, penal law*) and how such collocations are listed in the legal dictionary. With all material collected to date, this important layer of terminological lexis has not been much explored in our linguistic literature, so the distinction and separation of the fixed word-combinations from the unfixed terminology of compound words used in the field, is of a great importance in the compilation of Terminological dictionaries.

**Key words:** *fixed terminological word-combinations, legal discourse, combeing capacity*

**Hyrje**

Ndërmjet terminologjive të fushave të dijes, në leksikon e shqipes, vend të rëndësishëm zë edhe terminologjia e fushës të së drejtës, si fushë e gjerë dije, që përfshin edhe terma nga shumë fusha të tjera, por që dhe përfshihet në to. Një shtresë me interes të veçantë studimi në pjesën e leksikut të kësaj terminologjie, sikurse edhe në terminologjitë e fushave të tjera, përbëjnë togfjalësat e qëndrueshëm terminologjikë, të cilët, si njësi emërtuese të koncepteve, krahas termave fjalë, mbartin peshën më të madhe të shprehjes së informacionit shkencor-teknik përmes elementeve përbërëse të tyre dhe si njësi tërësore. Studimi i tyre, duke u mbështetur edhe në arritjet e derisotme, ka vlerë jo vetëm teorike të mirëfilltë, por edhe praktike konkrete në punën për përpunimin e standardizimin e leksikut tërësor të kësaj fushe edhe për pasqyrimin e tij në fjalorët terminologjikë dhe në ata filologjikë (joterminologjikë).

**Pasqyrimi i termave togfjalësh në fjalorë**

Sikurse u theksua më sipër në fjalorët terminologjikë të fushës të së drejtës, këta togfjalësha përbëjnë pjesën më të madhe. Sipas statistikës sonë rreth këtij leksiku, të pasqyruar në "Fjalorin e së drejtës" të serisë terminologjike (24) (DODBIBA L. 1986), prej 3114 terma, fjalë e togfjalësha, 806 janë terma njëfjalësh, kurse 2308 terma togfjalësh; këta të fundit nga ana sasiore janë trefish më shumë, ku ndërmjet tyre terma dygjymtyrësh janë 1344, terma trigjymtyrësh - 617, kurse terma mbitrigjymtyrësh - 347.

Nga ana e përbërjes së tyre, vështruar në mënyrën e renditjes në fjalor, ata janë shprehje më e drejtpërdrejtë e karakterit sistemor dhe hierarkik të kësaj terminologjie, të lidhjeve të gjymtyrëve me koherencë të brendshme dhe me simetri të jashtme të dukshme. Me sasinë e elementeve përbërëse ata paraqiten si pjesë e degëzimeve më të holla të sistemit terminologjik përkatës dhe që bëhen më komplekse me ndarjen e mëtejshme të koncepteve, realisht dhe potencialisht. Siç është nënvizuar me të drejtë, nga pikëpamja e lidhjes dhe e

marrëdhëniet të elementeve përbërëse, tek ta "mbizotëron në to e tëra mbi pjesët" (PASHO H. 2005:4), ku, si bazë e lidhjeve sistemore të karakterit paradigmatic shërbejnë jo vetëm elementet e përcaktuara, si p.sh., *ligj, kod*, por edhe Këtu duhet shënuar, se në fjalorët shpjegues e dygjuhësh termat togfjalësh zënë vend në strukturat semantike të fjalëve, duke shërbyer si lëndë ilustruese, ndonëse pasqyrohen në sasi të kufizuar në varësi nga destinacioni i fjalorit, nga madhësia e tij etj. Për herë të parë, në Fjalorin e F. Bardhit (PROKO V., DURO A. 2007), takohen disa togfjalësha të qëndrueshëm si njësi titullore, që sot shërbejnë si terma të fushave të ndryshme, ndërmjet të cilëve dy njësi të tilla janë nga fusha e së drejtës: *ati i fëmijës* dhe *be e rrejtshme* (betim i gënjeshtërt). Në Fjalorin e 54 (FGJSH 1954) ata "jepen në mënyrë të cinguar".

Më vonë këta togfjalësha kanë zënë vendin e merituar në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980) (FGJSH 1980). Në të, në strukturat semantike të fjalëve, pasqyrohen në një sasi të madhe togfjalëshash (jofrazeologjikë), si të gjuhës së përgjithshme, ashtu dhe të terminologjive të ndryshme, ndërmjet të cilëve edhe nga fusha e së drejtës, si: **juridik**: *marrëdhënie juridike, rregullim juridik, sistem juridik, Shkencat juridike, letërsi juridike, person juridik, e drejta*; **e drejta**: *e drejta penale*. Aty këtu ndonjë mund të jetë paraqitur si njësi më vete me përkufizimin përkatës në strukturën semantike të fjalëve.

Po kështu në të mund të takohen edhe terma të fushave të tjera, por që lidhen me fushën e së drejtës: *ambulancë mjeko-ligjore, arkeologji ligjore*.

#### **Fjalët librorë në përbërje të togfjalëshave terminologjikë**

Një grup më vete me interes të veçantë stilistikor përbëjnë një varg fjalësh kryesisht *librorë*, të cilat qëndrojnë në bazë të termave togfjalësh në terminologjinë e së drejtës. Në përbërje të termave togfjalësh, duke u përdorur kryesisht si elemente të përcaktuara, ato fitojnë status të veçantë në strukturën ndërtimore të termit dhe si të tilla, në fjalorët terminologjikë, dalin edhe si njësi të pavarura, siç janë p.sh., *afat, aftësi, përdorim, ndryshim, ndreqje, nevojë, ngatërrim* etj. Nga Fjalori të drejtës (PASHO H. 2005:4) me fjalën **afat** ka 22 togfjalësha (*afati i hetimit, afat i parashkrimit* etj.) dhe **afat** jepet edhe si njësi e veçantë (si të thuash e pranuar si term i fushës). Këto njësi që mund të cilësohen në vetvete më shumë si fjalë të zakonshme, kanë strukturën e tyre kuptimore, të dhënë në fjalorët shpjegues të gjuhës, me lidhjet e tyre të ndryshme kuptimore si, p.sh. *ndryshim, përdorim* (2 kuptime) etj. Vetëkuptohet se mbi bazën e kuptimit themelor të secilës prej tyre marrin vlera të shprehura nga termat togfjalësh.

elementet përcaktuese (si: *ligjor, statutor*), të cilët në rrafshin e këtyre dy lidhjeve përforcojnë më shumë sistemësinë e njërive: karakterin hierarkik, sistemor e semantik të tyre.

Kështu. p.sh., me fjalën *përdorim* ka 7 togfjalësha terminologjikë: (*përdorim vetjak, përdorim pa shpërblim*, etj.), ndonëse njësia *përdorim* nuk jepet si njësi titullore, meqë është cilësuar nga hartuesit e fjalorit si fjalë e zakonshme, çka është e kundërt me njësinë *afat*, të përmendur më sipër. Siç u theksua më lart, lidhjet e tyre kuptimore si njësi të veçuara në rrafshin paradigmatic mund të nxirren nga fjalorët e gjuhës së përgjithshme, kurse lidhjet konceptore mund të analizohen në rrafshin sintagmatik, siç mund të paraqiten në shembujt e mëposhtëm:

*Përdorim* (sipas FGJSH (1980) në lidhjet kuptimore paradigmatiche e të bashkëlidhura me foljen *përdor*, e cila ka 7 kuptime: 1. "shtie në punë" ... 2. "shfrytëzoj" ... 3. "hipi me mjet transporti" 4.5.6.7. "vë në jetë ..., etj".

#### **Marrëdhëniet e njërive përbërëse të togfjalëshave**

Një vend të veçantë zënë në studimet e kësaj terminologjie, njësitë togfjalëshore, të vështruara nga ana e bashkëlidhjeve të ngushta me elementet e togfjalëshave, të cilat, si gjymtyrë të përcaktuara në përbërje të tyre, shërbejnë si elemente kyçe. Ato bashkohen me gjymtyrët përcaktuese, të cilat funksionojnë si specifikuuese të përmbajtjes semantiko-strukturore të çdo togfjalëshi, të lidhur në mikrosistem me njëra-tjetrën si: **dënim**: *dënim më i rëndë / dënimi më i rëndë i shtuar/ dënim me kusht / dënim me gjobë ... etj.*

Konceptet e reja që shfaqen në fushën e së drejtës dhe që pasqyrohen togfjalëshat terminologjikë të kësaj fushe kushtëzojnë shtimin në përmasa të mëdha të njërive togfjalëshore, krahas njërive njëfjalëshe brenda kësaj fushe, ashtu edhe në lidhje me fushat e tjera. Kështu, p.sh., në Fjalorin e së drejtës, prej (UKA Nj. 2012) 20.000 termash, të hartuar nga Nj. Uka dhe të botuar kohët e fundit, janë përfshirë togfjalësha terminologjikë, që përbëjnë veçori të karakterit semantiko-strukturor, çka lidhet me përfaqësimin e gjerë të koncepteve juridike nga termat togfjalësh, si:

- Terma togfjalësh, të përbërë nga elemente latine: *à priori, ad hoc*

- Njësi nomenklaturore: *Gjykata e Kasacionit, Gjykata e Lartë ;*

- Emërtime për organizma: *Bashkimi Doganor, Bashkim Europian ;*

Për fjalën, si fjalë e zakonshme ose si term që shërben si bazë për formimin e termave togfjalësh, si temë termformuese merret jo vetëm elementi i përcaktuar, që shërben si pjesë kryesore, meqë mbart ngarkesën konceptore parësore të termit,

por edhe elementi përcaktues, i cili, ndonëse mbart peshën dytësore të informacionit të specializuar, bën pjesë në strukturën formuese të termit. Sikurse elementi i përcaktuar, që shërben si bazë për përmbajtjen e konceptit tërësor të togfjalëshit (БбЮСТЕР Е., 1935: 6-7) si, psh. *kod*, tek *kod ligjor*, ashtu dhe elementi përcaktues *ligjor*, specifikon konceptin, duke e diferencuar nga të tjerët. Kështu, p.sh., tek *kod rrugor* elementi përcaktues specifikon elementin e përcaktuar *kod*, duke e diferencuar nga *kod* në togfjalëshin *kod ligjor*. Kjo do të thotë se *kod* në të dyja rastet në bashkëlidhje me elemente përcaktuese *ligjor* dhe *rrugor* përfton dy koncepte të ndryshme. Përveç kësaj, termat togfjalësh i përkasin dy fushave (sferave) të ndryshme: *kod ligjor* (drejt.) dhe *kodi rrugor* (ek.transp.).

Nga ana tjetër, duhet nënvizuar, se në specifikimin e kuptimit të elementit përcaktues kanë peshën e vet edhe lidhjet sintagmatike të pjesëve fjalëformuese, të cilat specifikojnë njëra-tjetrën jo vetëm brenda së tërës, por edhe në bashkëvajtje me elementin e përcaktuar. Kështu, p.sh., tek *ligjor* mund të veçojmë lidhjen sintagmatike *ligj + or*, ku -or kuptimisht diferencohet në marrëdhënie me *ligj*, kur krahasohet me një element tjetër përcaktues me të njëjtën prapashtesë -or, si, tek *statutor: statut+or*, tek *kuvendor: kuvend+or*. Mund të shihet se -or vihet në raport me elementin tjetër të sintagmës fjalëformuese, d.m.th, me *statut, kuvend, ligj, rrugë* etj. dhe në vartësi të këtyre lidhjeve modifikohen ngjyresat kuptimore të saj, si: a) "sipas ligjit" në: *rrugë ligjore*, b) "i kuvendit", "që i përket kuvendit" tek *Komisioni Kuvendor* c) "i ligjeve" tek *kod ligjor* etj. Kjo do të thotë se prapashtesat në vartësi të pjesës temore dhe të elementit të përcaktuar të togfjalëshit terminologjik diferencohen kuptimisht, ndonëse kjo mund të zbulohet edhe në strukturën fjalëformuese të termit të marrë veças, çka del edhe nga konteksti si: 1) **Vërtetimi i faktit bëhet lehtë** (=kuptimi i "veprimi") dhe 2) **vërtetimi u dorëzua në kohën e duhur** (=kuptimi "i objektit"), pra :

-im në rastin e parë ka kuptimin e rezultatit të veprimi, kurse -im në rastin e dytë ka kuptimin e objektit. Kjo mund të zbulohet edhe në *përmbarrim* si "veprim<sub>1</sub>" dhe si "vend<sub>2</sub>" (=shkoi e dorëzoi *dokumentin në përmbarrim*), po kështu mund të thuhet për *vendim, deklarim*.

Siç dihet ka katër modele bazë të formimit të togfjalëshave terminologjike, sipas të cilave funksionon mekanizmi i krijimit të togfjalëshave: 1) *fjalë + term*; 2) *term + fjalë*; 3) *fjalë + fjalë* dhe 4) *term + term*. Lidhur me përfaqësimin e këtyre modeleve në fjalorë po sjellim disa shembuj që i ilustron ato.

- Në rastin e lidhjes term + fjalë, kuptimi i fjalës si element përcaktues në togfjalësh modifikohet nga kuptimi (përmbajtja konceptore) e elementit të përcaktuar e përfaqësuar nga termi si: **i lartë** nga *gjykata e lartë*, **i rëndë** nga *dënim i rëndë*, **i lehtë** nga *dënim i lehtë*, **i huaj** nga *ligj i huaj* etj. Në këtë rast kuptimi (kuptimet) e fjalës tek termi mund të nxirret nga struktura semantike të saj, ku, në tërësinë e vet gjithë kjo strukturë mund të shihet si një sistem kuptimor me lidhje të brendshme, të pasqyruar, p.sh., në një fjalor shpjegues (FGJSSH, 1980) brenda së cilës zbulohet edhe kuptimi që ka fjala në togfjalëshin terminologjik, si: i lehtë: kupt. - x: "i vogël në përmasa" i lehtë tek *dënim i lehtë*, i rëndë tek *dënim i rëndë*.

- Në rastin e modelit *term+term*, kuptimi i termit si element përcaktues mund të modifikohet nga elementi i përcaktuar, por ky modifikim mund të jetë "i padiferencuar", meqë, si rregull, termi është kryesisht i njëkuptimshëm, si: *kushtetues-e* tek *gjykata kushtetuese* dhe tek *kushtetues-e* tek *e drejta kushtetuese*.

#### Lidhjet kuptimore në çiftet folje/emër foljor

Një problem më vete mund të përbëjnë lidhjet kuptimore të elementeve të vargut (vargjeve) termformuese, sidomos në çiftet folje/emër foljor, si, p.sh., *dënoj* dhe *dënim*, *vërtetoj* dhe *vërtetim*. Në këto raste thelbin e kuptimit e përbën kuptimi i foljes që trashëgohet nga emri që lidhet nga ana e fjalëformimit (termformimit) me të, por, megjithatë kuptimi i emrit foljor mund të jetë më i gjerë se kuptimi i foljes, sepse ai fiton kuptime të tjera, si p.sh. tek *vërtetoj* → *vërtetim* elementi, *vërtetim* ka kuptimin e veprimi, të huazuar nga folja, por edhe një kuptim konkret: të të një "dokumenti" që vërteton diçka. "Ky kuptim gjen analogji me: *fortifikim, gjelbërim, lexim, studime, punim, strehim* etj.", që emërtojnë edhe objekte konkrete. Kjo do të thotë se sistemet terminologjike organizohen në mënyrë më të plotë, duke pasqyruar sistemet konceptore të fushës përkatëse, përmes termave emra (sidomos nga emrat prejfoljorë). Si rregull emrat prejfoljorë jo vetëm mbushin plotësisht strukturën konceptore, meqë e japin më të plotë strukturën konceptore të fushës, por ata kanë edhe denduri më të lartë përdorimi sesa termat folje. Ky konstatim mund të vlejë jo vetëm për termat emra të prejardhur nga foljet (ose më mirë që kanë korresponduese foljen si *dekretim* nga *dekretoj*). Kështu mund të vihet re përparësia *lexim i pretencës* ndaj *lexoj pretencën, përfundim i seancës - përfundoj seancën*. Në këtë rast lidhjet logjike nëpërmjet veprimeve të sendësuar jashtë marrëdhënieve kohore u shkojnë për shtat kërkesave të përmbajtjes së stilit shkencor-teknik, juridik-administrativ siç janë: karakteri objektiv i paraqitjes së lëndës (LLOSHI XH. 2001:25)

depersonalizimi dhe pasivizimi i përmbajtjes së tekstit etj., prandaj kanë përparësi termat togfjalësh emërorë dhe me bazë emërore.

Mund të arrihet në përfundimin se shkalla më e lartë e sistemësisë në lidhjet termformuese vërehet tek termat togfjalësh, të cilët në disa raste përbëhen në maksimum prej 5-6 gjymtyrësh. Si njësi të hapura nga forma e jashtme, por të mbyllura nga përmbajtja e vetme konceptore që shprehin, ato mund të quhen edhe lidhje sintaksore-konceptore, prandaj do të shihen si rast i veçantë lidhesh sistemore. Megjithatë ato mund të shihen në dy rrafshë: a) në tërësinë e lidhjeve të brendshme brenda çdo togfjalëshi me bazë fjalën b) në raport me njësitë e tjera, me të cilat lidhen nga ana termformuese.

#### **Përfundim**

Si qendër organizimi të lidhjeve brenda togfjalëshit shërbejnë ato njësi të përcaktuara, të cilat shquhen për një përmbajtje konceptore ose kuptimore të gjerë, si të tilla ato përbëhen nga tri lloje kategorish leksikore: a) nga fjalë të përgjithshme; b) nga njësi, si leksik i përbashkët terminologjik, d.m.th., nga njësi që u përkasin disa fushave terminologjike; c) nga terma me përmbajtje të gjerë konceptore. Për t'i konkretizuar më drejtpërdrejt rastet e mësipërme, mund t'u referohemi Fjalorëve terminologjikë të fushës të serisë të së drejtës në të dyja gjuhët (në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj) në të cilin sistemet terminologjike janë pak a shumë adekuate nga ana e pasqyimit në to të sistemeve konceptore përkatëse, pak a shumë të strukturuar njësoj dhe pothuajse të përbashkëta.

#### **Bibliografi**

- DODBIBA L., etj., 1986, *Fjalor i termave të së drejtës*, (24), Akademia e shkencave e RPSSH, Tiranë.
- PASHO H., 2005, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe* (Nga Rilindja deri në vitet 80, të shek.XX.), Tiranë.
- PROKO V., DURO A., 2007, *Përfaqësimi i fushave të dijes dhe tematike në Fjalorin e Frang Bardhit*, në "Frang Bardhi - 400 vjetori i lindjes", Prishtinë.
- 1954, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- 1980, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- UKA Nj., 2012, *Fjalor i drejtësisë*, Tiranë.
- БЮОТЕР Е., 1935, *Международная стандартизация в терминологии*, Москва.
- LLOSHI XH., 2001, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.

a) *Fjalë të përgjithshme*, të cilat, siç e kemi përmendur më sipër, mund të qëndrojnë si njësi më vete ose mund të futen si elemente përcaktuese të togfjalëshave terminologjike. Duke marrë për bazë të dhënat statistikore të nxjerra nga fjalorët terminologjikë, këto njësi mund t'i paraqesim të shprehura numerikisht nga ana sasiore, duke i dhënë në disa shembuj të veçantë në të dyja gjuhët: **bashkim** - 6 njësi: *bashkim çështjesh, bashkim dënimesh, bashkim sendesh* etj; **dëm** - 13, **dëmtim** - 18, **dërgim** - 6, **dhënie** - 6, **dhomë** - 3, **fëmijë** - 6, **fillim** - 4, **fshehje** - 5:

b) *Njësi të sistemeve të ndryshme terminologjike* si leksik i përbashkët terminologjik: **gjendje** - 7 njësi: *gjendje civile, gjendje juridike, gjendje lufte*,... etj.

c) *Terma të mirëfilltë*: **akt** - 7: *akt administrativ, akt i gjendjes civile, akt ligjvënës*, etj., **çështje, detyrim, dënim, e drejta, ekzekutim, gjykim**.

Krijimi i togfjalëshave terminologjike në terminologjinë e së drejtës të pasqyruar në fjalorë lidhet në mënyrë të pashkëputur me zhvillimin në thellësi e gjerësi të mendimit shkencor, në zbërthimin e pafundmë e me klasifikimin e vazhdueshëm të objekteve e koncepteve shkencore në tipa e nëntipa. Saktësia shkencore në fushën e së drejtës kërkon që termat t'i përgjigjen sistemit të koncepteve të shkencës të së drejtës. Për këtë arsye vetë termat e së drejtës duhet të jenë të bashkëlidhur e të ndërvarur njëri nga tjetri në bazë të një hierarkie të caktuar për tu pasqyruar në fjalorë.

# FONETIC PHONEMENS OF POPULAR POETIC TEXTS OF NIKAJ - MËRTUR DUKURI FONETIKE NË TEKSTET POETIKE POPULLORE NIKAJMËRTURASE

MERITA HAS'HYSA<sup>1</sup>, DEDË QOKAJ<sup>2</sup>

Gjimnazi "Elez Isuf Ndreu",

Kamëz, Tiranë, Shqipëri

E-mail: [ritahysa1@gmail.com](mailto:ritahysa1@gmail.com); E-mail: [dede.qokaj@gmail.com](mailto:dede.qokaj@gmail.com)

## Përmbledhje

Studimi ynë synon të sjellë disa dukuri fonetike nga treva nikajmerturase, që shfaqin originalitet gjuhësor në raport me të përbashkëtat dhe të veçantat e të folmeve verilindore dhe veriperëndimore të Shqipërisë, si një areal më konservativ i shtresës së hershme shqipfolëse. E folmja e zonës si ligjërim dhe si art poetik shfaq dukuri interesante, si në vokalizëm, ashtu edhe në konsonantizëm, ku përmes qasjes sonë i kemi bërë objekt trajtimi të imët gjuhësor, si: kuantiteti i zanoreve të theksuara; nazalizmi; diftongjet *au, eu, ou, iu, ie, ue, ye, oe*. Vërehet ruajtja e pastër e grupeve zanore *ie, ye* dhe *ue*. Veçanti paraqet *é*-ja, që i përgjigjet *ë*-së së shqipes së përbashkët, si edhe humbja e karakterit okluziv të bashkëtingëlloreve *q* e *gj* dhe *ç* e *gj*, si afrikate që janë shndërruar në tinguj frikativë. Dukuri fonetike të shpeshta janë edhe *elizioni, asimilimi, disimilimi, proteza, epenteza, epiteza, afereza, sinkopa, apokopa* etj, që mishërohen në ligjërim dhe tekstet poetike popullore. Ruajtja e elementeve konservative të shqipes së vjetër, sidomos e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* në pozicione të caktuara apo edhe ruajtja në disa raste, sidomos në brezin e vjetër, i grupeve *kl*, ku zakonisht paraqitet si *k*; grupet *bl, pl* e *fl* që i gjen të zbutura në *bj* dhe *fj*.

**Fjalë çelës:** Vokalizëm, nazalizëm, konsonantizëm, diftongim, monoftongim, asimilim, disimilim.

## Abstract

Our commentary aim is to bring some fonetic phonemns from the range's of nikajmertur that appears the originality of language in report to the commons and uncommons especially with the northwest and noertheast speeches of Albanian like the most conservator realm of primeval Albania spoken language. The dialect of the area like a legalization and like poetic art it shows some interesting phonemns like vocalism also consonantism where between our approach we have done to them a object with a detail lingual like quantity of emphasis vowels: nasalization; diphthongs *au, eu, ou, iu, ie, ue, ye, oe*. It is also distinguish the pour self - preservation of the group of vowel like *ie, ye* and *ue*. Whats is special is *é*-ja that is resposed to *ë*-së of the commom Albanian language, also the lost of explosive character of constant *q* and *gj*, sounds, that have lost explosive character and *ç* also *gj*, like rubbing vowel that are transformed into rubbing sounds. Fonetic phenomns that are often very used are also the *elizioni, asimilation, dissimulation, prosthesis, epenthesis, apheresis, syncope, apokope* etc, that incarnate on the legalization and popular poetic texts. The protection of conservative elements of old Albanian language, especially the groups of consonants us: *mb, nd, ng* on the fixed position or the safe in some cases, almost on the old generation, of groups *kl* where usually appears like *k*, groups *bl, pl* and *fl* that we find them softened in *bj, fj*.

**Key words:** vocalism, nasalize, consonantism, diphthongs, monophthongs, assimilation, dissimulation

## Hyrje

Është për t'u theksuar që në krye të herës se, në këngët popullore të kësaj krahine, dukuritë e ndryshme fonetike janë më të reduktuara sesa në ligjërimin bisedor. Në këngë populli del më i zgjedhur dhe, në disa raste, i jemi referuar edhe ligjërimin bisedor, duke qenë edhe vetë autor dhe "aktor" i tij. Vërehet se kemi të materializuara sot e tërë ditën:

a) vokalizmin, me kuantitetin e zanoreve të theksuara, (Çabej 1988: 29), ku zanorja e rrokjes së theksuar ka tri shkallë: *shkurtësi, gjatësi të mesme* dhe *gjatësi*, një dukuri e përgjithshme e shqipes (Topalli 2007: 107), të cilat dalin edhe në

të folur, edhe në këngë në arealin nikajmerturas (Lafe 1964: 107-108);

b) nazalizmin që i prek tërë zanoret, por më "e plagosura" është *a*-ja (Cipo K., 1949:7;

c) Diftongimi, si brenda fjalës, ashtu edhe në kushtet e fonetikës sintaksore (*sand'hit*), (Dodi 2004: 153), një *j* për zhdukje të hiatit, (Pedersen 1973: 241-247), zditur më tej nga gjuhëtari ynë i njohur Eqrem Çabej (1988: 65-66);

d) konsonantizmin me dukuritë që shfaqen, sidomos qiellzoret *q* e *gj* (Lafe, 3/164:111, 114), sidomos tek elementi katolik, siç është Nikaj - Mërturi, për *ć, ğ* (Çabej, 1973:149-150), (Gjinarit J.,

1963:39), (Dodi A., 1963:41), (Lambertz M., 2011:30 - 31);

e) grupet e bashkëtingëlloreve *kl* e *gl* (Çabej 1973:155, 156, 180, 181, 204) që kanë pësuar një velarizim të plotë, grupet *bl*, *pl* e *fl*, zbutur në *bj*, *pj* e *fj*, grupet *mb*, *nd*, *ng*, (Lafe E., 3/1964:115), për çka në pozicion nistor, këto paraqiten të rrafshuara me anë të një asimilimi progresiv, në një nazal të thjeshtë, por edhe në fund (mendimi im, - D. Q), *fsh*, asimiluar në *sh*, (Xhuvani - Çabej, BShSh, 4/1956:71), i shtrirë edhe tek dëshirorja e foljeve, kurse grupi *gt*, tingullin qiellëzor e ka jotizuar.

Vëmendja jonë ka pikasur, kryesisht, disa shfaqje të veçanta që kanë në këngë *elizioni*, *asimilimi*, *disimilimi*, *metateza* etj., me veçoritë e veta.

### Veçori fonetike

#### Elizioni (Çabej 1988:41)

Një rast interesant është shuerja e zanores “o” te pjezëza *po*, kur pas saj vjen trajta e shkurtër përemërore *e*. Kjo trajtë ka marrë kuptimin e pjesëzës *po* dhe përdoret në vend të saj përpara trajtash të shkurtër, siç dëshmohet: *Ket katund fare p’e qesim/Küll e shpija p’e ja u djegim*; Shuarjen e *é-së* të pjesëza *t’e* e lidhores, kur pas saj vjen trajta e shkurtër *e*: *Fill n’Krūm t’e paskan šue*.

#### Asimilimi (Çabej 1988:440 - 446)

Gjendet në disa fjalë të pakta dhe trajtash të tyre.

a) Asimilim bashkëtingëlloresh në kontakt: *nz>nx*: *Kâ° i manxerre e due m’e bvēt*; *sm>zm*: *M’ato dazm’ kie me m’ardh*; *llz>llx*: *E jam drēdh n’ket log për me t’kallxue*; *z>x*: *Ktu m’xu nata e u ugja për me fjet*; *bv >pv*: *P’e pvet Pāsha: “Qe bane ushtrin?”*; *bt >pt*: *Ropt të gāll nu’ mūj m’e j dhān*; *sht >ksht*: *Tu t’jēn liksh për m’e forcue*; *pt >bt*: *Ky Tesh Kurti rrebt po qet*.

Kemi edhe asimilim të këtyre grupeve *mp>mb* (i mbreht> i mreh’t), por dëgjohej i rrëgjuar tingulli i dytë në favor të të parit; *nt>nd* (t’linda); *tm >m* (prim’ aty se erdha), në ligjërmin bisedor.

b) Fjalë me asimilim në distancë:

-në zanore: *Qe nānd vjet jashtan s’ā kān*;

-në bashkëtingëllore: *Uj pjētpōsht mos djergt Balbona!*

Si në mbarë gegërishten, grupet: *nd*; *n*; *mb*; *m*; *ng*; *n*; *g* (më shpesh), si: *Treqin<sup>d</sup> djelm i kān pērm<sup>b</sup>rapa/Qe shtat vjet kām met<sup>n</sup>qujue*

Në këngët popullore, si edhe në të folmen e Nikaj - Mërturit, takojmë edhe asimilim të pjesshëm, dy tinguj afrohen në disa veçori. Kështu dy bashkëtingëllore të ndryshme, njëra e zëshme dhe tjetra e pazëshme, asimilohen pjesërisht duke u kthyer të dyja në të zëshme dhe të pazëshme: *Nat Bajramit sonde kam*; *n’shpīn e vet na j ka zhgarkue*.

#### Disimilimi (Çabej 1988:446 - 447; Dodi 2004:153;)

Ndeshet pak si fenomen. Kjo dukuri shfaqet më tepër në bashkëtingëllore e më shumë në distancë: *‘Qathër djali p’e ladron*. Në të folme: *yndyrë - undyr*; *kontrolloj - kuntralloy*; *Ilogore - Ilagore* etj., por në të folme shfaqet edhe *haplologjia*, dukuri e shpeshtë në rasat e zhdrejta.

#### Metateza (Çabej 1988:446 - 447; Dodi 2004:153; Topalli 2007:401 - 405)

Është e shpeshtë, që kap edhe fjalë të reja, përveç atyre të një kohe më të largët, si p.sh: *Kurrku pshtimin s’ma ka mue /‘Qato ‘qafa s’mūj me i pkūt*. Më dendur ky fenomen del në gjuhën e folur, si: *krapuell - kapruell*; *shkëndija - kshndija*; *ndërtim - ndrejtim*; *përzore - prezore*; *person - preson*.

#### Shtesa tingujsh:

a) Proteza (në fillim): *“Gjelosh Ramón e kām nxān”*. Në *i jati*, por me raste edhe *e jēma* (e jāma) është shtuar një “j” protetike në kushtet e *sand’hit*, si shtesë edhe tek pronori *im* (i im) i substantivuar (i jēmi); te foljet *ap*, *ep* kjo mungon. Si tinguj protetikë dalin më shpesh në gjuhën bisedore, më rrallë në këngë, “n” para “d” (e ndrejtë, ndushkon mali, u nxūm ndër veti/, del edhe “m” para b - së: *Pa jaran mbijo nu’ jje...*

b) **Epenteza** (shtesë në mes). Emrat e lakimit të tretë, që në trajtën e pashuar mbarojnë me zanoren “e” ose “i” të theksuar, marrin midis temës e njëjës shqese një “j” antihiatizuese: *Shtat ko’qak i ki’ pās malsija/A kām kap Demush Balija*. Në gjuhën e folur shumë herë një “m” tërheq një -b-epentike dhe një një b tërheq një - m epentike: *rrnōft*, e *shtunde*, e *prende*, *katund* (Çabej 1988:382 - 390).

c) **Epitezë** (shtesë në fund). Kjo dukuri fonetike paraqitet shumë e rrallë në këngët popullore të Nikaj - Mërturit, sepse karakteristike janë heqjet e tingujve në fund ose rrëgjimi tyre: *Jalla m’ shpīnd gogut po m’i kcen/Qe nānd vjet Krajli ti ka nxān*. Në gjuhën e folur fjala *man*, e *shtunë* dalin *mandi*, e *shtunde*.

#### Rënie tingujsh (Dodi 2004:150 - 152)

a) Aferezë. Kjo dukuri shfaqet më shumë në të folmen e kësaj treve, por edhe në këngët popullore, kryesisht tek emrat e njerëzve, tek numërorët etj: Po pvet Pasha: *“Q’e bāne pishtolen?”/- Ma ka xērr Murati prej dore”* ose *“Fort po shndrit naj djell e pak po xe”*.

Edhe grupet *mb*, *ng* e *nd* si në (nimoj) në fillim ose janë të rrëgjua ose dalin të asimiluara. Foljet *jap*, *jep* dalin me aferezë (‘ap, ‘ep). Në të folmen bisedore kemi: *‘sha zotin*, *s’un shkoj*, *‘sha gākun si kēna bāshk’*; tek numërorët: *‘i shok*, *‘i pūn* etj.



b) Sinkopa. Shfaqet dendur si dukuri, sidomos para theksit ose pas tij. Në mes të fjalës tingujt bien dhe shqiptohen, kjo edhe për arsye të komunikimit të shpejtë, p.sh: *gÿsa* (për gjysma), *mzika* (për muzika), *shpī* (për shtëpi); *pej* (për prej); *t'thūer* (për tërthuar). Rënie e bashkëtingëllores – *n* përpara një *sh* - je ose *t* - je fundore: *dhêt* (dhentë), *mêt* (mendtë); *n'mâ dhâs* (në ma dhësh). Këtu grupi bashkëtingëllor - *nsh* në fund të fjalës, në disa raste, dëgjohej 'q (afrikativ) si në tërë të folmen e trevës. Grupet *mb*, *ng* dhe *nd* në mes dalin të rrëguara ose të asimiluara tërësisht: '*Qou mojnuse me ʔ shtér<sup>n</sup>que/...Mâs tre fmiysh qÿsh me m'ls hue?* Përsa u përket bashkëtingëlloreve *g* e *k* nuk kemi velarizimim e plotë të tyre as në mes, por as në pozicione të tjera: *T'shtie me zqiedh n'dymdhet shpī*.

### c) Apokopeja

Kemi rënie të bashkëtingëllores – *n* kur shërben si mbaresë vetore ose në emra njerëzish, si në komunikim, po ashtu edhe në këngët popullore: *ish kâ puno, ka jê ka vje, Shyta, Hasa, Vuksa; për shiljer nu' po kâ dert; Kish' nevōj drit mos me dâl/Kish' nevōj diell mos me le; Mehme' Zaja t'madhe briti...*

Rënia e bashkëtingëllores *s* te pjesorja *pasë* në të kryerën e plotë të dytë.

Në të folur: *kemi pa' jetue, ki pa fōl etj.* Në këngë: '*Gjelosh Rama i ki'n pa thâ<sup>n</sup>...*

Rënia e bashkëtingëllores - *k* te pjesëza *nuk*. Në të folur: *nu'ki pa ardh, nu'â kan etj., ndërsa në këngë: Bajram Begun, 'Gjelosh m'e kallxue/ - Nu' muj me ta kallxue.*

Rënia e *t* - së fundore në fjalë të ndryshme, por kryesisht në këto të poshtëshënuarat: *Beqir Aga zo'ku j ka hi...; Zo' kâ ka Syla në ôdë?*

Rënia e zanores - *i* në vetën e parë shumës të foljes *jam* e *kam*, kur përdoren si ndihmëse: *Kushri nâne kem, 'qillue/Kem' kujtue se s'e lidh asqeri.*

### Bibliografi:

- Çabej, Eqrem (1960)*, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe", dispensë, f. 19; **(1988)**, Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe, f. 29, 41, 65 – 66, 382 – 390, 440 – 447; *Grup autorësh, (1973)*, Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, f. 132 – 150, 155 – 156, 178 – 181, 200 – 204.
- Cipo, K. (1949)*, Gramatika shqipe, Tiranë, f. 7.
- Dodi, A. (1963)*, Fonetika e gjuhës shqipe, dispensë, Tiranë, f. 41; **(2004)**, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, f. 147 – 153.
- Gjinari, J. (1963)*, Dialektologjia shqiptare", dispensë, Tiranë, f. 39; **(1975)**, Dialektologjia shqiptare, Tiranë, f. 32.
- Hylli i Dritës (1937)*, nr. 12, f. 595 dhe 600 - 602; **1940**, 1 - 2, f. 36 - 37, 38 - 39 dhe 41- 42; **1940**, 5 - 6, f. 221 - 222; **1941**, 9 – 10, f. 436 – 433.
- Këngë Popullore Historike (1956)*, Tiranë, f. 199 - 200, 203 - 204, 237 - 238, 293 – 294, 318 – 320.
- Lafe, Emil (3/1964)*, Studime filologjike, f. 107 - 147.
- Lambertz, Maximillian (2011)*, Raport mbi diskutimet e mia linguistike në Shqipëri prej mezit të majit deri në fund të gushtit 1916, Shkodër, f. 30 - 31.
- Memushaj, Rami (2009)*, Fonetika e shqipes standarde, Tiranë, f. 86, 87.

Te fjala "gjithë", si përemër i pacaktuar, rrokja e dytë, *bie*, kur përdoret si i tillë, por, zakonisht del, si *t'tân*: *T'tân' komit t'zqedhun me dōr/t'tân n'manxer e tât me shpata*, ndërsa në ligjërimin e përditshëm të zonës "gjithë" del me mungesën e *th* - së e pa *ë* - në fundore, p. sh.: *shkuli me ði rrōj, ish' me ði' grue* etj.

**Shurdhime e sonorizime.** Bashkëtingëllorja *d* te parafjala *deri*, shumë herë shqiptohet *t*, si: *Shkoi teri n'Gakov* në ligjërim, ndërsa në ligjërimin popullor: *Ka nxjerr shpatën teri n'gÿst*. Bashkëtingëlloret i gjejmë të shurdhuara si ato me burim nga sllavishtja, por në trajtën e shquar zakonisht dalin të pashurdhuara: *Ropt të gāl nu'muj me j dhân; Ti the stenén, ū thej zitin (d); Sot po virret ni bek i ri/N'Curraj t'Epër rri me shpī*. Shumë shpesh *t*-ja sonorizohet e bëhet *d*. Kjo del e rëndomtë te përemrat dëftorë e ndajfoljet, kur marrin si parashitesë deiktive '*qe*. Kjo del shpesh në vend të *k* - së, p.sh: '*qedij* (këtij), '*qedâ*, '*qedū* (këtu) etj në ligjërimin bisedor. Në këngët popullore: *Ūn qesaj s'ju kâ kujtūe; Qato 'qafa smūj me j kpūt*. Bashkëtingëlloret e zëshme, në këtë krahinë, përgjithësisht, nuk shurdhohen.

### Përfundim

Dukuritë fonetike, me aq sa paraqitëm më lart dhe të tjera që do të kërkojnë një qasje edhe më vullnetfortë, nxjerrin në pah se ky areal gjuhësor ruan disa veçori fonetike që s'i gjejmë as në pjesën verilindore, as perëndimore, me këtë formë shfaqjeje, si: *elizionin* (në të folur dhe këngë), *asimilimin* në kontakt dhe distancë, ndërsa *disimilimi* përdoret më rrallë. Dukuria e *protezës*, *epentezës* dhe *epitezës*, bashkë me *aferezën*, *sinkopën*, *apokopenë*, kanë edhe sot goxha përdorim edhe në ligjërim (moshë e mesme, e vjetër). Në ligjërimin bisedor dhe etnografinë e të folurit, ky komunitet folësish mbetet ende konservativ.

*Palaj, B., Kurti D. (2005)*, Visaret e Kombit, Shkodër, f. 25 - 41, 43 - 48, 49 - 62, 63 - 66, 118 - 122, 136 - 139, 140 - 145, 146 - 153, 154 - 158, 159 - 169, 170 - 174, 203 - 210, 215 - 217, 218 - 223, 224 - 226, 227 - 230, 231 - 233 dhe 234 – 236.

*Pedersen, Holger (1973)*, Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, f. 241 - 247.

*Topalli, Kolec (2007)*, Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë, f. 107, 371 – 376, 401 – 405.

*Xhuvani - Çabej (4/1956)*, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, f. 71.

**Arbëria muzikore në shek. XVI–XVIII: përsëri mes Lindjes gjithnjë e më shumë ‘Lindje’  
dhe Perëndimit gjithnjë e më shumë ‘Perëndim’**  
***Musical Albania in XVI–XVIII Centuries: between East and West once again – ever more East,  
and ever more West***

**EDMOND BUHARAJA**

Universiteti i Arteve Tiranë

Fakulteti i Muzikës

e-mail: e.buharaja@libero.it

**Përmbledhje**

Dorëzimi i Durrësit më 1501-shin shënoi edhe nisjen e administrimit të plotë otoman të krejt Arbërisë i cili, ndonëse askush nuk e besonte asokohe, do të zgjaste për më shumë se një gjysëm mijëvjeçar. Studiuesit do të shpreheshin se «forcat e dhunshme të ushtrive Turke provuan të jenë shumë më të forta edhe për të tillë diplomatë dinakë si venecianët dhe për të tillë luftëtarë të mrekullueshëm si arbërit». Rezistenca e identitetit të këtij populli do të vihet në provë të rëndë. Do të jetë kjo periudha e shkëputjes graduale, por progresive e këtij territori nga trungu të cilit i përkiste me të drejta të plota. Arbëria i largohej Mesjetës, e bashkë me të edhe Perëndimit me krenari. Lavdia e periudhës së rezistencës dhe e fitoreve shembullore të arbërve nën drejtimin e Skënderbeut i bënte të shpërngulurit e këtij vendi drejt brigjeve më të sigurta të Adriatikut perëndimor të prezantoheshin me kokën lart: ata ishin të mundur, por jo të thyer.

**Fjalë çelës:** Arbëria, muzika, otomane, tajfa

**Abstract**

The surrender of Durrës to the Turks in 1501 marked the beginning of a full Ottoman administration of Albania, which would last for more than half a millennium, although no one believed it at the time. Scholars would argue that «the violent forces of the Turkish army turned out to be much stronger even for those as cunning as Venetians diplomats, and as wonderful warriors as the Albanians». The Resistance and the identity of this people would be put to a severe test. It would be a gradual but progressively weaning period for this territory from the trunk of land to which it belonged with full rights. Albania eschewed the Middle Ages, and with it the West too, with pride. The glory of the resistance period and exemplary victories of the Albanians under the leadership of Skanderbeg presents a haughty image of the evacuees of this country escaping towards the safer shores of the western Adriatic: they were conquered, but not broken.

**Keyword:** Albania, music, ottoman, tajfa

**Hyrje**

Shqipëri, lejomë të kthej syt’ e mi  
Mbi ty, o nënë e rreptë burrash t’egër!  
Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë,  
E zbeta hënëz ndrin nëpër lugina  
Mbi pyje me selvi n’agor të çdo qyteti.  
(Byron 2004: 66, v. 338–342)

Dorëzimi i Durrësit më 1501-shin shënoi edhe nisjen e administrimit të plotë otoman të krejt Arbërisë, i cili, ndonëse askush nuk e besonte asokohe, do të zgjaste më shumë se katër shekuj. «Forcat e dhunshme të ushtrive Turke provuan të jenë shumë më të forta edhe për të tillë diplomatë dinakë si venecianët dhe të tillë luftëtarë të mrekullueshëm si arbërit» (Bury 1923: 583–4). Rezistenca e identitetit etnik vihet në provë të rëndë, e do të jetë kjo periudha e shkëputjes graduale, por progresive e këtij territori nga trungu të cilit i përkiste me të drejta të plota. Ballkani Perëndimor dilte nga Mesjeta me kokën lart. Lavdia e periudhës së ‘Motit të Madh të Arbrit’ me fitoret shembullore nën drejtimin e Skënderbeut i bënte banorët e këtij trualli dhe të shpërngulurit e tij drejt brigjeve më të sigurta përqark Adriatikut të

prezantoheshin me plot dinjitet: ata u mundën, por nuk ishin thyer. Dokumentet e shek. XVI flasin për një aktivizim të vetëdijes kombëtare, e posaçërisht të një krenarie e cila do të mbetet trajta stilizuese e këtij populli. «Produkti më hyjnor i këtij seleksionimi vdekjeprurës, luftëtari më i tmerrshëm, që e krijoi në përgjithësi përleshja e Europës me turqit, është *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*. Ky edhe për së gjalli u madhërua nga Evropa Perëndimore me legjenda [...] Fantazia e popujve të Ballkanit, të dërrmuar prej të pafeve, krijoi prej tij heroin e këngëve të veta dhe të përrallave të mbledhura. Qysh në shekullin XVII, por edhe në praninë e turqve, shqiptarët këndonin [...] këngë për Skënderbeun. Po ashtu të tilla këngë prej asaj kohe kreshnike janë ruajtur te kolonistët shqiptarë në Italinë e Jugut [...]» (Šuflyay 2004: 122).

Nga ana tjetër, shkëputja e dhunshme nga shtrati evropian dhe spostimi i qendrës në rrënojat e ish Perandorisë Romake të Lindjes, tashmë e quajtur Istambul (Stamboll), do ta rikthente historikisht Arbërinë më shumë se një mijëvjeçar prapa: ajo do të rezultonte përsëri tokë kufitare, ashtu si në shek.

iv e. s. Presioni mbi Ballkanin Perëndimor do të kishte pasoja të jashtëzakonshme posaçërisht demografike dhe hapësinore të përshkruar nga Çabej (1994b: 93) në këto terma: «Pozita gjeografike në këtë pikë të Adriatikut e ka vulosur për gjithmonë fatin historik të këtij kombi, që bashkë me grekët është më i lashti i Gadishullit ballkanik. Shqiptarët janë stërnipët e atyre fiseve ilire, shumëfish të përziera me fise trake, të cilat nëpër ag të kohëve prehistorike zbritën prej viseve të Veriut të Europës dhe ngulën në këto troje. Po të krahasojmë truallin e banimit të ilirëve në kohët historike, të cilët mbanin krejt viset e Lindjes së Adriatikut gjer thellë në Hellas, me tokën ku shqiptarët flasin sot gjuhën e tyre, do të shohim se kjo tokë është një vend reduksioni: rezultat i erozionit e i thërmimit të ngadaltë të zonave të anës». Eliminimi përfundimtar prej hartës i 'Albania Veneta' përkon me fillimin e Rilindjes europiane ndaj është në këtë moment që duhet kërkuar shkëputja apo çarja e madhe kulturore e detyruar me dhunë ushtarake dhe administrative. Iliria shumëgjyreshë kristiane do të shkonte drejt një rrudhjeje graduale e të pandalshme për t'i lënë vendin një Arbërie gjithnjë e më tepër njëgjyreshë me një sfond kulturor ku gjysmë hëna perandorake do t'i tregonte përherë anën e errët.

Studiuesit (Meyer 1885: 588<sup>3</sup>; Jokl 1917: 125) mendojnë se degëzimi i gjuhës shqipe në gegërisht dhe toskërisht «nuk është i vjetër [...] Toskërishtja jugore e mbarimit të Mesjetës, siç na shfaqet në idiomën e kolonive tona në Greqi e Itali, afrohet me gegërishten veriore të shekullit XVI e XVII. [...] duket se njësia e gjuhës, shqipja e vjetër e përbashkët, ka rrojtur gjer në Mesjetën e lartë, në trajtat kryesore» (Çabej 1994a: 20).

Kjo tezë na intereson në pikpamje të stilistikës shprehëse, e ndjekja e saj do të mundësonte arsyetimin edhe të diferencave që hasen sot në stilemat muzikore. Arti i tingullit ka ruajtur për këtë popull të trysnuar vlerën e tij shtesë, atë që do të mund t'i siguronte mbijetesën. «Zëri e jo shkrimi ka qenë faktikisht instrumenti i fuqishëm në kujtesën e shqiptarëve: këngët epike, rapsoditë, të celebruara gojarisht, na kanë transmetuar edhe ne arbëreshëve, mite e rite të largëta në kohë, "për të mos harruar", për të mos qenë të harruar» (Mandalà 2010: 80).

Nëse i përmbahemi kësaj teze atëhere Arbëria reale, ajo e njohur si raca dinarike, ndonëse pjesë të

kësaj të fundit shtrihen edhe në disa vende fqinje, ka vepruar më shumë sesa mendohet larg të qenit mozaik, e diferencimi duket të jetë aktivizuar në masë të konsiderueshme vetëm gjatë pushtimit otoman. Mesa duket janë vënë në lëvizje disa mekanizma që synonin çarjen në dysh të kësaj njësie etnike, frakturë që me kalimin e shekujve është bërë gjithnjë e më kontrastuese. Me këtë lëvizje divergjente mund të shpjegohet edhe rrudhja progresive e trajtave identifikuese që për mijëra vjeçarë kishin mbajtur të unifikuar *gens*-ët që popullonin *Illyricum*-in.

Ai që njihet si dialekti geg, me të gjitha prurjet kulturore që mbart me vete, këtu përfshirë edhe idiomat muzikore, duket të jetë shtresëzimi më i hershëm i substraktit iliro-arbër i trashëguar deri më sot në forma ende të virgjëra. Në këtë mënyrë, ndërsa pjesa qytetare e Arbërisë — e civilizuar ndryshe nën presionin administrativ dhe ushtarak otoman, paralelisht e bashkarisht me simotrat e saj fqinje, mënjanoi shumë nga vlerat e trashëguara, duke iu hapur ndikimeve të Lindjes së Afërme, veriu geg dhe jugu tosk, vijoi konservatorizmin tipik ballkanik për të ruajtur të paprekur atë botë animiste e pagane, gjithsesi parakristiane që kishte karakterizuar Europën juglindore në mijëvjeçarën e parë p.e.s., e më herët. Mund të ketë ndikuar në këtë realitet edhe ashpërsia e mjedisit alpin që ka shkurajuar depërtimet e padëshirueshme të stigmatizuara si të huaja për mjedisin kulturor, ndaj edhe të përjashtuara *a priori*. Në jugun arbër është pjesa perëndimore, pra ajo labe, e cila, më larg kontaktit të drejtpërdrejtë me fqinjët, duket se e ka ruajtur më shumë strukturën e hershme fisnore, domethënë *gens*-in epiriot, i cili vërehet edhe në gjallimin e katundeve të vogla të ndërtuar mbi themele farefisnie.

#### **Organizmat e para muzikore**

Pas mposhtjes së rezistencës e, posaçërisht, pas thyerjes së besimit të ndonjë largimi të shpejtë të otomanëve nga Ballkani, jeta arbëre filloi të hyjë dalëngadalë në një tjetër rrjedhë, pra në atë të largimit gradual nga shtrati kristian mijëra vjeçar që i kishte shërbyer si identitet. Zëvendësimi gjithnjë e më i shpeshtë i ngrehinave kristiane me ato të kultit islam, ndryshimi i veshjes dhe pamjes apo përshatja e zakoneve sipas modelit imponues të administratës së re dhe zbatimi i një ligjshmërie që buronte nga një tjetër sfond kulturor, do të përfundojnë për të krijuar një Arbëri gjithnjë e më shumë vilajet orientale. Bashkëjetesa e detyruar — për arbërit më shumë marrëse sesa dhënëse — i dha udhë një ndryshimi sistematik i cili, nga qytetet kryesore ku ishte instaluar filli misht, nisi të përhapej në mënyrë kapilare duke kërcënuar vetë

<sup>3</sup> Meyer (1885:588) shprehet: «Sidoqoftë, diferenca e sotme midis gegërishtes dhe toskërishtes e cila nuk është pastaj aq e madhe, mund të rrjedhojë një dallim të mëpasshëm. Studimi i shqipes së folur në Greqi më bën për momentin ta konsideroj këtë opinion si më bindësin».

qenësinë shpirtërore<sup>4</sup>.

Tërheqja nga Lindja nuk kishte qenë kurrë kaq e rrezikshme dhe, për më tepër, ajo do të ishte edhe e gjatë, shumë e gjatë. Ndonëse në «shek. xvii në disa vendbanime të Shqipërisë Veriore u arrit të hapeshin edhe disa shkolla fillore dhe një shkollë e mesme, në të cilat mësimet fillestare jepeshin në gjuhën shqipe», do të shtohen me shpejtësi edhe «shkollat islamike (medresetë), që u ndërtuan pothuajse në të gjitha qytetet shqiptare», ku «mësimi zhvillohej në gjuhën turke ose arabe» (Duka 2009: 394). Veç tyre u vunë në aktivitet edhe shkolla në gjuhën greke si «“Akademia e Re”<sup>5</sup> (shkollë e mesme, që u çel më 1720 në qytetin e zhvilluar të Voskopojës». Sinani (2014: 98) informon për «*Codex Georgius Papisimos, Kodiku i Gjegj Papisimos*, kompozitor dhe shkruar voskopojar, me përmajtje *lëndë himnodike kishtarë*, përdorur për këtë funksion në liturgjinë e kishës lindore dhe në shkollat e Voskopojës, u botua pas vdekjes së tij», fakt që dëshmon bindshëm se edhe jeta muzikore e atij qyteti po prirej të merrte përmasa gjithnjë e më me peshë.

Brown-i (1685: 13) e përmend shkarazi si gjuhën shqipe ashtu dhe muzikën e saj në gjysmën e dytë të shek. xvii, por domethënia është e tillë që ia vlen ta citojmë të plotë: «Në të njëjtën mënyrë ne u shushatëm nga Gjuha e *Shqipërisë*, në pjesën veriore të *Epirit*, dhe në perëndim të *Maqedonisë*. Ne përdorëm disa nga ai vend duke kaluar malet, të cilët ishin të aftë të flisnin pak *Sllavisht*: po sa për *Shqiptarët*, ose për Gjuhën e tyre, kudo të ishin gëzoheshin të këndonin ditë e natë, ndërsa udhëtonin me ne; gjuhëtarët tanë më të mirë, si *Turq* e *Kristianë*, nuk kuptuan gjë prej saj».

Situata po degradonte dita-ditës duke e mbajtur pjesën më të madhe të banorëve larg mundësive të shkollimit ndaj analfabetizmi mori përmasa të frikshme. Tashmë popullsia mund të ushqej vetëm me trashëgiminë kulturore paraosmane e cila

<sup>4</sup> «Me depërtimin masiv të islamit edhe në zonat fshatare të Shqipërisë, aty nga mesi i shek. xviii, rreth 70% e popullsisë shqiptare rezultonte e islamizuar» (Duka 2009: 379).

<sup>5</sup> Valentini (2010: 69–70) informon: «Kështu që u ngrah dhe u organizue më 1750 në Voskopojë Akademia e re “*sbukurimi i vetmë i qytetit*”. Shpirti i saj u bë Theodor Kavalioti i cili u shkrua qytetar i saj dhe drejtoji e i kushtoji tërë jetën e tij Akademisë. Ky ish prej Kavalle dhe mësoji në Janinë në Eugjen Bullgarin ardhni dhe zuri vend në Voskopojë e drejtojë shkollën e madhe të saj gjer sa mundi ta bëjë Akademi. Prej këtij Instituti duallën shumë burra të shquar, që përhapën dritat e diturisë në çdo vend duke u bërë Drejtorë shkollash, mësues e profesora si edhe shkrimtarë» (vijon një listë me emra të shquar).

ruhej në kushte izolimi gjithnjë e më të shtrënguar. «Bashkë me rrënimin e mjaft qyteteve, vala shkatërrimtare e ushtrive turke prishi thesaret më të çmuara të kulturës së kaluar të popullit tonë, rrëzoi përdhe dhe dërrmoi veprat më të bukura të arkitekturës, pallatet madhështore, monumentet, kishat dhe katedralet dhe paralizoi për mjaft kohë jetën dhe gjallërinë e mëparshme ekonomike dhe shoqërore» (Shkodra 1973: 21). Kështu standarti jetësor dhe kulturor i qyteteve Durrës, Shkodër, Prizren, Krujë apo Drisht u rrënuan keqazi duke e humbur peshën e tyre për disa shekuj. Ndryshe ndodhi me kryeqendrat e administrimit otoman si Elbasan, Berat, Gjirokastër, Vlorë, Janinë që vijuan të ngriheshin në nivele të larta ekonomike.

Islamizimi i qyteteve, i cili në fillimet e shek. xvi nuk ishte i konsiderueshëm, në mesin e atij njëqindvjetëshi mori përmasa galopante, kështu, «megjithëse në një pjesë të mirë ato akoma banoheshin nga elementë të krishterë, nga fundi i kësaj periudhe duken edhe tiparet tipike të qyteteve muhamedane» (Shkodra 1973: 28-9) duke arritur deri aty sa «në shek. xvii në qytet[et] tona gati në çdo lagje i binte të kishte nga një ose dy faltore, shkolla ose teqe, që shërbenin për kultivimin e ndjenjës fetare dhe përhapjen e kulturës orientale islame» (*ibid.*: 50).

Turqit sunitë, në dallim nga arabët islamë, nuk e kishin si mision përhapjen e myslimanizmit ndaj edhe nuk e detyruan sistematikisht, por duhet nënvizuar se struktura administrative i çelte dyert vetëm për popullsinë muhamedane, ndërkohë që sistemi fiskal penalizonte jo pak “të pafetë” duke ia thyer gradualisht rezistencën e besimit derisa t’i nënshtroheshin konvertimit në fenë e re që vinte nga Lindja e Afërme<sup>6</sup>, e bashkë me të, pranimin e një sërë ndikimesh në mënyrën e konceptimit të jetës dhe në aktivitetin shpirtëror, posaçërisht në atë të shprehjes tingëllore që ende sot është mjaft aktive në muzikën qytetare ballkanike. Otomanët iu qasën ndryshe popullsisë të Europës jug-lindore, kështu,

<sup>6</sup> Bartl (2006:19) informon: «Por kryesisht të krishterët përqafojnë fenë islame që në këtë mënyrë t’i shpëtonin taksës për kokë (xhizja ose haraçi) dhe detyrimeve të tjera. Në shkrimin anonim: — Përshkrimi i oborreve të perandorisë turke-osmane — p[ë]rk. [latinisht në origjinal] (Bazel 1573) kjo ngjarje përshkruhet në mënyrën që vijon: “Nëse... ndonjë nga të krishterët, sipas vullnetit të tij, duke u paraqitur, njohur botërisht si mysliman bëhej synet, gjë që shpesh edhe ndodhte, për shkak të zgjedhës shumë të rëndë dhe të barrës së taksave, një njeri i tillë nxirrej në të gjitha rrugët dhe sheshet e qytetit, me nderimet më të mëdha e me hare nga populli që i binte lodërtive; ata vetë i jepnin dhuratat të vogla, pastaj ai lirohej nga pagesa e taksave».

«ndërsa sllavët erdhën e u ngulën si kolonistë, dhe romakët bashkuan sundimin politik me kolonizimin, sunduesit e rinj edhe nga shkaku i numrit të tyre të vogël, si shtresë zotërinjsh që ishin, synonin kryesisht pushtimin politik e administrativ të vendeve; ata me pak përjashtime nuk bënë politikë kolonizimi. Në këtë osmanët janë vijuesit e politikës bizantine» (Çabej 1994b: 95).

Gjatë shek. XVI–XVIII të administrimit otoman muzika mbeti e lidhur me ambientet private të shtresave shoqërore të cilat e përdornin për kënaqësi personale, por edhe si mjet pune, duke afruar aftësitë vokale dhe instrumentale në shërbim të ceremonive të ndryshme. Nevojat ekzistenciale e detyruan popullsinë autoktone të gjente mënyra përshtatjeje për të siguruar mbijetesën. Kjo u pa edhe tek ata që merreshin me artin e tingullit, i kuptuar ky kryesisht si mjeshtri ekzekutimi, por jo si krijimtari e mirfilltë. Repertori do të plotësohej gjithnjë e më shumë me melodi të “reja”, domethënë me huazime nga kultura dominuese ushtarakisht, ndërsa fondi i parë, ai më ballkanik, do të ngushtohej pandalshmërisht duke rrezikuar hiçëzimin. Ky zëvendësim i materialit të ekzekutuar dhe pjesmarrja gjithnjë më e shpeshtë e tyre në ceremonira shtetërore dhe private, fakte këto që do ta lidhnin edhe më shumë pushtetin me popullsinë autoktone, detyruan një sistemim ligjor të këtyre organizmave të cilat do të qeveriseshin tashmë nga një aparat legjislativ.

Në këtë mënyrë, nga fundi i shek. XVI vërehet se — në qytetet shqiptare të rimëkëmbura tanimë në formatin oriental, si: Elbasani, Berati, Prizreni, Shkodra, Shkupi etj., — filluan të shfaqeshin forma *esnafore*<sup>7</sup>, të cilat do të përfshinin kategoritë e

<sup>7</sup> ‘Esnafi’ është një bashkim mbi bazë profesionale dhe profili mjeshtror i realizuar gjatë sistemit feudal turk, i cili përfshinte aktivitete të vogla zejtarie dhe tregëtie. Shkodra (1973: 270) informon: «Pothuajse çdo esnaf (sipas besimit) kishte shenjtorin e vet, të cilin e konsideronte si simbol dhe mbrojtës të zejës që ushtronte. [...] Sipas botkuptimit të mbështetur në dogmën fetare, këta pajtorë mbrojtës të esnafit konsideroheshin njëkohësisht si shpikësit e zejeve», për të përfunduar, përmes referimit të Schurtz-it (1903): «Në kushtet e sundimit otoman pajtorët ose mbetën ata të dhjatës së vjetër për kristianët, ose u krijuan të tjerë të botës islamike për muhamedanët». Duke parë se *tajfa*-t muzikore të përmendura nga Shkodra janë ato të jevgjeve muhamedanë, kuptohet se, nëse ka patur ndonjëherë shenjtor muzike të atyre *esnaf*-ve, ai duhet t’i përkiste botës islame. Në të vërtetë nuk na rezulton të ekzistojë ndonjë i tillë në atë kulturë. Duhet pasur parasysh se islami, posaçërisht ai më ortodoks, është përherë i prirur të mënjanojë dhe të shkurajojë çdo tipologji kulturi shenjtorësh me bindjen se askush nuk mund të pozi-

mjeshtrove apo artizanale në sistemin shoqëror, e rrjedhimisht edhe ekonomik, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo formë organizative mbi bazë profesioni. Pak nga pak ky sistem i shfaqur qysh në shek. XVI, në njëqindvjetëshin e mëpashtëm «u bë forma mbizotëruese e organizimit ekonomik të zejtarëve në qytetet shqiptare» (Shkodra 1973: 54). Duket se modaliteti në fjalë mbetet i njëjtë për të gjithë hapësirën ballkanike të përfshirë nën administratën turke<sup>8</sup>.

Njoftimin e parë për organizmat esnafore muzikore në Arbëri e hasim në *Defterë*-t (AIH 1570) të gjysmës së dytë të shek. XVI, ku shfaqen me profesionin e *mehter*-it, domethënë të muzikantit instrumentist, disa emra të gjithë të myslimanizuar<sup>9</sup>, mesa duket, një kushtëzim ky për t’u regjistruar e për të patur mundësi angazhimi në tregun e punës. Përmes mbiemrave kuptojmë se një pjesë e shoqërive të *mehter*-ëve, ashtu si dhe në esnafet e kategorive të tjera profesionale, ishin me karakter familjar.

Grupimi i zejtarëve, me format e veta shprehëse, ka një rol të posaçëm në shoqëri pasi shërben si hallkë ndërlidhëse midis shtresës së fisnikëve — e kufizuar në marrëdhëniet e saj brenda oborreve apo pallateve të pushtetit — dhe popullsisë fshatare, — e mbajtur kjo jashtë çdo modaliteti bashkëveprimi, nëse jo si punëtorë me mëditje. Në këtë mënyrë, ky strukturim aktiviteti në shoqëri, ndonëse në «forma primitive esnafore të vogla», përfshiu edhe instrumentistët e këngëtarët që merreshin me argëtimin muzikor, duke formuar kështu *tajfa* [arab. *shoqëri, grup*] të muzikantëve. Kemi të dhëna (Shkodra 1973: 207) se qysh nga viti 1606 ekzistonte në Elbasan një njësi e tillë mbi bazë *mjeshtrie* që shikonte gjashtë instrumentistë<sup>10</sup>.

Me kohë, shoqëri të tilla ‘lëvizëse’ janë shtuar në numër duke krijuar një urë lidhëse midis botës fisnike dhe asaj bujqësoro-blektorale. Këto *tajfa* me nivel kulturor më të lartë se popullsia fshatare, — ndaj dhe thithnin me lehtësi prej saj çdo mënyrë

cionohet mbi njerëzit, pra ndërmjet krijesës dhe krijuesit të saj.

<sup>8</sup> Shkodra (1973:204), duke iu referuar të dhënave bibliografike, pohon: «Kështu, për Bullgarinë nuk shohim ndonjë ndryshim nga sa paraqitëm më sipër; gjithashtu për Bosnjën apo edhe për krahinat e ndryshme të Rumanisë».

<sup>9</sup> Hasim kështu: Hasan dhe Jusuf Hysejini, Ferid dhe Xhafer Hasani, Sinan Jusufi, Jusuf Memi, Jusuf Ahmedi, etj. *Shiko*: Duka 2001; Tole 2004: 42 dhe 2007: 199.

<sup>10</sup> Këtu duhet të jetë një *lapsus* i autorit pasi në një tabelë të mëparshme (Shkodra 1973: 62) grupi rezultoi në katër njësi, numër ky që duket edhe më i arsyeshëm, aq më tepër nëse i referohemi pagesës së ulët të tyre.

shprehëse artistike, — posedonin edhe aftësinë e imitimit të formave muzikoro-koreutike të shtresave të larta, duke krijuar në këtë mënyrë simbioza risuese falë mendësisë së hapur dhe spekulative ndaj të resë. Është kjo mënyrë procedimi pa *tabù* e cila, me kalimin e shekujve, do të krijojë atë që sot quhet kënga qytetare.

Në këtë mënyrë duhet të jetë përshtatur edhe *avazi*, term ky me origjinë persiane i cili kaloi nga koncepti i motivit vokal të pamizuruar tek ai i gjinisë muzikore *solo* instrumentale apo si pjesë hyrëse e *kaba*-ve që duhet të kenë hyrë përmes sekti të dervishëve qysh në çastet e para të depërtimit otoman, por duket se janë pranuar nga autoktonët vetëm aty nga fundi i shek. xviii<sup>11</sup>.

Në veri, në zonat rurale kryesisht malore, ekzistonin, edhe pse nuk na rezultojnë të regjistruara në *tajfa*, formacione të hershme instrumentale me të paktën dy instrumentistë që luanin në syrlë të shoqëruar nga daullja. Me kohë këto ansamble u shtuan në numër duke u plotësuar kështu «me vegla të tjera tradicionale, si me çifteli, sharki, lauri, fyelli, bilbili etj.» (Sokoli 1991: 230). Në dallim nga *tajfa*-t e njohura ligjërisht, ato të peregjistruara e ushtronin veprimtarinë e tyre ekzekutive thjesht për kënaqësi — e kështu si aktivitet dytësor, — në ambiente kryesisht private.

#### Hapësira publike si “teatër” popullor muzikor

Duket se me fuqizimin e administrimit turk dhe me themelimin, zhvillimin apo me spostimin e rëndësisë mbi disa qytete me peshë në kuadrin e Perandorisë, janë krijuar, — sikurse informon Çelebi (2008), — hapësira kushtuar aktivitetit artistik. Në këtë mënyrë, nën zërin «*Vende dëfrimi*» informohemi për «sheshe dëfrimi në natyrë» (*ibid.*: 83), mjedise «të këndshme për shëtije dhe argëtim në natyrë» (*ibid.*: 140) apo edhe për ambiente të posaçme «*Vende dëfrimi për burra*», pra hapësira «çlodhjeje e dëfrimi, si brenda ashtu edhe jashtë qytetit» (*ibid.*: 120). Në mjaft faqe vihet re se autori i *Seyahatname*-së duket jo pak i prirur të evidentojë të “çuditshmet” e botës shqiptare<sup>12</sup>. Është e qartë se në këto mjedise muzika, e kuptuar kjo si

zbavitëse, kishte rolin e saj, ku nuk mungonin edhe këngët e pasionit të ashikëve apo dylberëve.

Qyteti i Elbasanit — «nusja e Shqipërisë» në të cilin, sipas Çelebi-ut, «filozofë dhe magjistarë të panumërt kohësh të shkuara zunë vend për të banuar» (*ibid.*: 107), — përshkruhet si kryeqendër e qefit dhe e shfrimit plot këngë homoseksualësh, një pjesë të të cilave janë madje ende në përdorim: «Këtu, djelmosha të panumërt të goditur nga dashuria vijnë të këndojnë këngë dashurie për djemtë e pajshëm që ata adhurojnë, buzët e kuqe të të cilëve janë si trëndafila dhe qershi. Ata zbrazin emocionet e tyre kaq ëmbëlsisht dhe trishtueshëm sa bilbilat mbajnë gojën mbyllur me admirim. Në çdo qoshe ka flirtime dhe argëtime dhe të pira dhe orgji, me muzikë dhe këndim dhe të tjera dëfrime ditë e natë, si në prag të Vitit të Ri. [...] Tregëtia lulëzonte në këtë kohë; në dhjetë ditë e net shpenzoheshin lekë baraz me pesë thesare Egjiptiane. Njerëzit e Elbasanit hallakateshin në kënaqësitë e jetës dhe konsumonin ditët dhe netët duke festuar dhe argëtuar si gostitë e Kurban Bajramit. [...] I tërë metropoli është i fshehur në mes të pemëve të gjata dhe vreshtave dhe oborreve. Shkurt, ai është i begatë dhe qytet i vjetër, shtëpi e studiuesve dhe njerëzve virtuozë, poetëve dhe mistikëve»<sup>13</sup>. Elbasani, në përkufizimin final të Çelebi-ut, është «qytet i lashtë e i begatë, vendlindje dijetarësh e burrash të virtytit, vjershëtorësh e mistikësh» (*ibid.*: 122).

Edhe Berati «ka shumë vjershëtorë, njerëz të ditur e që shkruajnë, me dije mjaft të gjëra. Ata janë të sjellshëm e të hijshëm, të zgjuar e të pjekur, më fort të dhënë pas qefit e të pirit sesa pas përkushtimit fetar» (*ibid.*: 82).

Krejtësisht ndryshe paraqitet pjesa tjetër e popullsisë, në të cilën shtegtarët dhe kronistët dallojnë një karakter posaçërisht burrëror, por gjithnjë me këngë në gojë. «Ata janë të veshur e të armatosur me shpenzimet e veta, të veshur me rroba të pastra të trasha të bardha, kanë armë me gjatësi të çuditshme të cilat i mbajnë mbi shpatulla sikur të mos ndjenin peshën e tyre, udhëheqësi duke kënduar një lloj melodie të vrazhdë, jo të papëlqyeshme, dhe të tjerët që bëjnë korin» (Montague 1790: Letra xxvii, *April* 1. O: S: 1717).

Kuptohet: përse i përket stilistikës së këndimit, kemi të bëjmë me atë polifonik, ndonëse autorja e këtyre rreshtave, duke mos qenë e zanatit dhe pa interesin e etnografit, nuk e përshkruan më në detaje procedimin muzikor. Gjithsesi kjo ‘Letër’ e

<sup>11</sup> Na ndihmon në arsyetimin tonë fakti që Beethoveni në *Die Ruinen von Athen (Rrënojat e Athinës)*, Op. 113 (1811) stilizon në ‘Chor der Derwische’ përmes trioletave kërcimin rrotullues tipik të këtij sekti, ndërsa përfigurimi melodik priret të evidentojë sekundën e zmadhuar orientale, ndonëse kompozitori tedesë e trajton më së shumti si veçanti e shkallës minore harmonike, ndërkohë që prek edhe gradin e dytë napolitan që dihet se është me origjinë arabe. Në ‘Korin e Dervishëve’ kulmi semantik arrihet në fjalën ‘Kaaba’.

<sup>12</sup> Të dhëna të tilla furnizohen edhe për Gjirokastrën (Çelebi 2008: 62) dhe Beratin (*ibid.*: 82).

<sup>13</sup> Kemi preferuar të japim një tjetër version të këtyre paragrafeve të përkruara në shqip sipas botimit në anglisht të Elsie (2015) — i cili ndryshon disi nga përkthimi në shqip i Çelebi-ut (2008: 121 dhe 122).

1717-ës ka vlerë të posaçme për etnomuzikologjinë shqiptare, pasi rezultoi si dokumentimi më i hershëm i shumëzërëshit epiriot.

Në dallim nga ansamblet familiare të ciganëve ku rolin e kërcimtareve e luanin vetë gratë e instrumentistëve, në masën e popullsisë autoktone femra mbetet e mënjanuar nga këto veprimtari nëse jo për festime private. Duket pra se arti muzikor në publik i vendasve ishte trajtë dalluese e botës mashkullore. Duhet të ketë ndikuar në këtë kufizim qoftë filozofia islame — e cila depërtonte gjithnjë e më thellë, — e qoftë identifikimi i kërcimit me aktivitetin kryesor të ardhacakëve nomadë, — e nga këtu edhe përjashtimi i femrës autoktone nga ky model veprimtarie. Malte-Brun (2011: 47), duke folur për Kotorrin e fillimit të shek. XIX, informon se «kërcimi dhe muzika nuk do të mund të bënin përparim të ky popull kaq xheloz dhe që i mban femrat në një lloj skllavërie».

Mungesa e femrës në artin e interpretimit, posaçërisht në veri dhe veri-lindje, rrjedhon edhe faktin e përdorimit të veglave vetëm mashkullore. Kështu «instrumenti muzikor kryesor në vend është *gusla* e Dalmacisë, një lloj tubi me një tel të vetëm, të cilës i bihet me një hark. Përveç *gusla*-s kanë edhe gajden dhe një lloj kitare (çifteli) të vogël me dy tela. Kjo është e gjithë orkestra e tyre» (*ibid*: 14).

Është e qartë se gjeografi danez, i cili e ka realizuar veprën e vet në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XIX, flet vetëm për hapësirën gege, ndërkohë që në jugun tosk, prania instrumentale po bëhej gjithnjë e më këmbëngulëse. Qermania (violina) përmendet për herë të parë në Arbëri si vegël ansambli vetëm në 1815-ën (*shiko*: Holland 1815: 70–80), por nga burime dytësore<sup>14</sup> (Bogdani 1997: 373), hamendësojmë se hyrja e saj në Ballkanin Perëndimor duhet të ketë ndodhur shumë më herët, gjithsesi pas ideimit të saj që *Organologjia* e pranon në shek. XVI.

#### **Formacionet muzikore otomane**

Bandat ushtarake turke përmenden për herë të parë nga Barleti (1982b: 121) kur flet për dorëzimin e qytetit të Shkodrës në 1479-ën: «Dhe turqit aty për aty, plot gëzim e hare, midis brohoritjeve dhe

duartrokitjeve u futën brenda në qytet dhe, duke u endur andej e këtej, ngulën flamujt e tyre në të katër anët; i dhanë shkrim qejfit të vet (siç e kanë zakon në raste të tilla) me trumbeta, me daulle e me sa e sa instrumente të tjera, entuziazmi i tyre ishte i pamasë, po çmendeshin nga gëzimi që shtinë në dorë Shkodrën».

Prania e bandava ushtarake otomane, si dhe pushtimi i gjatë kanë bërë të harrohet fakti se Skënderbeu i kishte përdorur këto formacione muzikore qysh në mesin e shek. XV, madje edhe duke i ndërtuar me vegla jo të importuar — «borizanë, brizanë dhe vegla të tjera luftarake të këtij lloji», saktëson Barleti (1982a: 496). Me pushtimin e Arbërisë, bashkë me mërgimtarët u larguan edhe instrumentistët të cilët u integruan në formacione muzikore perëndimore, e madje, duket se lodra është përhapur në Europë pikërisht përmes instrumentistëve të shpërngulur (*shiko*: A.A. 1966).

Reparti këmbësor jeniçer — në turqisht ‘Yeniçeri’, domethënë *milicianët e rinj* — është ideuar në shek. XIV, e fillimisht ndërtohej me djem të rrëmbyer në moshë të vogël kryesisht nga Turqia Europiane, Arbëria në krye, e të stërvitur në mënyrë shumë të rreptë si truproja të sulltanit. Marshimi i tyre shoqërohej me tingujt e bandës ushtarake që ishte nomenklaturë e kësaj njësie *élite*, pjesëtarëve të së cilës u mohojë madje edhe e drejta e martesës. Orientimi fetar mbetej ai bektashi.

*Mehter(ân)* (banda otomane) u krijua në Bursa në 1326-ën dhe ka shoqëruar aktivitetin luftarak e ceremonial perandorak deri në kryengritjen e jeniçerëve në fillim të shek. XIX, fakt që rrjedhoi vendimin e sulltanit të vitit 1826 për shkrirjen e këtij formacioni, e bashkë me të edhe të bandës muzikore si dhe shpalljen e paligjshmërisë së sektit bektashian.

Struktura bazë e *Mehter(ân)*-it që do të rezistojë në kohë rezultoi në vegla: (i) *perkusioni* — *kös* (timpanë të mëdhenj), *daulle*, *piata*, *triangolo*, *zile*, dhe (ii) *aerofonike* — *zurna*, *naffir* (*trombeta*). Të dhënat e cituara nga Shkodra<sup>15</sup> (1973: 207) flasin se «për të kënaqur popullin dhe ushtrinë e këtij qyteti në lulëzim, këta u binin dy herë në ditë daulleve dhe zurnave»<sup>16</sup>.

<sup>14</sup> Bogdani (1997: 373), në një letër të 24 shkurtit 1680 dërguar nga Shkupi ku shërbente si ipeshkëv, shkruan metaforikisht: «[...] non potendo la tigre ac[c]ordarsi col violino, [...]» — (it.) «[...] duke mos mundur tigrin të akordohet me violinën [...]». Nga kjo mënyrë shprehjeje mund të besohet se, nga njëra anë, qysh në gjysmën e dytë të shek. XVII violina kishte hyrë në leksikonin e shprehjeve të urta, — domethënë ishte e njohur e në përdorim të gjërë në jetën reale, — e, nga tjetra, ky instrument vlerësohej si kryesori, si i parë i grupit, pra në rolin udhëheqës melodik.

<sup>15</sup> Arkivi Historik Shtetëror, fondi Sher. Elb., Dosja nr. 13, dokumenti nr. 230.

<sup>16</sup> Pa referime bibliografike Shkodra (1973: 207) megjithatë vijon: «Këto grupe prej 5–10 instrumentistësh të dalluar që na kujtojnë “meistersingerët” gjermanë, apo “menestrelët” shëtitës italianë, i gjejmë në disa krahina të vendit tonë qysh në shek. XVI–XVII». Besojmë se fjala këtu nuk është për formatet ekzekutive që përmend Shkodra, të cilat përfshihen në termin mesjetar ‘guilare’ — zhongler e këndues historik — apo ‘iokular’ — mjeshtër i zbavitjes me



Edhe Çelebiu (1938), duke folur për zakonet muzikore të kryeqytetit perandorak otoman, saktëson se rënia e veglave dy herë në ditë ishte një rit që praktikohesh qysh në kohën e Fatihut, pra të Mehmeti II, sulltani i shtatë që ia doli të mposhtë Konstandinopojën më 1453-shin. Nga kjo kuptohet se jeta e qyteteve ballkanike zhvillonte rituale të ngjashme me ato të kryeqytetit otoman, të detyruara, mesa duket, duke filluar qysh nga mesi i shek. xv.

Çelebi (2008: 73) e rendit drejtuesin e bandës muzikore midis parisë së vendit, por nga listimi i tyre, duket se ai hynte ndër funksionet e rëndomta, i rreshtuar midis personelit administrativ të kështjellës<sup>17</sup>. Realisht, nëse i referohemi citimit të mësipërm nga Shkodra, më shumë se për bandë të vërtetë e të mirfilltë, duhet folur për një thjeshtim në ansambël të atij formacioni, ndaj, drejtuesi i saj, — duke patur në varësi një numër aq të kufizuar individësh, e për më tepër, me formim kulturor e profesional që ishte më pranë muzikës joprofesioniste ‘me vesh’, — nuk mund të gëzonte një autoritet të madh<sup>18</sup>.

Veç kësaj, prania e zurnave — aq të ngjashme me syrlen e autoktonëve — dhe e daulleve — në

---

recitim, këngë, valle e muzikë. Mendojmë se kemi të bëjmë me ansamble të kufizuara që i referohen formacioneve ushtarake të bandës të cilat, duke filluar nga shek. xvii, pikërisht për timbrikën e tyre të zhurmshme dhe të veçantë, — rezultat i unisoneve të zurnave dhe kontrapunkteve ritmike të lodrave, — u bënë të njohura në të gjithë Europën e do të frymëzojnë me ritmikat *alla turca* kompozitorë të ndryshëm të kontinentit të vjetër duke filluar nga të mëdhenjtë Mozart e Beethoven. Në paragrafët në vijim, me të dhëna më të plota rreth *tajfa*-ve të disa qyteteve të tjera të Arbërisë, bindemi akoma më shumë se kemi të bëjmë me një tjetër *lapsus* nga Shkodra në interpretimin e fakteve.

<sup>17</sup> Celebi (2008: 73), duke folur për Berat, shënon: «Qyteti ka edhe këta zyrtarë të lartë: qehajain e spahijve, komandantin e jeniçerëve, dizdarin e kalasë me trupat e tij të garnizonit, voivodën e qytetit, inspektorin e financës, tagrambledhësin, qehajain e kalasë, kreun e bandës muzikore, qehajain e qytetit, kryearkitektin, si dhe nënpunësin e taksës për frymë».

<sup>18</sup> Një përshkrim i Farmer-it (1912: 71) informon se banda jeniçere «përmban zakonisht tre oboe të vogla e dy të mëdha dhe një ose më shumë xhura, të gjitha me një karakter shumë të mprehtë, të cilat sokëllijnë në unison me shoqërimin e tre timpanëve — një i gjerë dhe dy të vegjël, tre ose më shumë tamburë tenor dhe një tambur bas, ndërsa tre palë piatash dhe një çift triangolosh ishin për t'u dhënë ngjyrë shtesë». Ky lloj strukturimi indukon që numri i instrumentistëve duhet të ishte jo më pak se 20 individë, domethënë dyfishi i formacioneve të përmendura nga Shkodra.

përdorim të gjerë në Ballkanin perëndimor shumë më herët sesa shfaqja e otomanëve në këto anë — na orienton të besojmë se instrumentistët duhet të vinin nga radhët e autoktonëve, e nuk do të ishte çudi që madje drejtuesi i tyre të ishte i të njëjtës origjinë.

Në një dokument të viteve 1689–1690 mbi ‘Vepri-met ushtarake në Kosovë...’, kur flitet për aktivitetin në afërsi të Shkupit të dukës së Holsteinit, informohet: «Në mënyrë që ushtarët e tij të dukeshin shumë më tepër sesa ishin në të vërtetë, ai vendosi në radhët e para të gjitha boritë, timpanet dhe veglat e tjera [muzikore] luftarake, për t'u paraqitur si një ushtri e madhe [...]» (Zamputi dhe Pulaha 1990: 306). Duket se teknikat e përdorura kahe-rshëm nga otomanët dhe të huazuara prej Skënderbeut qysh në mesin e shek. xv, replikoheshin rreth dyqindepesëdhjetë vjet më vonë edhe nga formacionet e rregullta europiane.

#### **Përjetimi i aktivitetit muzikor shekullar**

Arti pamor i kohës është treguar aktiv në dokumentimin e jetës muzikore të arbëro-shqiptarëve, ndonëse vlera e tyre është më e madhe për organologjinë pasi nuk mund të furnizojë të dhëna të drejtpërdrejta mbi mjeshtrinë e tingullit, për modalitetet apo format e shprehjes. Kështu vetëm në mënyrë të tërhortë apo përmes paralelizmave mund të hamendësohet se ç'farë lloj muzike praktikohesh asokohe. Duhet patur parasysh se piktorët dekorues të objekteve të kultit nuk e kishin, gjithsesi, kulturën e duhur muzikore, ndaj veprimtaria e tyre artistike nuk i është nënshtruar një gjykimi filologjik, fakt që detyron një kujdes të posaçëm në trajtimin e pamjeve.

Veprat e Onufrit<sup>19</sup> apo ato të Selenicës<sup>20</sup> i referohen jetës blegtorale përmes paraqitjes së barinjve duke lozur në fyell. Këto tema idiliake lidhen me një kryefill shumë të hershëm të lindjes së Kristianizmit ndaj synimi i veprës pamore nuk ka qenë ai i përjetësimit të realiteti, por evokimi përmes ikonizimit i një bote tashmë të arkivuar nga faktet historike. Edhe pse përmes tematikave biblike, mund të deduktohet një shenjë lirije interpretative në këto afreske. Ato krijoheshin si për t'u kujtuar vendasve një të kaluar ku jeta ishte më paqësore, më e amëshuar, më në kontakt me natyrën e virgjër, e gjitha kjo përkundër një realiteti faktik që e detyronte bashkësinë të shkëputej nga ai trung teologjik europian të cilit i përkiste.

Çelebi-u (2008: 65) prek shkarazi ceremoninë martesore të Libohovës ku nusja arrin në mbrëmjen e të enjtes dhe fillon menjëherë dasma, e kështu:

---

<sup>19</sup> Dy afreske të një kishe në Kostur të realizuara në 1547-ën dhe 1553-shin.

<sup>20</sup> Në kishën e Shën Kollit në Voskopojë në 1726-ën.

«Ahengu, këngët dhe zallamahia e festës vazhduan për gjithë natën deri të nesërmen në mëngjes, [...] Me pak fjalë, pata kënaqësinë që, për një javë të tërë, të shihja si bëhet një dasmë shqiptare. Nuk ka fjalë, me gojë a me shkrim, që ta përshkruajë një festë të tillë dasme. Sikur të hidhja në letër të gjitha ato gjëra të bukura e të çuditshme që pashë asaj jave, do të bëhej një libër i plotë e i vërtetë».

Deduktojmë në fjalët e autorit, — një njeri që ia kushtoi tërë jetën udhëtimeve në të katër anët e Perandorisë otomane dhe përshkrimeve të detajuara të tyre, — origjinalitetin e ceremonisë martesore të një familjeje myslimane që e befason skajshmërisht. Por bie në sy edhe etiketimi “dasma shqiptare”, saktësim që do të thotë se kjo etni dallohej jo vetëm për mëvetësi kulturore nga ç’farë e rrethonte, por edhe për unitet kulturor. Nëse kjo tezë është me baza, duhet të pranojmë atëhere edhe faktin se në mesin e shek. XVII shqiptarët vepronin kulturalisht si komb unik e me një identitet etnik të diferencuar nga pjesa tjetër e perandorisë.

Ndërsa Lear (1851: 421–2) na përshkruan vallet femërore të dasmës ku «gra të kapura dorë-përdore, lëviznin këmbët në mënyrë të matur në një gjysëm rrethi të gjerë sipas kadencës së vogël të luajtur me fyej». Kuptohet: autoktonët e Ballkanit perëndimor parapëlqenin jo vetëm gjestikulimin e moderuar e të hijshëm të trupit, por edhe shoqërinë e veglave baritore të trashëguara në shekuj, e që dalloheshin prej atyre të ardhacakëve më të fundit.

### Tipologji të tjera të shprehjes muzikore

Tjetër pamje na shfaqin skena të ndryshme nga jeta shqiptare ku hasim mpleksjen e të shenjtës me profanen. Në afreskun e kishës së Shën Thanasit apo në atë të bazilikës së Libofshit<sup>21</sup> kemi një përfigurim më kompleks. Tek i pari paraqitet një ansambël instrumental me dy syrle të shoqëruara me një lodër. Megjithë veshjen tipike të tyre apo kontekstin fetar të besimit ortodoks, grupimi i muzikantëve shfaq ngjashmëri stilistike me atë të formacioneve të bandave të famshme otomane, në të cilat grupi i instrumentistëve ekzekuton një melodi në *unison* ndërsa një ose më shumë perkusionistë u kontrapunktojnë ritmikisht melodive me një ritëm *ostinato*.

Në kishën e Shën Mëhillit (Vithkuq) formacioni orkestral duket më i plotë. Skena e pikturuar në 1728 pasqyron dy tipe syrlesh: njëra tradicionale, domethënë e drejtë duke u zgjeruar nga tyta dhe tjetra e modifikuar me tutën që ngrihet duke u lakuar të cilën organologjia e njeh si *tibia phrugia*.

<sup>21</sup> Të dhënat flasin se duhet të jenë realizuar nga vëllezërit korçarë Zografi (Konstandin dhe Terpo) respektivisht në vitet 1744 dhe 1782.

Ajo që bie në sy është se tytat janë tashmë metalike, ndërsa në Antikitët, lakim realizohej duke i shtuar syrles një bri kau.

Ambientime të këtilla i hasim në mjaft kisha që arrihen t’i mbijetojnë pushtimit otoman edhe përgjatë ’800-ës. Në njërën prej tyre, e realizuar nga Çetiri<sup>22</sup>, të krijohet përshtypja se instrumentistët mund të jenë ciganë. Formacionet muzikore cigane duhet të kenë qenë shumë të përhapura në Turqinë europiane të kohës. Boué (1854: 71) na bën të ditur se «nganjëherë merreshin me pagesë ciganë për të bërë muzikë gjatë shëtitjeve, ose ndonjë nga grupi merrete kitarrën dhe fashatin (dajren), ndërsa të tjerët këndonin në kor».

Besojmë se edhe ky informacion i Boué-së ka vlerë të posaçme për historinë e muzikës shekullare në Shqipëri, pasi rezultoi si më i hershmi dokumentim i ansambleve të sazeve të jug-lindjes së Shqipërisë. Gjithsesi, këndimi, i yshtur edhe nga dehja e ahënshinjve, zgjaste pa masë, aq sa shoqëruesi, «për t’i ndaluar, ishte detyruar t’i ndiqte ata këngëtarë këmbëngulës me pistoletë në dorë» (Boué 1854:96).

Një afresk i bazilikës së Libofshit, veç instrumentistëve, pasqyron edhe kërcimtarë (meshkuj) në vallen tipike të zonës që ruhet ende sot në kërcimin “polifonik” fshatar të Myzeqesë. Duket qartë se tradita vendase ka shërbyer si model për artin pamar. Valltari i parë tund një shami ndërsa ekzekuton i shoqëruar ‘vallen dyshen myzeqare’ në skemën tipike që parashikon një minimum prej dy aktorësh ku kryesuesi — domethënë: ‘hedhësi’, mbështetet i kapur me dorën e majtë tek ‘mbajtësi’. Instrumenti *aerofon* mbetet ai pastoral, domethënë fyelli, apo *fëjll* siç e përdorin «shqiptarët e Maqedonisë» (Tole 2007: 90), *flojere* (Tole 2007: 95) etj.

Nuk duhet harruar se kërcimi më jetëgjatë ndër ballkanasit autoktonë mbetet *pirriku*, i cili, sipas dokumenteve, shfaqet në kohë të ndryshme në shumë variante. Një nga më të çuditshmit, sigurisht më i veçanti, pasqyrohet nga Giraudet (1900: 18–19), i cili, duke rreshtuar në mënyrë enciklopedike të dhëna mbi tipologji të ndryshme kërcimi, nën zërin «‘Arnaut (*arnaoute*), valle luftarake e grekërve, në 1700-ën. – Masa 2/4’», përshkruan një paradigmë të pahasur më herët: «– Një kavalier dhe një damë, që mbajnë njëri një shkop e tjetra një kamzhik, i tundin ndërsa përplasnin këmbët, lëvizin përpara, vrapojnë, kërcëjnë, hidhen. Ky çift pasohet nga çifte të tjera që gërshetojnë duart, ndërsa imitojnë hapat

<sup>22</sup> Familja grabovare Çetiri ka qenë aktive për 142 vjet me rradhë, e më konkretisht nga 1775-a me Gjergj Prend Çetirin deri në 1866-ën me Gjergj Nikoll Çetirin. Më emërmadhi i tyre mbetet Joani, i cili, gjatë viteve 1792–1813, pikturoi në 65 kisha.

dhe gjestet që bëri çifti i parë. Në të shkuarën grekët shkolin në luftë të ushtruar nga kjo valle, suksesi i të cilës varej nga çifti që e ekzekutonte, e që i drejtonte në lavdi ose në vdekje».

#### **Përmbyllje**

Sikurse u vu në dukje nga ky hulumtim, përgjatë shek. XVI–XVIII, vërehet nga ana muzikore një tendencë e qartë dhe këmbëngulëse në diferencimin midis trashëgimisë autoktone dhe prurjes së ardhacakëve të rinj, e shfaqur kjo qoftë në tipologjinë e formacioneve ushtarake, e qoftë në atë të ansambleve të vogla me përbërje familjare më së shumti ciganë nomadë. Këta të fundit u izoluan kryesisht në periferitë e qyteteve nga ku prireshin të ndërthureshin edhe me botën fshatare shqiptare, fillimisht, — të detyruar nga nevojat ekonomike — përmes konvertimit në besimin e vendasve, e më pas, përmes mpleksjeve shoqërore dhe familjare, këto edhe martesore. Në një situatë të tillë, nuk mund të flitet për individë krijues që t'i kushtohen tërësisht artit të kompozimit, por vetëm për ekzekutues, — pra: këngëtarë, instrumentistë dhe kërcimtarë — veprimtaria e të cilëve kufizohet në ceremonira familjare dhe publike, por gjithnjë në nivel amatorial. Kënga dhe këndimi, — këto përherë e më tepër me tipare orientale dhe të orientalizuar — do të mbesin “krijimtaria” e vetme e cila, me shumë vështirësi, do t'ia dalë të vendosë ura komunikimi midis autoktonëve dhe ardhacakëve më të fundit vetëm diku aty nga gjysma e parë e shek. XIX.

#### **Bibliografia:**

- A.A. 1966. *Armi ed eserciti nella storia universale*. Vol. 3. Torino: Salani.
- BARLETI, Marin (BARLÉZ[Z]IO, Marino), lat. Barletius. 1982a. *Historia e Skënderbeut*. Përkthyer nga Stefan I. Prifti. Bot. III. Tiranë: Shtëpia Botuese «Naim Frashëri». Botimi I 1964.
- BARLETI, Marin (1982b). *Rrethimi i Shkodrës*. Përkthyer nga Henrik Lacaj. Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”.
- BARTL, Peter. 2006. *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare: 1978–1912*. Përkthyer nga Nestor Nepravishta. Tiranë: Dituria.
- BEETHOVEN, Ludwig van. *Di Ruinen von Athen*, Op. 113 (1811). Wien: Wiener philharmonischer verlag, [n.d.] dhe Leipzig: Verlag von Breitkopf & Härte, [n.d.].
- BOGDANI, Pjetër. 1997. Në Odette Marquet, *Pjetër Bogdani, Letra dhe dokumente* (nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit). Shkodër: Shtëpia Botuese “At Gjergj Fishta”.
- BOUÉ, Ami. 1854. *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*. Vol. II. Vienne: Librairie de l'Académie impériale des Sciences.
- BROWN, Edward. 1685. *A Brief Account of some Travels in divers Parts of Europe, Viz. Hungaria, Servia, Bulgaria, Macedonia, Thessaly, Austria, Styria, Carinthia, Carniola, and Frivli : through a great part of Germany, and the Low-Countries: through Marca Trevisana, and Lombardy on both sides of the Po. With some Observations on the Gold, Silver, Copper, Quick-silver Mines, and the Baths and Mineral Waters in those Parts. As also, The Description of many Antiquities, Habits, Fortifications and Remarkable Places*. Bot. II me shumë shtesa. London: Printed for Benj. Tooke.
- BURY, J.B. (*planifikuar nga*). 1923. “The Eastern Roman Empire (717–1453).” Vol. IV i *The Cambridge Medieval History*, botuar nga J.R. Tanner, C.W. Previté-Orton dhe Z.N. Brooke. Cambridge: Cambridge University Press.
- BYRON, George Gordon. 2004. *Shtegëtimet e Çajld Harodit*. Përkthyer nga Skënder Luarasi dhe përgatitur nga Petro Luarasi. Tiranë: Onufri.
- ÇABEJ, Eqerem. 1994a. “Për Gjenezën e Literaturës Shqipe.” Në *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*,

Falë aftësisë së ciganëve nomadë për t'iu përshatur kulturës vendase, në kapërcyell të shek. XVIII–XIX fillojnë të shquhen në të gjitha qytetet ballkanike shenjat e para të lindjes së muzikës urbane. Më konkretisht:

(i) në mpleksjen e autoktones epiriote, thelbësisht *anhemitonike*, me mjeshturinë melizmatike dhe improvizative tipike cigane do të marrë udhë në jug-lindje të Shqipërisë formacioni i sazeve dhe tërë prodhimitaria e tyre artistike;

(ii) në shndërrimin e monodisë geqe, kryesisht *tetrakordike*, me përvijime sipas principeve të *makamatit* të mbartur gjatë shtegëtimit nga endacakët lindorë, mori formë e ashtuquajtura kënga qytetare që u përhap gradualisht në të gjitha qendrat më të rëndësishme të Europës juglindore. Rishtazi Alpet e Ballkanit Perëndimor në dy anët e kufirit verior dhe veri-lindor të Shqipërisë, — lartësira këto vështirë të depërtueshme dhe të dominueshme, — mbetën mjedisi ideal i ruajtjes në kushte izolimi tërësor i autoktones më të virgjër. Por edhe fshatrat më në jug të Shkumbinit rezultuan të papërshkueshme nga ndikimet orientale, falë diferencave sistemike të cilat nuk mundësojnë gërshetimin e *anhemitonizmit* epiriot me *polihemitonizmin* apo edhe mikrointervalizmin e *makamatit* oriental. Është ky fakt që i detyroi ardhacakët nomadë t'i nënshtroheshin gradualisht stilistikës polifonike të ambientit përfaqësues duke e pasuruar atë me fantazinë improvizative instrumentale për të cilën ciganët dallohen posaçërisht.

- përgatitur nga Brikena Çabej, 5–65. Tiranë: MÇM.
- ÇABEJ, Eqerem. 1994b. "Romantizmi në Europën lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare." Në *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, përgatitur nga Brikena Çabej, 67–116. Tiranë: MÇM.
- ÇELEBI (CHELEBI), Evliya (Dervish Mehmet Zilli). 1938. *Seyahatnamesi*. Istanbul: Deylet Bisimevi.
- ÇELEBI (CHELEBI), Evliya (Dervish Mehmet Zilli). 2008. *Seyahatname*. Fols. 352a–372b. Libri VIII. Në *Evlija Çelebiu në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mal i Zi, Ohër, në bazë të dorëshkrimit autograf*, përgatitur nga Robert Elsie dhe përkthyer nga Abdurrahim Myftiu. Tiranë: Shtëpa botuese "55".
- DUKA, Ferit. 2009. *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (studime dhe dokumente)*. Tiranë: UET Press.
- DUKA, Ferit. 2011. *Berati në kohën osmane, shek. XVI–XVIII*. Tiranë.
- ELSIE, Robert. 2015. *Texts and Documents of Albanian History*. <http://www.albanianhistory.net>.
- FARMER, Henry George. 1912. *The Rise & Development of Military Music*. London: Reeves.
- GIRAUDET, Eugénie. 1900. *Traité de la Danse*. Tome II. *Grammaire de la Danse et du Bon Ton a travers le monde et les siecles Depuis Le Singe Jusqu'a Nos Jours*. 6341 Dances. Ou pas differents et articiels de tous genres sur la danse. 3333 Figures De Cotillon; 2000 Pas Choregraphiques; 658 Danses De Salonn; 150 Quadrilles Differents; 200 Articles Sur Les Es Et Costumes et les Belles Manieres en Poutes Circonniances. Paris: 39, boulevard de Strasbourg.
- HOLLAND, Henry. 1815. *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, &c., during the years 1812 and 1813*. London: Longman.
- JOKL, Norbert. 1917. *Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch F. Bopp*. II, *Die Erforschung der indogermanischen Sprachen* III, 109–51. Strassburg.
- LEAR, Edward. 1851. *Journals of a landscape painter*. London: Richard Bentley.
- MALTE-BRUN, Conrad. 2011. *Për Shqipërinë dhe Shqipëtarët (Përmbledhje artikujsh dhe studimesh)*. Përkthyer nga Ilirjana Angoni. Tiranë: Plejad.
- MANDALÀ, Matteo. 2010. "La vita d'un uomo in un palinsesto mai scritto." Në *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925–1992) gewidmet*. Albanische Forschungen 29:75–86. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag.
- MEYER, Gustav. 1885. "Della lingua e della letteratura albanese." *Nuova Antologia*. Vol. I. Roma.
- MONTAGUE, Lady Mary Worthley. 1790. *Letters of the right honourable Lady M—y W—y M—e, written during her travels in Europe, Asia, and Africa to Persons of Distinction, Men of Letter, & c. in different Parts of Europe*. A New Edition, complete in one volume. London: Printed for Thomas Martin.
- SCHURTZ, Heinrich. 1903. "Türkische Basare und Zünfte." *Zeitschrift für Socialwissenschaft*, 6 Band. Berlin: Georg Reimer.
- SINANI, Shaban. 2014. *Kodikët kronografikë të Shqipërisë, Shkrimet dhe dorëshkrimet prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen kombëtare*. Tiranë: Naimi.
- SOKOLI, Ramadan. 1991. "Shikim në të kaluarën." Në Ramadan Sokoli dhe Pirro Miso, *Veglat muzikore të popullit shqiptar*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- ŠUFLAY, Milan. 2004. *Serbët dhe shqiptarët*. Përkthyer nga Hasan Çipuri. Tiranë: Toena.
- SHKODRA, Zija. 1973. *Esnafët shqiptarë, shekujt xv–xx*. Akademia e Shkencave të RPSH – Instituti i Historisë. Tiranë.
- TOLE, Vasil S. 2004. *Cluster, Muzikologji & Kompozicion*. Tiranë: Uegen.
- TOLE, Vasil S. 2007. *Enciklopedia e iso-polifonisë popullore shqiptare, "Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO – Enncyclopædia of Albanian Folk Iso-polyphony, "A Masterpiece of the Oral and Intangible Heritage of Mankind" safeguarded by UNESCO*. Tiranë: Eugen.
- ZAMPUTI, Injac dhe Selami PULAHA, (përgatitur nga). 1990. *Dokumente të shekujve XVI–XVII për historinë e Shqipërisë*. Vëll. IV, (1675–1699). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë. Tiranë.

# GJATËSIA E ZANOREVE NË TË FOLMEN E KARADAKUT TË SHKUPIT LENGTH OF VOWELS OF THE KARADAK OF SKOPJE DIALECT

Asllan HAMITI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski”

Universiteti “Shën Cirili e Metodi”

Shkup, Maqedoni

E-mail: asllan\_hamiti@yahoo.com

## Përmbledhje

Përgjithësisht, si në të gjitha të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallojmë tri gjatësi zanorësh: *të shkurtra*, *të mesme* dhe *të gjata*. Por, vetëm të shkurtrat krijojnë kundërvënien fonologjike me zanoret e gjata, ndërsa zanoret e gjatësisë së mesme nuk krijojnë kundërvënien, ato nga pikëpamja e gjatësisë janë asnjëse. Gjatësia e zanoreve në këtë të folme, si edhe në të gjitha të folmet e tjera gege ka vlerë kuptimdaluese (semantike), si në çiftet minimale të fjalëve: *kos* ~ *ko:s* 'kos-i – kos-a', *çaj* ~ *ça:j* 'çaj-i për pije - shqyej', *boll* ~ *bo:ll* 'mjaft – bollë, lloj gjarpri' ose funksion gramatikor: që të bëjë dallimin e gjinisë së emrit (mashkullor – femëror): *plak* ~ *pla:k* 'plak - plakë', *kunat* ~ *kuna:t* 'kunat - kunatë'; dallimin e numrit (njëjës – shumë): *dishek* ~ *dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *dham* ~ *dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *dollap* ~ *dolla:p* 'një dritare – shumë dritare' etj.

**Fjalë çelës:** gjatësi fonetike, fonologjike, zanore, kundërvënien, fonemë

## Abstract

Generally, as all dialects of geg, thus so and in the Karadak of Skopje, in highlighted syllables in the phonetic view we recognize three length of vowels: short, middle and long. But, short ones create phonological confrontation with long vowels, while middle length vowels doesn't create confrontations, they from the longitudinal view are neutral. The length of the vowels in this dialect, and in all other geg dialects has semantic value, as in minimal couples of words: *kos* ~ *ko:s* 'kos-i – kos-a' (yogurt), *çaj* ~ *ça:j* 'çaj-i (tea) për pije - shqyej', *boll* ~ *bo:ll* (enough) 'mjaft – bollë, lloj gjarpri' or grammatical function: to make the difference of the gender of noun (male-female) *plak* ~ *pla:k* 'plak - plakë' (old man), *kunat* ~ *kuna:t* 'kunat - kunatë' (brother in law); the difference in the number (singular – plural): *dishek* ~ *dishe:k* 'dyshek - dyshekë' (mattress), *dham* ~ *dha:m* 'dhëmb - dhëmbë' (tooth), *dollap* ~ *dolla:p* (window) 'një dritare – shumë dritare' etc.

**Key words:** phonetical length, phonological, vowels, oppositions, phoneme

## 1. Hyrje

Ndërmjet Shkupit, Kumanovës, Gjilanit, Preshevës dhe Kaçanikut shtrihet një krahinë malore që quhet Karadak. Këto vargmale ngjiten përpjetë nga lugina e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës (në lindje), Lugina e Gjilanit (në veri) dhe rrjedha e lumit Lepenec (në perëndim). Ky masiv malor shtrihet në drejtimin jugperëndim – verilindje, me majën më të lartë Ramno që ka 1.651 metra lartësi mbidetare.


Në Karadakun e Shkupit jetojnë popullsi me përkatësi të ndryshme kombëtare: shqiptarë, maqedonas, serbë, myslimanë, turq, romë dhe të tjerë.

Karadaku i Shkupit (që e quajmë edhe Mali i Zi i Shkupit, *maq.* Скопска Црна Гора (Skopska Crna Gora) shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë. Ai përfaqëson një tërësi gjeografike, etnografike dhe gjuhësore. Kufiri verior i Karadakut të Shkupit përkon me kufirin e Maqedonisë me Kosovën. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës dhe të

Likovës, ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec si edhe rruga magjistrale Shkup – Prishtinë.

Në këtë trajtesë do të shtjellojmë gjatësinë e zanoreve të këtij areali gjuhësor, përkatësisht të 11 fshatrave me mbi 15 mijë banorë, pra të katundeve Tanushë, Brezë, Malinë, Bllacë, Luboten, Straçincë, Orllancë, Mojancë, Grushinë. Për shkak se pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave Haraçinë dhe Hasanbeg, që gjenden në jug të zonës, janë të ardhur nga katundet përreth, në aspektin dialektor edhe këto dy fshatra i takojnë këtij areali.

Materialin dialektor e mblodhëm nëpër të gjitha fshatrat e kësaj krahine të banuara me shqiptarë, me pyetje të tërthorta në bazë të një pyetësi dhe me biseda të lira e tematike me informues tipikë të moshuar e të paarsimuar, të cilët nuk kanë munguar për një kohë të gjatë nga vendi i lindjes.



Harta 1. Hartë topografike e Malit të Zi të Shkupit

Mbizotëron mendimi se në një fazë të hershme të zhvillimit, gjuhët indoevropiane në pikëpamje fonologjike dallonin zanore të shkurtra ~ zanore të gjata. Gjatë rrugës së zhvillimit të shqipes, ky dallim në gjatësinë e fonemave zanore ka pësuar ndryshime, që ka sjellë edhe ndryshimin e inventarit të fonemave zanoreve. Thjesht, gjuhët indoevropiane me gjatësi fonologjike janë shndërruar në gjuhë me gjatësi fonetike. Si rrjedhojë e kësaj, gjatësia e dikurshme fonologjike në gjuhën shqipe është trashëguar vetëm pjesërisht. Në fazën e shqipes së shkruar (në fazën literale) në tekstet e vjetra gjejmë të shënuara zanore të shkurtra dhe zanore të gjata (Demiraj 1996: 47). Në studimet albanologjike, përgjithësisht është e njohur se në gjendjen e sotme, në të folmet toske si dhe në shqipen standarde gjatësia e zanoreve nuk ka vlerë fonologjike.

Përgjithësisht, si në të folmet e tjera të gegërishtes, ashtu edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallohen tri shkallë gjatësie: zanore të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Megjithatë, në pikëpamje fonologjike vetëm të shkurtrat kundërvihen me të gjatat.

Gjatësia në të folmet e gegërishtes (si dhe në disa krahina skajore të toskërisë: në Labëri, në Bregdet, në Çamërishten, tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme), edhe sot e kësaj dite përdoret për të diferencuar kuptimin e fjalëve dhe të formave gramatikore. Të tri gjatësitë fonetike (të shkurtra, të mesme dhe të gjata) përbëjnë vetëm një opozicion: të shkurtra e të mesme ~ të gjata. Pra, në aspektin fonologjik dallohen dy shkallë: **të shkurtra ~ të gjata**, nga se kuptimi i fjalëve apo i

formave gramatikore të disa çifte minimale fjalësh dallohen vetëm nga ky tipar. Zanoret me gjatësi të mesme, në të vërtetë janë neutrale, ato nuk kundërvihen (Ismajli, 1987 : 193-200). Bëhet fjalë për një asnjësim të gjatësisë së zanoreve të theksuara, sepse gjatësia e tyre fonetiki është e kushtëzuar.

Kështu, gjatë eptimit të disa fjalëve, gjatësia e caktuar e zanores e bjerr funksionin semantik ose gramatikor dhe ky funksion bartet në mbaresë. P.sh.: Fjalët *plak* dhe *plakë* në toskërishten dhe në shqipen standarde dallohen fonetiki me anë të zanores fundore ë-ë]. Në të folmet gege rënia e ë-ë]-së fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, në këtë rast të ëa]-së. Kështu, emri i gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar shqiptohet me ë] të shkurtër (plāk), ndërsa ai i gjinisë femërore me ëa:] të gjatë (pla:k). Në trajtën e shquar kemi ëpla.k-u, (-i) ~ pla.k-a], ku edhe zanorja e shkurtër edhe zanorja e gjatë shndërrohen në zanore me gjatësi të mesme, nga shkak se gjatësitë më nuk kanë asnjë rol të bartjes së informacionit (nuk është më tregues distinktiv i gjinisë), por rolin e tyre e kryejnë morfemat (mbaresat), përkatësisht fonemat /u/ ose /i/ për gjininë mashkullore dhe /a/ për gjininë femërore. Kalimet e të shkurtrave në të mesme dhe të gjatave në të mesme e anasjelltas, për shkak të kushteve të jashtme fonetike, e lëkundin dhe e ngatërrojnë vlerën fonologjike të gjatësisë.

Kundërvënia e gjatësisë është rezultat i rënies së ëë]-së tek emrat që dikur e kanë formuar shumësin me këtë zanore. Rënia e ëë]-së është shoqëruar me një zgjatim të zanores së temës, të cilën edhe prof. E. Çabej e ka quajtur gjatësi kompensatore. Si

rrjedhim, ka lindur një kundërvënie morfonologjike e temave të njëjësimit me temat gjegjëse të shumësit. Në një kundërvënie të tillë njëjës ~ shumës hyjnë emrat që në njëjës mbarojnë me *-ak, -ik, -ek, -osh, -ec, -oç* dhe ndonjë me *ar* (Osmani I., 2010 : 40-41).

Është e njohur se në të folmet e gegërishtes, gjatësia fonologjike më e shprehur është në të folmet veriore, përkatësisht më e shprehur në nëndialektin e gegërishtes veriore sesa në gegërishten jugore. Pra, duke zbritur më nga jugu, në përputhje me shtrirjen gjeografike të të folmes

hetohet defonologjizimi i gjatësisë, ashtu që në të folmet e toskërishtes veriore kjo kundërvënie më nuk është e pranishme (Osmani Z., 1996 : 19). Në këtë drejtim, në të folmet e gegërishtes qendrore e të Shqipërisë së Mesme hetohet prirja e rrafshimit a njësimi të gjatësisë, por prapëseprapë në gjendjen e sotme ajo është e pranishme (Beci, 1987 : 16).

Gjatë analizës së materialit burimor të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit hetuam disa çifte fjalësh me prirje për njësimin e gjatësisë së zanoreve. Krahaso shembujt:

<i>në nëndialektin e gegërishtes veriore</i>	<i>në të folmen e Karadakut të Shkupit (si edhe në tërë gegërishten jugore)</i>	<i>në toskërishte dhe në shqipen standarde</i>
(ni) dīt ~ (shu:m) di:t	(ni) dit ~ (shu:m) dit	(një) ditë - (shumë) ditë
(ni) gu:r ~ (shu:m) gūr	(ni) gūr (gjur) ~ (shu:m) gurzi (gjurzi)	(një) gurë - (shumë) gur
(ni) malōk ~ (shu:m) malo:k	(ni) malōk ~ (shu:m) malōk	(një) malok - (shumë) malokë
shtāt ~ shta:t	boj ~ shta:t	shtat - shtatë

Megjithëkëtë, konstatim i përgjithshëm është se gjatësia e zanoreve në të folmet Veriore të shqipes shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfolgjike të fjalëve. Po sjellim disa shembuj nga e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve dhe i formave dallohet vetëm nga ky tipar. Pra, te disa çifte minimale fjalësh zanorja e shkurtër me kundërvënien që krijon me zanoren përkatëse të gjatë ka:

a) **Funksion leksikor** (semantik, kuptimdallues): *māz ~ ma:z* 'mëz - mazë', *gjeta ~ gje:ta* 'bleta - gjeta (diçka të humbur)', *dī ~ di:* 'dy - di, njoh (diçka)', *kī ~ ki:* 'ky - ke (ti)', *çaj ~ çaj:j* 'çaj (pije) - çaj (dru)', *rrās!* ~ *rra:s* 'ha! (në pezhorativ) - rrasë (pllakë guri)'; *kōs ~ ko:s* 'kos (bulmet) - kosë (mjet për prerjen e barit)', *bōll ~ bo:ll* 'mjaft - bollë (lloj gjarpri)', *lūgj ~ lu:gj* 'lug, koritë - lugë (për të ngrënë)', *kōt ~ ko:t* 'kot, pa dobi - dremit', *shpāt ~ shpa:t* 'shpat, tatëpjetë, pjerrësirë e malit' - shpatë, pallë, mjet lufte', *māll ~ ma:ll* 'mall (për treg) - mallëngjim', *hāll ~ ha:ll* 'brenjë - hallë, motra e babait' etj.

b) **Funksion gramatikor**. – Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënien e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa funksion leksikor. Kështu, disa emra dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë. Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënien fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë

mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë. Edhe disa folje në mënyrën dëftore njëtohen me zanore të gjatë, ndërsa po këto folje me formë të njëjtë në mënyrën urdhërore dalin me zanore të shkurtër. Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj nga areali gjuhësor i Malit të Zi të Shkupit:

- **dallim në gjini** (mashkullore ~ femërore): *plāk ~ pla:k* 'plak - plakë', *kunāt ~ kuna:t* 'kunat - kunatë', *krūshk ~ kru:shk* 'krushk - krushkë' etj.;

- **dallim në numër** (njëjës ~ shumës): *vēsh ~ ve:sh* 'vesh - veshë', *dhām ~ dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *fishēk ~ fishe:k* 'fishek, gëzhojë - fishekë', *dishēk ~ dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *oxhāk ~ oxha:k* 'oxhak - oxhakë', *dollāp ~ dolla:p* 'dollap - dollapë', *baxhanāk ~ baxhana:k* 'baxhanak - baxhanakë' etj.;

- **dallim në mënyrën e foljes** (dëftore ~ urdhërore): - Siç dihet, mënyra urdhërore ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore. Këto dy forma homonime dallohen midis tyre vetëm nga intonacioni (Grup autorësh, 1995 : 297).

Megjithë përputhjet e këtylla të formave të foljeve në këto dy mënyra në aspektin morfolgjik, vështruar nga ana fonetike e fonologjike në të folmet geqe format e njëjta dallohen sipas gjatësisë së zanores së theksuar: zakonisht zanorja e gjatë që shfaqet në përbërjen e foljes së mënyrës dëftore korrespondon me zanoren e njëjtë të shkurtër të mënyrës urdhërore. Falë kësaj dukurie, te foljet e këtylla pamundësohet homofonia e tyre në format e

mënyrës urdhërore me gjegjëset e tyre të mënyrës dëftore (Grup autorësh, 1995 : 297). Krahaso

shembujt e sjellë nga e folmja në shqyrtim:

<i>mënyra dëftore</i>	<i>mënyra urdhërore</i>
(ju) he:cni	hecni!
hi:pni	hipni!
puno:ni	punoni!
laro:ni	laroni!
(ti) he:c	hec!
ma:t	mat!
me:rr	merr!
hi:p	hip!

Me metodën e fonetikës eksperimentale, prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme tingullore të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1. Me fjalë të tjera, zanorja e shkurtër është njëmorëshe, ndërsa e gjata dymorëshe (Beci, 1995 : 232). Po i njëjti studiues konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7 (Beci, 1985 : 93-109). Përgjithësisht dihet se zanoret e gjata shqiptohen si më të mbyllura sesa të shkurtrat, por përveç këtij dallimi, sidomos në nëndialektin e gegërishtes veriore, të gjatat realizohen edhe si më të prapme (Gjinari, 1989 : 118). Gjatë nyjëtimimit të zanoreve të gjata, aparati i të folurit është më i tendosur sesa gjatë artikulimit të zanoreve të shkurtra (Ismajli, 1987 : 197).

Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve ka qenë karakteristikë e vokalizmit të mbarë shqipes. Mungesa e saj në pjesën më të madhe të të folmeve toske, nga kjo pikëpamje, shihet si një inovacion, zhvillim i këtyre katër-pesë shekujve të fundit, meqë arbëreshët e shpërngulur nga Toskëria

## 2. Përndarja e zanoreve të shkurtra

Zakonisht të shkurtra realizohen zanoret tek emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore. Më të shpeshta janë rastet kur zanoret gjenden:

- Në pozicion para prapagjuhores së shurdhët mbylltore [k], si në fjalët: *xhāk* 'gjak', *shök*, *ük* 'ujk', *gjiks* 'gjoks', *koçāk* 'koçak, kotec'; *dirëk*, *bilik* 'bylyk, tufë' etj.

- Para prapagjuhores së zëshme mbylltore [g] dhe mesgjuhores [g]: *brëg*, *brëgj* 'breg', *lūg*, *lūgj* 'lug, koritë'; *zōg*, *zōgj* 'zog' etj.

- Para lëngëzores sonore [l]: *gjël*, *māl*, *kūlm*, *kōl* 'kuaj', *ēlb*, *dāl*; por kam *da:l* etj. Emrat *gja:l* 'djalë',

e kanë pasur dhe e ruajnë ende gjatësinë fonologjike të zanoreve, ashtu si të folmet periferike.

Si përfundim, nga gjithë sa u tha, del se gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzjerje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm fonetikë (gjatësi fonetike). Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e gjatësisë. Kjo tregon se shqipja në çështjen e gjatësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: toskërishtja dhe shqipja standarde kanë evoluar në tipin fonetik të gjatësisë, ndërsa gegërishtja (edhe pse me mbizotërim të gjatësisë fonetike) ende e ruan tipin fonologjik të gjatësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të gegërisë gjatësitë e tilla janë rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit (Hamiti, 2005 e 2011 : 142). Me synimin që të përftohet pasqyrë më e qartë për gjatësinë e zanoreve në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit, do të përmendim veç e veç rastet më të shpeshta të rrethimit tingullor (fonetik) të tyre, duke sjellë jo pak fjalë me zanore të shkurtra, zanore të gjatësisë së mesme dhe zanore të gjata, që të dalë në pah edhe përndarja (distribuími) e tyre.

*ka:l* 'kalë' njëtohen me zanore të gjatës për arsye se rrjedhin nga latinishtja ballkanike dhe se rënia e tingujve ka lënë gjurmë në zgjatjen kompensatore të vokaleve që i kanë qëndruar kohës (Çabej, 1987 : 53). Edhe pse janë emra të gjinisë mashkullore (djali, kali), në shqipen standarde këta dy emra shkruhen me [ë] fundore (djalë, kalë). Rënia e [ë]-së fundore në të folmet e Veriut ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

- Të shkurtra janë edhe zanoret kur gjenden para paragjuhores mbylltore të shurdhët [t] ose para grupeve të bashkëtingëlloreve [rt], [ëkt], [ësht],



ëft] etj., si në fjalët: *msit* 'mësit, shkues', *plöt, qöt* 'plot', *mrët* 'mbret'; *irt* 'yrt', *fört* 'fort'; *i, e vökt* 'i, e vakët'; *gisht, gjisht* 'gisht', *bisht; plësht, qësht; nxëft* 'nxeh', *ftöft* 'ftoht' etj.

- Para dybuzores mbylltore të shurdhët ëp]: *plëp, qëp; shköp, Shküp, gjëp* 'djep'; *cäp, sqäp; qip* 'qyp' ...

- Para shtegores së shurdhët ësh] dhe afrikates ëç] te disa emra të gjinisë mashkullore të tipit: *kösh, däsh, prësh, çösh, lësh*; *mish, mâish; kapuç, iriç* ...

- Përgjithësisht të shkurtra në këtë të folme shqiptohen edhe zanoret kur gjenden para paragjuhoreve shtegore ësh] e ëz], si në fjalët: *kös, līs; mätz* 'mëz', *brëz* etj.

- Dëgjohej të shkurtra zanoret e theksuara te një numër i konsiderueshëm fjalësh kur ato gjenden para bashkëtingëlloreve ëh], ëj ], ëdh]: *kräh, äh; plëh, qëh; fäj, ftöj* 'ftua, ftonj (për njëjës e për shumës)', *thöj* 'thua, thonj', *vöj* 'vaj (peshku)', *hüj* 'ves', *büjk; ëdh, livädh, gjärdh* 'gardh' e në fjalë të tjera.

- Para sonoreve hundore ëm], ën] si dhe para grupeve të përngjashmuara (asimiluara) ëmb], ënd] në ëm], ën]: *gjim* 'gjym', *gabim, ishim* 'ushqim', *kalëm* 'kalem, laps', *çilim* 'qilim'; *gjim, xhin* 'njerëz'; *qën, çën; tlin* 'tëlyen, gjalpë'; *çobän* 'çoban, bari', *filxhän; dhäm* 'dhëmb', *shkäm* 'shkëmb'; *plüm, qüm* 'plumb; vën 'vend', *fün* 'fund', *katün* 'katund', *kurkün* 'kurkund, askund' e në fjalë të tjera.

- Zanorja e theksuar e rrënjës së foljes në mënyrën dëftore të kohës së tashme, në vetën e parë njëjës në këtë areal, si edhe në të folmet e tjera shqipe, realizohet e shkurtër, sipas tipit: *punöj, däl, shköj, msöj* 'mësoj', *vras, prës* e të ngjashme; ndërsa te foljet ku zanorja është përfutur nga monoftongimi i togzanorshit ëue], kjo zanore e monoftonguar në ëu:] rregullisht shqiptohet e gjatë: *shkru:j* (< shkruaj) 'shkruaj', *gatu:j* (< gatuej) 'gatuaj', *blu:j* (< bluej) 'bluaj'; *pagu:j, pagju:j* (< paguej) 'paguaj' etj.

### 3. Përndarja e zanoreve me gjatësi të mesme

Edhe pse në pikëpamje fonetike në të folmet e gegërishtes, përfshirë edhe të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit, zanoret realizohen me tri lloj gjatësish: të shkurtra, të mesme dhe të gjata (ëä, a., a:]), në pikëpamje fonologjike kemi kundërvënien e dy segmenteve: zanore të shkurtra ~ zanore të gjata, meqë zanoret me gjatësi të mesme janë asnjansë (neutrale) dhe paraqiten si arkifonema. Dihet se gjatësia e mesme fonetiki kushtëzohet nga natyra dhe përbërja e rrokjes, pozita e saj në fjalë e në fjali. Përgjithësisht, me gjatësi të mesme në shqipen na dalin zanoret në pozita të ndryshme në fjalës, me përjashtim të fundit absolut të fjalës. Pra, si zanoret e gjata ashtu edhe zanoret e shkurtra të theksuara gjatë eptimit (lakimit dhe

- Po kështu, te disa mbiemra që mbarojnë në rrokje të mbyllur, zanorja e theksuar dëgjohej e shkurtër: *i, e ftöft* 'i, e ftohtë'; *i, e ngröft* 'i, e ngrohtë'; *i, e sprëht* 'i, e mprehtë'; *i, e përlömt* 'i, e përlyer' ...

- Edhe te disa ndajfolje dhe përemra zanoret na dalin të shkurtra: *gjims, gjimc* 'gjysmë', *söt, k'tü* 'këtu'; *tj, äj* (< ai); *kjt* 'këtë'; *xhit, dixhit* 'çka, diçka' ...

- Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në shumë të folme të tjera të gegërishtes qendrore (Nesimi, 2008 : 53-56), përveç në rrokje të mbyllur, e shkurtër realizohet zanorja ëi] te jo pak emra vetjakë (personalë) me burim oriental (Ymeri, 1997 : 38), që në trajtën e pashquar mbarojnë në këtë zanore, si në emrat: *Xhezmi, Ruzhdi, Sami, Ali, Salj, Balj, Kadri, Bari, Fari, Nuri, Sadi, Shukri* etj.; por kur emri shquhet, e njëjta zanore ndërron gjatësinë: nga e shkurtër shndërrohet në të mesme, sipas tipit: *Xhezmi.ja, Ruzhdi.ja, Sami.ja* ... Emrat e gjinisë femërore në të pashquarën shqiptohen me zanore të gjatë: *Nuri:, Fari:, Sadi:, Shukri:...*, ndërsa në të shquarën gjatësia e zanores asnjansohet, përkatësisht e gjata bëhet e mesme, sipas tipit *Nuri.ja, Fari.ja, Sadi.ja, Shukri.ja* ... Rrjedhimisht, tek emrat e tillë e të ngjashëm, në dallim nga trajta e pashquar ku gjatësia e zanores është tregues gramatikor (zanorja e shkurtër për meshkuj dhe e gjata për femra), në trajtën e shquar në të dy gjinitë emrat bëhen homofone, pra me gjatësi të mesme zanoresh (ki ã:sht Shukri.ja - kjo ã:sht Shukri.ja 'ky është Shukriu - kjo është Shukria').

- Zanoret mund të jenë të shkurtra edhe në rrokje të hapur në fundin absolut të fjalës (Topalli, 1995 : 79), rëndom në fjalëzat njërrrokëshe (meqë janë fjalë të patheksuara, proklitike), si p.sh.: *nä* 'ne', *kj* 'ky', *nj* 'një', *dj* 'dy', *kü, sj, k'tü* 'këtu', *të, më, pö, jö* etj.

zgjedhimit) të fjalës shndërrohen në të mesme, duke bërë rregullimin mekanik të gjatësisë.

Edhe pse trajtohen si zanore të gjatësisë së mesme, megjithatë ato për nga kuantiteti janë më afër të gjatave sesa të shkurtrave, meqenëse, në përgjithësi, me rregullimin mekanik të gjatësisë formohen fjalë që mbarojnë në rrokje të hapur. Po kështu, zanoret e mesme në pikëpamje të hapjes: e hapur ~ e mbyllur janë më afër të gjatave (në shqipen zanoret e gjata janë më të hapura sesa të mbyllurat) (Topalli, 1995 : 79). Në këtë mënyrë, tek emrat e trajtës së pashquar, zanorja e theksuar qoftë e gjatë apo e shkurtër, në trajtën e shquar shndërrohet në zanore me gjatësi të mesme. Për shembull:

- Zanore e shkurtër > zanore e gjatësisë së mesme: *līs > li.sj; i, e li.sit, li.sit, li.sin; li.sat; i, e li.save, li.save, li.sat, (prej) li.save; plūm, qūm > qu.mi; i, e qu.mit, qu.mit, qu.min; qu.mat; i, e qu.mave, qu.mave, qu.mat; brēz > bre.zi; i, e bre.zit, bre.zit, bre.zin; bre.zat; i, e bre.zave, bre.zave, bre.zat; kōs > ko.sj; i, e ko.sit, ko.sit, ko.sin; kīngj > ki.ngji; i, e ki.ngjit, ki.ngjit, ki.ngjin; ki.ngja; i, e ki.ngjave, ki.ngjave, ki.ngjash 'qengj' etj.*

- Zanore të gjata > zanore me gjatësisë së mesme: *u:dh > u.dha, u.dhat, u.dhën, u.dhës; i, e u.dhës, u.dhëve; u:r > u.ra, u.rat, u.rën; i, e u.rës, u.rave, u.rash; gri:k > gri.ka, gri.kat, gri.kën; i, e gri.kave, gri.kave, gri.kash; katuna:r > katuna.ri, katuna.rit, katuna.rin, katuna.rve etj.*

- Rregullimi mekanik i shndërrimit të gjatësisë së zanoreve gjatë marrjes së formave të ndryshme gramatikore sipas analogjisë me fjalët anase, bashkë me përshtatjen e vendit të theksit sipas natyrës së shqipes (nga rrokja e tretë në rrokjen e fundit a të parafundit) në këtë të folme bëhet edhe te huazimet me burim nga gjuhët sllave (maqedonishtja e serbishtja), sipas tipit: *плáта > pllátë > pllát:t > pllá.ta, pllá.tën, pllá.tës, pllá.tave 'ragë, rrogë'; липа > lipë > lí:p, lí.pa, lí.pën, lí.pës, lí.pave 'bli'; домаќин > domaќin 'nikoqir', námештај > nameshtáj 'mobilje', пиявица > pijavāic 'ushujzë', слаткарница > sllatkarni:c 'ëmbëltore' etj.*

- Te një sasi e konsiderueshme foljesh, zanoret e theksuara (qofshin ato të shkurtra ose të gjata), gjatë zgjedhimit shndërrohen në zanore të gjatësisë

#### 4. Përndarja e zanoreve të gjata

Në veprat e shkrimtarëve të vjetër midis shekujve XVI–XVIII, zanoret e gjata janë shënuar me dyzimin (dyfishimin) e dy shkronjave të njëjta (Demiraj, 1996 : 52). Prof. Bahri Beci me metodën e fonetikës eksperimentale (e para e këtij lloji në dialektologjinë shqiptare) ka hartuar një monografi për të folmen e Shkodrës (Beci, 1995 : 179-187; 232), ku studiuesi ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe me zanore në rrethime të ndryshme fonetike. Sipas këtij autori, zanoret e shkurtra në të folmen e Shkodrës shqiptohen në intervalin kohor prej 20 deri më 8 të qindtat e sekondës (qs), ndërsa zanoret e gjata ndërmjet 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata ~ zanoreve të shkurtra është 2 : 1.

Në pamundësi që të masim me saktësi gjatësinë e zanoreve e më pas të nxjerrim vlerat mesatare të tyre, meqë te ne nuk kemi laborator të fonetikës eksperimentale (as që më është dhënë mundësia të shfrytëzojmë mjetet teknike të ndonjë laboratorit fonetik), mund të mjaftohemi tani për tani me konstatimin se edhe për të folmen e Karadakut të Shkupit (si edhe për të folmet e tjera të Veriut) vlen

së mesme, sipas tipit: *punōj > puno.jm, puno.ni, puno.jn; dāl > da.lim, da.lin; shkōj > shko.jm, shko.jn.*

Duhet vënë në pah se rregulli i rregullimit mekanik të gjatësisë së zanoreve në sistemin foljor ka edhe disa përjashtime. Si shembull mund të përmendim disa situata:

a) Foljet që në trup të fjalës dikur në mbarë gegërishten kishin grupe zanoresh (më shpesh ëue], ëye]), sot në Karadakun e Shkupit përdoren në tri forma fonetike: me monoftong të gjatë ëu:], me diftong dytësor ëäu], ose me ëa:] të gjatë (të përfutur nga monoftongimi i diftongut ëäu]). Vetë e përbashkët e këtyre zanoreve (ëu:], ëa:]), por edhe e diftongjeve është se ato gjithnjë shqiptohen të gjata, si: *blu:j (< bluej) 'bluaj', pagu:j, pagju:j (< paguej) 'paguaj', shkra:j, shkrau:j (< shkru:j, shkruiej) etj.*

b) Po kështu, foljet e mënyrës dëftore me zanore të shkurtër të theksuar, të tipit: *punoj, shkoj; dal, mjel, pres; marr etj.*, pjesoret e këtyre foljeve shqiptohen me zanore të gjatë: (kam) *punu:* (puna:, punâu) (kam) 'punuar', *shku:* 'shkuar', *da:l* 'dalur', *mje:l* (me:l) 'mjelë', *pre:* 'prerë', *ma:rr* 'marrë'.

c) Kuantiteti i zanores në rrënjë të foljes nuk ndryshon në mënyrën urdhërore as edhe kur ndryshon përbërja rrokjesore, duke i shtuar foljes trajta të shkurtra të përemrave vetorë. Krahaso: *gërko!, gërkoje!, gërkonil!* 'kërko!, kërkoje!, kërkonil!'; *laro!, laroje!, laroni!* 'lëvro!, lëvroje!, lëvronil!'; *puno!, punoje!, punonil!*

barazimi i njohur: *një zanore e gjatë = dy zanore të shkurtra.*

Mbështetur në të dëgjuarit e vëmendshëm gjatë vjeljes së materialit dialektor si dhe në kontaktet e mia pesëdhjetëvjetëshe të përditshme me folës të Karadakut të Shkupit, të gjitha zanoret (të gjatat, të mesmet e të shkurtrat) në këtë areal gjuhësor janë diçka më të shkurtra sesa në grupin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore (me qendër në Shkodër, si qyteti më i madh) dhe në gegërishten verilindore (e njohur edhe si kosovarishte). Megjithëkëtë, raporti 2 : 1 mbetet i pranueshëm e i mundshëm edhe për këtë të folme, meqë të gjitha zanoret na dalin pak më të shkurtra, kështu që raporti matematikor mbetet i pandryshueshëm, po i njëjti.

Në bazë të kësaj që u tha, po të përpiqemi të japim një vlerësim përgjithësues, atëherë mund të themi se kundërvënia fonologjike që realizohet në gjatësinë e zanoreve në të folmet e gegërishtes bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike: sa më në veri që gjendet e folmja aq më shumë realizohet kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë (përfshirë edhe kundërvënien zanore gojore ~

zanore hundore). Duke zbritur më nga jugu nëpër Gegëri, funksioni i gjatësisë dhe i hundorësisë së zanoreve zvogëlohet, zbehet ashtu që çiftet minimale të fjalëve me opozicion fonologjik zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë si dhe zanore gojore ~ zanore hundore janë më të rralla e më të rralla.

Sido që të jetë, dy gjatësitë fonologjike të zanoreve (e shkurtër ~ e gjatë) në vetëdijen komunikuese të folësve të shqipës së Karadakut të Shkupit kanë funksion kuptimdalues e më shpesh funksion gramatikor, në mungesë të ndonjë treguesi tjetër për të bërë dallimin midis dy çiftesh minimale fjalësh. I njohur në shumë gjuhë të botës është edhe fakti se ndërmjet dy izoglosave që kanë dallime të thella njëra me tjetrën, sidomos në fushën e fonetikës, shpeshherë gjendet një 'zonë e mesme, e ndërmjetme, kalimtare, tranzitive', ashtu që kalimi nga një tip izoglose në tipin tjetër bëhet në mënyrë të shkallëshkallshme, graduale, me ndërthurje e gërshetime, duke u shuar një dukuri e duke u shfaqur një dukuri tjetër (Trubeckoi, 1985 : 475).

Nga kjo pikëpamje, pozita gjeografike e Malitz të Zi të Shkupit (në jug të Kosovës dhe në veri të Maqedonisë) ka bërë që edhe në pikëpamje gjuhësore të jetë një zonë kalimtare ndërmjet grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore dhe gegërishtes verilindore (kosovarishtes). Në të vërtetë, fshatrat që janë pikërisht në zonën kufitare me Kosovën, Tanusha dhe Bllaca edhe gjuhësisht na dalin si të folme të gegërishtes qendrore me shumë elemente gjuhësore të gegërishtes verilindore, ndërsa të folmet e tjera që shtrihen më në jug kanë më shumë elemente të gegërishtes qendrore e më pak të gegërishtes verilindore.

Shpjegimet e mësipërme na japin të drejtë të pohojmë se këtu e gjen arsyen e fillimit të shprehisë nyjetimore të këtij areali (Beci, 1987 : 14-18) për të defonologjizuar dhe denazalizuar zanoret në krahasim me të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore (Beci, 1995 : 35-43). Këtë proces, sipas gjithë gjasash, e ndihmojnë edhe ndikimi i shqipës standarde si edhe ndikimi i gjuhëve të tjera në takim (serbishtja e maqedonishtja, që nuk njohin gjatësi e hundorësi zanoresh).

Në bazë të materialit burimor të vjelë në terren, në këtë të folme, si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes, zanoret e gjata gjenden në këto raste:

- Si rezultat i gjatësisë së trashëguar historike, kur nga fjalë të gjata me rënie tingujsh e rrokjesh janë përfutur fjalë më të shkurtra, si: *ku:t* < lat. cubitus, *de:t* < lat. deubetos, *mje:k* < lat. medicus, *ka:l* < lat. cabalus.

- Nga rënia e ëë]-së së patheksuar në fundin absolut të fjalës është shkaktuar zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse, ashtu që zanorja që gjendet para saj tani shqiptohet e gjatë. Zanore të tilla kemi

sidomos tek emrat e gjinisë femërore në trajtën e pashquar, sipas tipit: *na:n* 'nanë', *do:r* 'dorë', *a:r* 'arë', *fa:r* 'farë', *pu:n* 'punë', *mo:ll* 'mollë', *fu:sh* 'fushë', *pu:l* 'pulë', *ça:f* 'qafë', *ma:c* 'mace, macë', *o:d* 'odë', *fla:k* 'flakë', *pu:shk* 'pushkë' etj.

- Mosshqiptimi i ëë]-së te disa emra ka bërë të mundur të dallohet forma e njëjësit nga shumësi. Krahaso: *fishëk* - *fishë:k* 'fishëk - fishek', *dishëk* - *dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *jelëk* - *jele:k* 'jelek - jelekë', *jastëk* - *jaste:k* 'jastëk - jastëkë', *lejlek* - *leje:k* 'lejek - lejekë'.

Rast të njëjtë kemi edhe te pak emra të gjinisë mashkullore (që shqiptohen me zanore të shkurtër dhe emra përkatës të gjinisë femërore (që shqiptohen me zanore të gjatë, që janë përfutur nga rënia e ëë]-së fundore), si: *plāk*, *qāk* - *pla:k*, *qa:k* 'plak - plakë'; *kunāt* - *kuna:t* 'kunar - kunatë'; *krūshk* - *kru:shk* 'krushk - krushkë' etj.

- Po kështu, zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse kemi edhe te mbiemrat e nyjshëm, si p.sh.: *i*, e *māir* (< i mi:r < i mirë); *i*, e *gja:n* (< i gjanë); *i*, e *gja:t* (< i, e gjatë); *i*, e *le:t* (< i, e lehtë); *i*, e *kfe:llt*, *fke:llt* (< i, e kthjelltë) ...

- Rastet më të shpeshta e me gjatësi më të shprehur qartë na dalin kur zanorja gjendet në pozitë absolute fundore të fjalës (qoftë kur ruhet si monoftong apo në formë të diftonguar), si: *brī:*, *hī:*, *mullī:*, *mullāi:*, *kusī:*, *kusāi:*, *drī:*, *gjā:*, *kurgjā:*, *shullā:*, *zā:*, *gra:*, *frē:*, *drū:*, *hū:*, *dhe:*, *ka:*, *vlla:*, *shpāi*, *kutāi*, *shāi*; kam (kom) - *la:*, *pa:* *gje:* 'ble:', *pre:*, *da:* 'nda:' ...

Kjo gjatësi maksimale e zanoreve në pozitë fundore absolute mund të shpjegohet me kushtet ideale për t'u zgatur, për t'u nyjetuar për një kohë më të gjatë, pa u ndërprerë nyjetimi nga tinguj të tjerë pasues. Te fjalët e shënuara më lart, disa zanore ose diftongje shqiptohen me hundorësi. Hundorësia e tyre është gjurmë e ekzistencës së ëë]-së që ka pasur dikur në rrënjë të fjalës në trajtën e pashquar, pas zanores së sotme hundore ose diftongut hundor (në të kaluarën: tr. e pashq *pēn* – tr. e shq. *pēni*; sot: tr. e pashq. *pē* – tr. e shq. *pēni*).

- Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit zanore të gjata dëgjuam edhe në rrokje të mbyllur. Zakonisht, përveç për shkaqe historike, të gjata janë edhe zanoret kur pas tyre përdoren tingëllueset ë], ëll]; ër], ërr]: *gja:l* 'djalë', *va:l* 'valë', (kam) *da:l* 'dalë', (jam) *fa:l* 'falë', *ba:ll* 'ballë', *musa:ll* 'tregim, përrallë', *mura:ll* 'mullar', *i rra:ll* 'i rrallë', *ma:ll* 'mallë', *i xha:ll* 'i gjallë', *katuna:r* 'katundar', *buna:r* 'bunar, pus', *shipta:r* 'shqiptar', *malso:r* 'malësor', *bu:rr* 'burrë', *vo:rr* 'vorr', *ke:rr* 'qerre' etj.

- Do theksuar se në këtë të folme, si dhe në të folme të tjera shqipe në Maqedoni, fjala vjen në të folmen e Dervenit (Nesimi, 2008 : 371), ka raste ku zanorja edhe pse gjendet në pozicion para

sonanteve ër] ose ërr] nuk shqiptohet e gjatë, si në: *asker* 'ushtar', *minder*, *shofer*, *sheqer*, *Baftjar*, *terr* etj.

- Në këtë të folme si e gjatë shqiptohet edhe zanorja ëi:] tek emrat që kanë prapashtesën sllave -ica (icë, i:c), sipas tipit: *magjari:c* 'gomare', *bulli:c*, *bullâic* 'buallicë'.

- Po kështu, ëi:]-ja artikulohet e gjatë edhe te patronimet e gjinisë femërore të formuar nga emrat e burrave të tyre, duke shtuar prapashtesën sllave -i:c. Kjo mënyrë e tillë e formimit të patronimeve (tregues i patriarkatit të skajshëm) është karakteristikë e shumë të folmeve shqipe në Maqedoni (Nesimi, 2008 : 371). P.sh.: *Dauti:c*, *Hasani:c*, *Arifi:c*, *Murati:c* etj. Shprehi nyjetimore e këtij areali gjuhësor është edhe shqiptimi me ëi:] të gjatë i toponimeve *Runi:c*, *Goshi:nc*, *Corroti:c*, *Zhuni:c*, *Presni:c*, *Vaksi:c*, *Përlepni:c*, *Reçi:c* etj., që si emra të gjinisë femërore (Runica, Goshinca, Corrotica, Zhunica, Presnica, Vaksica, Përlepnicë, Reçica) kanë bjerrë ëë]-në fundore dhe kjo ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

- Të gjata janë edhe zanoret e përfutuara nga monoftongimi i togjeve vokalike ose diftongjeve ëue], ëie], ëye]. Krahaso shembujt: (kam) *shku:* ( < shkue ), *bu:ll* ( < buell ), *ftu:* ( < ftue ), *kru:* ( < krue ), *knu:s* ( < knues, këndues ), *tru:ll* ( < truell ), *du:* ( < due ), *di:ll* ( < diell ), *çi:ll* ( < qiell ), *mi:ll* ( < miell ), *dhe:t* ( < dhjet, dhjetë ), *pe:k* ( < pjek ), *pe:shk* ( < pje:shk, pjeshkë ), *fi:ll*, *fâill* ( < fyell ), *di:r* ( < dyer ), *di:ll* ( < dyell ) etj.

- Në këtë areal gjuhësor kemi vërejtur një dukuri fonetike mjaft interesante, veçmas në fshatrat Brezë, Malinë e Grushinë: zanorja ëu:] e theksuar e gjatë së pari është shpërbërë në diftongun dytësor

**Përfundim**

Tri shkallët e hapjes, tri radhët e formimit dhe mungesa ose prania e buzorëzimit të zanoreve në gjuhën shqipe përbëjnë tipare dalluese të qëndrueshme, që nuk varen as nga pozicioni as nga përndarja e tyre. Në mënyrë të përgjithshme, vështruar nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike,

5 të shkurtra: /ă/ /ë/ /ö/ /ĩ/ /ũ/  
 5 të gjata: /a:/ /e:/ /o:/ /i:/ /u:/  
 4 hundore: /ã/ /ẽ/ /ĩ/ /ũ/

Në rrokje të patheksuar përdoret edhe zanorja e shkurtër ëë], që ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës.

Këto 14 fonema zanore kanë fushë të gjerë përhapjeje, përkatësisht realizohen nëpërmjet modifikimeve të ndryshme si alofone, deri sa edhe si diftongje gjatë shpërbërjes së /i/-së dhe të /u/-së në dyzanorësh: /i/ në ëai], ëëi], ëëi]: *shpâi*, *shpëi* (<

ëâu], e pastaj ky dytingullsh është monoftonguar në ëa:] të gjatë, nëpërmjet disa fazave: *arúshë* > *arú:sh* > *arâush* > *ara<sup>u</sup>sh* > *ara<sup>ë</sup>sh* > *ará:sh*. Raste të tilla kemi edhe në format e fjalëve: *ca:c* ( < câuc < cu:c < cucë ), (kam me) *puna:* ( < punâu < punu: < punue ), *u mashtra:m* ( < u mashtrâum < u mashtru:m < u mashtruem ) etj.

- Zanore të gjata ndeshim edhe në sintagmat që fonetikiisht përbëjnë një fjalë të vetme (sandhi), gjatë takimit të dy zanoreve të njëjta, të tipit: *ujti:ukrojt* ( < ujt i krojt ) 'uji i kroit', *gjali:ujem* ( < djali i jem ) 'djali i im, djali im', *kali:uvet* ( < kali i vet ), *dele:ubardh* ( < dele e bardhë ) etj. Në të vërtetë te këto sintagma si dhe te togfjalëshit e tillë të ngjashëm kemi një tërësi theksore, fonetikiisht një fjalë të vetme, një fjalë fonetike; në pikëpamje morfologjike të formuar nga një emër + përcaktor ose emër + përemër pronor (Савицка – Спасов, 1997 : 195-205).

Nga shembujt e sjellë, duket qartë se edhe për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, lidhur me kuantitetin e zanoreve vlejné rregullat e gjuhësisë së përgjithshme, siç janë konstatimet se: gjatësia e zanores është në raport të drejtë me hapjen ~ mbylljen e saj: sa më e hapur është zanorja aq është edhe më e gjatë, dhe sa më e mbyllur të jetë ajo është më e shkurtër (Trubeckoi, 1985 : 162). Zanorja ëë] është më e shkurtra dhe nuk shfaqet në rrokje të theksuar në të folmet e gegërishtes, ajo përdoret vetëm si e shkurtër dhe nuk e ka fituar statusin e fonemës. Në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera të dialektit të Veriut, kjo zanore (ëë]-ja) ka frekuencë dhe distribuim të vogël (Gjinari, 1988 : 50-51), me tendencë të humbjes (Beci, 1995 : 101).

kjo e folme ka një sistem zanorësh me kundërvënie fonologjike të gjatësisë (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) dhe të hundorësisë (zanore gojore ~ zanore hundore). Rrjedhimisht, kjo e folme ka një inventar me 14 fonema zanore të theksuara (10 gojore dhe 4 hundore), nga të cilat:

/ĩ/ /ũ/  
 /o:/ /i:/ /u:/  
 /ĩ/ /ũ/

shpi, shtëpi), dhe të /u/-së në ëâu]: *nâuse* si dhe në formë të monoftonguar *na:se* ( < nuse ); diftongoide ëã]: *ca<sup>ë</sup>ng* ( < cung ), *rra<sup>ë</sup>sh* ( < rrush ); ëu]: *ku<sup>o</sup>dër* ( < kodër ), *mu<sup>o</sup>tër* ( < motër ), *i vu<sup>o</sup>gël* ( < i vogël ); sekuenca diftongore ë<sup>i</sup>e]: *g<sup>j</sup>eth*, *l<sup>e</sup>për*, *l<sup>e</sup>tër*, *v<sup>e</sup>ga* ( < gjeth, lepur, letër, vegë ) etj.

Këto fonema në rrokje të theksuar në trekëndëshin akustik mund të paraqiten kështu:

a) të shkurtra  
 /i/ /u/

b) të gjata  
 /i:/ /u:/

c) hundore  
 /ĩ/ /ũ/

/e/ /o/  
/a/

/e:/ /o:/  
/a:/

/ä/ /ã/

Zanoret e theksuara janë afërsisht dy herë më të gjata sesa të patheksuarat. Këtu na dalin 6 zanore në rrokje të patheksuar:

ëa], ëe], ëë], ëo], ëi] dhe ëu].

Përgjithësisht, si në të gjitha të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në të folmen e Malit të Zi të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallojmë tri gjatësi zanoresh: të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Por, vetëm të shkurtrat krijojnë kundërvënie fonologjike me zanoret e gjata, ndërsa zanoret e gjatësisë së mesme nuk krijojnë kundërvënie, ato nga pikëpamja e gjatësisë janë asnjansë. Gjatësia e zanoreve në këtë të folme, si edhe në të gjitha të folmet e tjera gege ka vlerë kuptimdalluese (semantike), si në çiftet minimale të fjalëve: *kos* ~ *ko:s* 'kos-i – kos-a', *çaj* ~ *ça:j* 'çaj-i për pije - shqyej', *boll* ~ *bo:ll* 'mjaft – bollë, lloj gjarpri' ose funksion gramatikor: që të bëjë dallimin e gjinisë së emrit (mashkullor – femëror): *plak* ~ *pla:k* 'plak - plakë', *kunat* ~ *kuna:t* 'kunat - kunatë'; dallimin e numrit (njëjës – shumë): *dishek* ~ *dishe:k*

'dyshek – dyshekë', *dham* ~ *dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *dollap* ~ *dolla:p* 'një dritare – shumë dritare' etj.

Edhe pse zanoret hundore janë pjesë e shprehisë nyjëtimore të Shqiptarëve të Malit të Zi të Shkupit, ekzistenca e një numri të vogël të çifteve minimale fjalësh që dallohen nëpërmjet opozicionit fonologjik zanore gojore ~ zanore hundore dëshmon për prirjen e kësaj të folmeje, si edhe e të folmeve të tjera gege (në jug më shumë e në veri më pak) për humbjen e vlerës fonologjike të hundorësisë, përkatësisht prirjes për defonologjizimin e hundorësisë (që thuaja se gjendet në fazën e fundit) dhe të gjatësisë së zanoreve (që ka filluar të lëkundet, por ende ruhet). Nga materiali i vjelë dialektor e kemi pasur shumë vështirë të veçonim çifte të tilla fjalësh të cilat hundorja i kundërvihet zanores përkatëse gojore për të krijuar fjalë me kuptim të ndryshëm. Çifte të tilla minimale fjalësh kemi mundur të gjenim pak:

#### Bibliografi:

- BECI, Bahri (1995), *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë.  
BECI, Bahri (1987), *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë.  
ÇABEJ, Eqrem (1987), *Studime gjuhësore III*, Prishtinë.  
DEMIRAJ, Shaban (1996), *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.  
GRUP autorësh (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë.  
GJINARI, Jorgji (1989), *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë.  
GJINARI, Jorgji (1988), *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë.  
HAMITI, Asllan (2005, 2011), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup.  
ISMAJLI, Rexhep (1987), *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë: 197.  
ISMAJLI, Rexhep (1987), *Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara në gjuhën shqipe*, Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë.  
NESIMI, Remzi (2008), *E folmja e Dervenit*, Tetovë.  
OSMANI, Ismet (2010), *Ndërrimet morfonologjike në gegërishte*, Shkup.  
OSMANI, Zihni (1996), *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup.  
САВИЦКА, Ирена – СПАСОВ, Људмил (1997), *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје.  
TOPALLI, Kolec (1995), *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë  
TRUBECKOI, N. S. (1985), *Parime të fonologjisë*, Prishtinë.  
YMERI, Haki (1997), *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup.

**VENDI I LEKTYRËS NË PLAN-PROGRAMIN MËSIMOR TË SHKOLLAVE TË MESME NË  
MAQEDONI GJATË PERIUHDHËS (1973-2015)  
READING MATERIAL PLACEMENTS IN HIGH SCHOOL'S PROGRAMS IN MACEDONIA  
DURING THE PERIOD (1973-2015)**

Farketa DIBRA - ZEQRIRI  
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski"  
Universiteti "Sh. Cirili e Metodi"  
Shkup, Maqedoni  
Email: farketadibra@gmail.com

### **Përmbledhje**

Zhvillimi i arsimit shqip në Maqedoni ka qenë i kushtëzuar nga rrethanat kulturore, shoqërore dhe politike. Pas Luftës së Dytë Botërore e këndeje, duke kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit të shkollës shqipe, lektyra letrare nuk pati vendin e duhur dhe të barabartë me fushat e tjera mësimore. Pas viteve të 90-ta, me ndryshimet politike që u bënë në vend, sipas plan-programeve bashkëkohore të gjuhës shqipe lektyra letrare është konceptuar si fushë e posaçme e lëndës mësimore me përmbajtje dhe orë të veçanta, gjë e cila e bën atë të radhitet në plan-programet bashkëkohore të gjuhës amtare të vendeve me sistem të avancuar të arsimit, d.m.th. zë vendin e merituar që është dashur ta ketë edhe më herët. Në këtë punim jemi orvatur të japim një pasqyrë rreth vendit të lektyrës shkollore në periudha të caktuara historike. Hulumtimin e kemi mbështetur në të dhënat që nxorëm nga plan-programet e shkollave të mesme, të cilat i siguroam nga Arkivi i Shtetit të Maqedonisë.

**Fjalë çelës:** lektyrë, shkollë, plan-program, gjuhë, nxënës.

### **Summary**

The development of Albanian education in Macedonia has been conditioned by cultural, social and political circumstances. After the Second World War, passing through different periods of Albanian school development, Albanian reading materials have not had equal placement with other studying fields. With political changes which came after the 90's, according to contemporary plan-programs of Albanian Language, literary reading materials have been viewed as a special field of the subject with content and specific classes, which has ranked it in line with contemporary plan-programs of mother-tongue of places with a well-developed education system. So, it takes the rightful place which it should have had even earlier. In this paper, an effort has been made for an overview about the reading material placement in certain historic periods of time. The research is based on data taken from high school, which were secured from the State Archive of the Macedonian State.

**Key words:** reading material, school, plan-program, language, students etc.

### **Hyrje**

Historia e arsimit shqip në Maqedoni është e lidhur ngushtë me fatin e popullit shqiptar, me rrethanat historike, shoqërore, politike e kulturore, me një fjalë, ajo del e lidhur ngushtë me jetën tonë kombëtare nëpër shekuj. Para shkollës shqipe në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore paraqiteshin sfida të ndryshme që pengonin zhvillimin normal të edukimit dhe arsimit të shqiptarëve në këtë republikë Jugosllave (Mustafa 1998: 11-12). Përkundër kësaj gjendjeje populli shqiptar gjithmonë qëndroi i palëkundur kundër rrebesheve të kohës, këtë guxim dhe rezistencë ia jepte dëshira dhe etja për arsimim dhe dituri në gjuhën amtare. Në plan-programet e shkollës shqipe, si për ciklin fillor, ashtu edhe për atë të mesëm shihet se përqindjen më të madhe të orëve e zë lënda e gjuhës shqipe dhe e letërsisë. Në këto programe

mes tjerash është përcaktuar edhe lektyra, si fushë më vetë për t'u punuar. Meqenëse, kumtesa në fjalë lidhet me vendin që zë fusha e lektyrës, si pjesë përbërëse e plan-programit të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, e kemi përqendruar vëmendjen në këtë fushë, për të parë vendin dhe rëndësinë e saj ndër vite.

Roli dhe rëndësia edukativo-arsimore e lektyrës është jashtëzakonisht e madhe, mbi të gjitha ajo synon:

- ta nxisë nxënësin të punojë në mënyrë të pavarur me librin;
- të mundet, nxënësi në mënyrë të pavarur të sjellë gjykime mbi vlerën ideo-artistike të veprës letrare;
- ta zgjerojë kreativitetin dhe imagjinatën;
- ta pasurojë fjalorin;

➤ ta përmirësojë kulturën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim etj. Rëndësia dhe vlera e veçantë shihet edhe në funksionin pedagogjik që luan ajo, pasi që nëpërmjet veprave të planifikuara si lektyra, synohen të formohen vlera humane tek nxënësi, të vendoset një sistem i vlerave të përshtatshme për njeriun bashkëkohor, si dhe për vlerësimin e të mirës dhe të bukurës. Vlera, kësaj fushe i shtohet edhe me karakterin plotësues të programit, sepse nëpërmjet saj nxënësit njihen edhe me veprat e autorëve të tjerë që nuk janë të planifikuar në plan-program dhe, në këtë mënyrë i plotësojnë njohuritë e tyre të përgjithshme. Prandaj, lektyra duhet kuptuar dhe përdorur si: përmbajtje, mënyrë, mjet, formë, aktivitet dhe kusht për ngritjen e kulturës së leximit dhe kulturës nga letërsia tek nxënësit, në kushte dhe rrethana konkrete pedagogjike në shkollë dhe qëllimisht të vazhduara edhe në kushte dhe rrethana familjare. Duke marrë parasysh këto anë pozitive, gjykojmë se trajtimi, interpretimi dhe vendi i saj duhet të jetë i veçantë në plan-programin mësimor.

Parashtrohet pyetja: *Si është trajtuar dhe radhitur lektyra në plan-programet mësimore në të kaluarën dhe ç'vend zë sot?*

### **1. Vështrim krahasimtar mes programeve mësimore të gjuhës amtare prej vitit 1973-2015**

Për t'u përgjigjur në këtë pyetje u bëmë një analizë dhe krahasim të plan-programeve të gjuhës amtare, duke filluar që nga viti 1973-2015. Nga kjo analizë arritëm të konstatojmë, se pas Luftës së Dytë Botërore e kënde, duke kaluar nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit të shkollës shqipe, lektyra nuk pati trajtimin e duhur dhe të barabartë me lëmitë e tjera mësimore. Madje, ka pasur raste kur lektyra është kuptuar si përmbajtje që shërben për të përmbushur zbrazëtitat e orëve mësimore nga fushat e tjera të mësimin të gjuhës amtare (Arkivi i Maqedonisë: 1973 - ).

Programet e lëndës së gjuhës amtare duke pasur parasysh rrethanat dhe momentet nëpër të cilat kalonte zhvillimi i arsimit shqip në Maqedoni, mund të themi se asnjëherë nuk i kanë përmbushur kërkesat dhe nevojat e shkollës shqipe, sepse në plan të parë duhej të përmbushej ana ideologjike e më pas kërkesat e tjera shkencore e profesionale.

"Përpiluesit e plan-programeve dhe të teksteve shkollore kanë qenë të gjymtuar në disa drejtime, dhe atë: programet për lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë deri vonë janë përshtatur nga gjuhët sllave. Ekzistonin vësh tirsësi të mëdha për përcaktimin e vendit të autorëve në programet mësimore dhe në tekstat shkollore, sepse shumë autorë e vepra letrare, për shkaqe ideologjike ishin përjashtuar prej programit nga partia dhe nuk mund të përfshiheshin as në procesin mësimor, as

në tekstet shkollore e jo më të propozoheshin në listën e lektyrave si vepra të zgjedhura për t'u punuar" (Rexhepi 2002: 40).

Në shqyrtimet mbi programet mësimore dhe listën e lektyrave aq shumë ka dominuar çështja e zgjedhjes së veprave dhe autorëve sipas çelësit nacional, sa që ishte bërë pengesë e madhe për përfshirjen e një grupi autorësh më eminentë në listën e lektyrave dhe në programet shkollore. Këto rrethana ndikuan që lektyra në vite të caktuara ta gjejë veten në vende dhe pozicione të ndryshme dhe atë, jo në bazë të vlerave që ofronin autorët e mirëfilltë të letërsisë shqipe, por duke u pozicionuar në baza nacionale, edhe pse bëhej fjalë për plan-programe dedikuar nxënësve shqiptarë.

Kështu, në plan-programin e vitit 1973 numri i veprave që u përkasin autorëve shqiptarë për t'u punuar si lektyra është i barabartë me numrin e veprave të autorëve botërorë, ndjekur më pas nga vepra të autorëve jugosllave. Gjykojmë, se edhe pse letërsia e huaj ndikon pozitivisht në zgjerimin dhe pasurimin e kulturës së përgjithshme që duhet të fitojë nxënësi, megjithatë bazat e shëndosha ndërtohen mbi një kulturë të shëndoshë amë dhe pa njohur kulturën e mirëfilltë letrare kombëtare është vështirë të njohësh kulturat e tjera. Prandaj, nuk e shohim me vend baraspeshën mes veprave të autorëve shqiptarë dhe atyre botërorë të propozuar në listën e lektyrave, edhe pse është një fenomen, i cili ndodh shpesh dhe, në një farë mënyre vite me radhë nuk ka qenë në favor të nxënësve shqiptarë.

Një nuancë fare të vogël dalluese, krahasuar me këtë që lamë pas, sjell programi i vitit 1978, ku lista e lektyrave kryesohet nga autorë shqiptarë, ndjekur më pas me një proporcion të njëjtë nga vepra të autorëve jugosllavë e botërorë. Por, ky kryesim nuk zgjatë shumë, pasi që në plan-programin që pason pas dy viteve, d.m.th. në vitin 1980 vendin e autorëve shqiptarë në listën e lektyrave e zënë autorët botërorë.

Çështje e cila lë shumë për të dëshiruar edhe në periudhat në vazhdim është vendi i autorëve shqiptarë në listën e lektyrave, pozicion ky, i cili gjithnjë e më pak i kënaq kërkesat dhe nevojat e shkollës shqipe. Kjo çështje vështirësohet edhe më shumë pas ndryshimeve të shumta dhe të thella që pësoi plan-programi i vitit 1984, ku përveç zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të veprave të parapara si lektyra, vendi i autorëve shqiptarë gjatë kësaj periudhe barazohet me ata jugosllavë, d.m.th. veprat e autorëve shqiptarë dhe jugosllavë vihen në stadin e njëjtë në listën e lektyrave për nga numri.

### **2. Risitë që sollën programet e viteve të 90-ta**

Ndryshimet e para pozitive rreth vendit të lektyrës fillimisht u ndienë në plan-programin e vitit 1988 ku shihet se vendi i autorëve jugosllavë vjen gjithnjë e

më shumë duke u zbehur, duke ia lëshuar vendin autorëve të letërsisë kombëtare. Lista e letrës këtë vit kryesohet nga autorë shqiptarë, ndjekur më pas nga ata botërorë dhe më pak në numër janë veprat që u përkasin autorëve jugosllavë. Në masë të theksuar këto dallime dolën në pah në vitin 1991 ku numri i veprave të autorëve shqiptar është dukshëm më i madh krahasuar me autorët botërorë dhe ata sllavë.

Bazuar në këtë mbarështim, mund të themi, se rrjedhat e arsimit shqip në Maqedoni filluan të stabilizohen pas vitit 1991, kur hapi i parë dhe i domosdoshëm ishte ç'ideologjizimi dhe shpolitizimi i programeve dhe i teksteve të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Meqenëse, deri në këtë vit nuk ekzistonte zgjedhje e lirë e veprave për t'u punuar, lista e lektyrave ishte e caktuara nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit dhe, sipas kërkesave të plan-programit mësimor duhej të realizohen të gjitha detyrat e plan-programit mësimor pa asnjë përjashtim.

Si rrjedhojë, ndodh të mos kemi prezantim të krijimeve letrare nga zhanret me vlerë artistike- edukative kulminante që do të ndihmonin më shumë zhvillimin e potencialeve emocionale dhe intelektuale krijuese të nxënësve. Përveç kësaj *"ndodhte që nxënësi të ngarkohej më shumë seç duhej, meqenëse në raste të caktuara lektyra ishte aq voluminoze sa që vëllimi i saj e tejkalonte vëllimin e të gjitha lëndëve të tjera mësimore. Kjo ka ndodhur për vetë faktin, se arsimtari duhej të sillej në kuadër të kornizave të plan-programit mësimor, jo rrallë të tejkaluara për nga përmbajtja dhe për nga vlera artistike"* (Krasniqi 2004 : 107).

Me një fjalë, nevojiteshin zëra të rinj për të plotësuar dhe ndryshuar vendin e kësaj fushe në plan-programet e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë; për të avancuar kuptimin dhe rëndësinë çfarë ka puna e mirë me lektyrën dhe për të ndihmuar përpunimin e saj në frymën e kërkesave të programeve të reja mësimore.

Pas viteve të 90-ta e në përmasa të mëdha pas vitit 2001 në plan-programet e lëndës së gjuhës shqipe

dhe të letërsisë ekziston një përparësi e madhe, zgjedhja e lektyrave nuk bëhet nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, por zgjedhja e tyre është një hap i lirë dhe demokratik. Byroja propozon një listë të gjatë veprash për t'u punuar si lektyra, ndërsa përzgjedhja bëhet nga trekëndëshi prind-profesor-nxënës. Ky hap i lirë dhe demokratik ndikon pozitivisht në shumë aspekte, në radhë të parë u jep mundësi nxënësve për të qenë më afër veprës së dëshiruar, e cila i përgjigjet botës dhe interesimit të tij individual dhe emocional, por mbi të gjitha paraqet edhe pozicionin dhe vendin që duhet ta kishte pasur lektyra ndër vite.

#### **Përfundim**

Gjykojmë, se u desh një periudhë dhjetëvjeçare që të tejkalohen plotësisht gjurmët e ngelura nga sistemi politik i mëhershëm. Me gjithë përpjekjet e bëra brenda këtij dhjetëvjeçari, periudha pas vitit 2001 e deri më sot mund të themi se është periudha më frytdhënëse, e cila solli një reformim kurrikular të arsimit, gjuhës shqipe, mësimin të saj, e në veçanti fushës së lektyrës.

Në plan-programet e fundit me të cilat punohet në shkollat e mesme në Maqedoni, lista e lektyrave është zhveshur tërësisht nga ndikimi nacional, fillimisht kryesohet nga autorë shqiptarë, pasuar nga ata botërorë dhe eventualisht ndonjë vepër e propozuar sipas dëshirës së nxënësve dhe në bashkëpunim me mësimdhënësin, mund të punohet nga autorë sllavë. Këto ndryshime lënë të kuptohet, se dhjetëvjeçarin e fundit lektyra është konceptuar si lëmi e posaçme e lëndës mësimore me përmbajtje dhe orë të veçanta mësimore, gjë e cila e bën atë të radhitet në plan-programet bashkëkohore të gjuhës amtare të vendeve me sistem të avancuar të arsimit, pra zë vendin të cilin duhej ta kishte pasur edhe më herët.

Në vazhdim për ta ilustruar kumtesën edhe praktikisht, do të paraqesim në mënyrë tabelore vitet kalendarike shkollore dhe numrin që zënë veprat e autorëve shqiptarë, botërorë dhe jugosllavë në listën e lektyrave duke filluar që nga viti 1973-2015.

<b>V. KALENDARIK 1973</b>	<b>LETËRSI SHQIPE</b>	<b>LETËRSI E HUAJ</b>	<b>LETËRSI JUGOSLLAVE</b>
Viti I	2	3	1
Viti II	3	2	1
Viti III			
Viti IV			
<b>V. kalendarik 1978</b>			
Viti I	3	1	1
Viti II	2	2	2
<b>V. kalendarik 1980</b>			
Viti I	4	7	2
Viti II	3	4	4



<b>V. kalendarik 1984</b>			
Viti I	3	2	3
Viti II	4	2	4
<b>V. kalendarik 1988</b>			
Viti I	3	7	2
Viti II	4	4	3
Viti III	5	3	4
Viti IV	7	3	2
<b>V. kalendarik 1991</b>			
Viti I	5	4	1
Viti II	5	2	3
Viti III	5	2	3
Viti IV	6	3	1
<b>V. kalendarik 2001</b>			
Viti I	9	2	1
Viti II	8	2	0
Viti III	8	3	
Viti IV	9	2	1

Tabela 1. Përfaqësimi i letërsisë shqipe, jugosllave dhe botërore sipas viteve kalendarike dhe shkollore

**Bibliografia:**

KRASNIQI, Islam (2004), *Mendimi metodik dhe praktika e mësimit të gjuhës shqipe, (periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe midis viteve 1945-1978)*, Prishtinë.

MUSTAFA, Avzi (1998), *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975*, Shkup.

REXHEPI, Nuhi (2002), *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Prishtinë.

PLANI dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për periudhën përgatitore (1973), Prosvetno Dello, Shkup, kutia nr. 19.

PLANI dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në kohë lufte për shkollat e mesme (1978), Arkivi i Shtetit të Maqedonisë, kutia nr. 23.

PLANI dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në kohë lufte për shkollat e mesme (1980), Arkivi i Shtetit të Maqedonisë, kutia nr. 23.

PLANI dhe programi mësimor për veprimtarinë edukativo-arsimore në shkollimin e mesëm (1984), Arkivi i Shtetit të Maqedonisë, kutia nr. 29.

PLAN-PROGRAMI i gjuhës shqipe dhe të letërsisë për të gjitha profesionet (1988), Arkivi i Shtetit të Maqedonisë Shkup, kutia nr. 30-34.

# Gjuhët Indo evropiane, evolucioni dhe roli i tyre në shekullin e 21<sup>it</sup>

## Indo-European languages, evolution and their role in 21<sup>st</sup> century

Mirlinda Shehu  
EX-EULEX Office  
mirlindashehu2@yahoo.com

### Përmbledhje

Në këtë punim do të mundohemi të paraqesim një nga çështjet më të rëndësishme të origjinës, evolucionit si dhe rolin e gjuhëve të vjetra. Ekzistojnë shumë teori dhe mosmarrëveshje në lidhje me rrënjët e gjuhëve të sotme. Duhet theksuar se familja e gjuhëve indo-evropiane përcaktohet nga marrëdhëniet gjenetike, që do të thotë se të gjithë anëtarët supozohet të jenë pasardhësit e një paraardhësi të përbashkët. Diferencimi generik nga Proto-indo-evropiane në dialekte dhe gjuhë, ka ndodhur gradualisht në kontakt me gjuhën, gjatë përhapjes së saj si dhe risive në territore të ndryshme. Sipas evoluimit historik të një familje gjuhësore, koncepti gjenerik është konsideruar i përshtatshëm sidomos në qoftë se komunitetet nuk mbeten në kontakte efektive në divergjencën e tyre gjuhësore. Këto koncepte paraqesin risit e fituara me anë të huazimeve gjuhësore apo të konvergencës gjuhësore, të cilat koncepte nuk mund të konsiderohen gjenetike.

**Fjalë çelës:** origina, degët, risitë ,huazimet, konvergencat

### Abstract

In this paper work we tried to describe one of the most important issues the origin, evolution and the role of the old languages. Exists many theories and disputes concerning the root of the nowadays languages. The Indo-European language family is determined by genetic relationships, meaning that all members are presumed descendants of a common ancestor. The generic differentiation of Proto-Indo-European into dialects and languages happened hand in hand with language contact and the spread of innovations over different territories. This factors, shared innovations among various languages, suggesting a common ancestor. To the evolutionary history of a language family, generic is considered appropriate especially if communities do not remain in effective contact as their languages diverge. These concepts are shared innovations acquired by [borrowing](#) or [convergence](#), which cannot be considered genetic.

**Key words:** origin, branches, innovation, borrowing, convergence,

### Hyrje

Që nga shekulli 16 shumë vizitorë evropianë të nënkontinenti indian kanë vërejtur ngjashmëritë në mes gjuhëve indo-ariane, gjuhës iraniane dhe gjuhëve evropiane. Observime të cilat kanë paraqitur çasje të ndryshme sa i përket origjinës dhe ndyshimeve evolutive gjatë zhvillimit të tyre.

Për shembull në vitin 1583, Thomas Stephens, një misionar anglez, jezuit në Goa, në letrën që ia kishte dërguar vëllait të tij vuri në dukje ngjashmëritë në mes gjuhëve indiane, në veçanti sanskritishtës, greqishtës dhe latinishtës. Kjo letër nuk u publikua deri në shekullin e 20-të.

Një ngjashmëri tjetër me gjuhën e lashtë sanskrite e ka vërejtur edhe Filippo Sassetti (i lindur në Firencë në 1540), një tregtar i cili udhëtoi në nënkontinenti indian. Në 1585 në shkrimet e tij, ai vuri në dukje disa ngjashmëri të fjalëve në mes të gjuhës sanskrite dhe gjuhës italiane (si për shembull: devaḥ / dio "Perëndisë", sarpaḥ / Serpe "gjarprit", Sapta / Sette "shtatë", Asta / Otto "tetë", Nava / nove "nëntë" e tjera.

Megjithatë as vëzhgimet Stephens e as të Sassetti nuk ndihmuan në gjurmime të mëtejshëm shkencor.

Në vitin 1647, gjuhëtari holandez dhe dietari Marcus Zuerius van Boxhorn vuri në dukje ngjashmërinë midis gjuhëve indo-evropiane, që supozohej që rrjedhin nga një gjuhë e përbashkët primitive e quajtur nga ai si gjuhë e skifeve. Ai përfshinte në

hipotezën e tij holandishten, shqipen, greqishten, latinishten, persishten, dhe gjuhën gjermane më vonë shtoj sllavishten, gjuhën kelte, dhe gjuhët baltike.

Sido që të jetë, sugjerimet e Van Boxhorn nuk nxitën hulumtime të mëtejshme.

Udhëtari otomano turk Evlia Çelebia i cili vizitoi Vjenën në vitin 1665-66, si pjesë e një misioni diplomatik vuri në dukje disa ngjashmëri në mes të disa fjalë në gjermanisht dhe farsi. Ndërkaq Gaston Coeurdoux dhe të tjerët kanë vërejtur po të njëjtat ngjashmëri. Coeurdoux bërë një krahasim gjithëpërfshirës të sanskritisht, latinishtes dhe greqishtes. Ngjashme, ka mendur Mikhail Lomonosov kur bënte krahasimet e ndryshme të grupeve gjuhësore por ai përfshinte edhe gjuhët sllave, Baltic ("Kurlandic"), iranian ("Medic"), finlandeze, kineze, "Hottentot", e tjera. Ai prerazi shprehu lashtësinë e fazave gjuhësore përmes metodës krahasuese në gramatikën e tij ruse (botuar 1755).

Hipoteza për ngjashmëritë gjuhësore u bë aktuale në vitin 1786 kur Sir William Jones i pari ligjëroi mbi ngjashmëritë në mes të tri gjuhëve më të vjetra që njiheshin në kohën e tij si: sanskrishtja, latinishtja, greqishtja dhe të cilave ai qëllimisht ia shtoj edhe gjuhën Gotike, Kete, dhe Perse, edhe pse klasifikimi i tij përbante disa pasaktësitë dhe mangësi.

Ndërkaq, Thomas Youngu ishte linguisti i pari që e shpiku dhe përdori termin gjeografik familja e gjuhëve "indo-evropiane" që përfshinte Europen Perëndimore deri te India verilindore kështu që ky term u shëndrua në një disiplinë shkencore, dhe në shumicën e gjuhëve ky term është thelbësor dhe term standard shkencor.

Linguisti i shquar Franz Boppi në mënyre sistematike përkrahte këto hipoteza në Gramatikën e tij krahasuese Comparative Grammar, e cila u paraqit në mes të viteve 1833 dhe 1852. Ai gjithashtu defino gjuhët nëpër degë.


Më pas Schleicher më 1861 në veprën e tij "Compendium", si dhe Karl Brüggmann ne "Grundriss" botuar në 1880 ne "Junggrammatische" bënë rivlerësime në këtë lami kurse Ferdinand de Saussure lansoi "Laryngeal theory" e cila mund të konsiderohet si fillim i studimeve moderne indo-


evropiane. Calvert Watkins, Jochem Schindler dhe Helmut Rix, kanë pasur nje çasje me të mirë ndaj morfologjisë ndërkaq, Kuryłowicz më 1956 në veprën e tij "Apophonie" zhvilloi dhe shtjelloi në mënyrë të detajuar çështjen e apofonise (ablaut-variacioneve zanoreve te rregullta). Prej të gjithëve këtyre linguistve i vetmi ishte Gotfrik Lajbnc (1646-1717) filolog i shquar që lansoi për herë të parë teorin se gjuha shqipe rrjedh që nga ilirishtja.

**Ndarja në nëngrupe të gjuhëve Indo - Evropiane**

Ka më shumë se 100 gjuhë në familje që tregojnë shkallë të ndryshme të lidhjes që u lejon atyre të klasifikohen në shumë degë evropiane dhe aziatike.

Shih më posht skemat (a,b) dhe lidhjet e paraqitura ku druri familjar është i ndarë në dy pjesë në gjuhët kentum, që janë gjuhë evropiane perëndimore, dhe gjuhët Satem, që cilat janë gjuhë evropiane dhe aziatiko lindore sipas Dan Short:





Për gjuhën shqipe mund të themi se është një degë e veçantë e degës indo-evropiane. Gjuha shqipe i ka ruajtur tiparet thelbësore të trashëguara nga një fazë e hershme indo-evropiane, si psh: sistemi i lakimeve, zgjedhimeve, natyrisht me ndryshime domethënëse përgjatë shekujve.

Siç e dijmë gjuha shqipe është e dokumentuar që nga shekulli i 15-të. Megjithëse ishte e ndikuar nga fqinjët e saj, ajo megjithatë qëndron në një degë të pamvarur, të veçantë në kuadër të familjes indo-evropiane edhe pse ajo ndoshta ishte e ndërlidhur me disa dialekte të ilirishtes si dakishtja etj. Nga pellasgishtja në ate ilire dhe pastaj në gjuhën shqipe e cila u trashëguar dhe u ruajt si gjuha më e vjetër në Evropë. Është vërtetuar, dhe argumentuar se gjuha shqipe është gjuhë burimore indo-evropiane.

Është e njohur se gjuha shqipe ka origjinë ilire dhe thrakase, ose trashëgiminë të dyfishtë ilire- thrakase. Për arsye gjeografike dhe historike, më shumë gjasa gjuha shqipe rrjedh nga një dialekt ilir.

Shkrimi i parë në gjuhën shqipe është "Formula e pagëzimit "në 1462 ndërsa sa i perket" Ungjëllit të Pashkëve "nuk ka të dhëna të sakta.

Gjuha armene është gjithashtu një degë e veçantë. Ajo flitet në Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgjia dhe Rusinë Jugore. Alfabeti armen ka 36 shkronja. Ajo ka dy dialekte lindore dhe perëndimore, dhe ka qenë e ndikuar nga gjuhët si persiane, greke dhe arabe.

**Gjuha iraniane:** përfshin Persishten moderne, Kurde, Pashtu, Baluchi dhe disa gjuhë të zhdukura të Iranit dhe të Azisë Qendrore. Gjuhët iraniane janë përhapur, më parë në të gjitha stepat aziatike por më vonë u zhvendosën nga territori Turk dhe në ditët e sotme këto gjuhë fliten në Iran, Afganistan, Taxhikistan dhe pjesë të Turqisë dhe Pakistanit.

Ashtu si gjuha shqipe dhe armene edhe gjuha greke i takon një dege të veçantë indo-evropiane. Dallohen: greqishtja e vjetër e cila kishte një numër të madh të dialekteve: greqishten e mesjetës (bizantine) dhe ate të sotmen greqishten moderne.

#### Gjuhët Baltiko-sllave

Në përgjithësi, dega Baltik ka ngjashmëri me ate Balto-sllave. Ajo gjithashtu, ndan disa karakteristika me ate gjermanike dhe ndoshta edhe me gjuhen Tokariane.

Gjuhët që mbijetuan nga kjo dege janë: lituanishtja letonishtja nderkaq estonishtja i takon gjuhëve joindo-evropiane dmth. familjes Uralic. Gjuhët tjera baltike u zhdukën, gjuha e parë që është zhdukur ishte gjuha Prusiane, në shekullin e 18-të.

Gjuhët sllave ndajnë një paraardhës të përbashkët me gjuhët baltike duke pasur një prerje të vogël me gjuhët indo-iraniene dhe gjuhen armene. Gjuhët sllave ndahen në grupe lindore, perëndimore dhe jugore. Grupi i parë përfshin gjuhen ruse, bjelloruse dhe ukrainase. Grupi i dytë përfshin gjuhët: polake, çeke dhe sllovaqe.

Gjuhët e sllavëve të jugut janë: kroatishtja, serbishtja, sllovenishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, boshnjakishtja dhe gjuha malazeze.

**Gjuhët keltike,** prej fillimit e saj deri në vitet e 70 –ta .të shekullit XX, janë ruajtur deri diku tri gjuhë: gjuha Bretone në Bretagne, Uells dhe ajo Skoceze. Ajo flitej në një pjesë të madhe të Evropës në mijëvjeçarin e parë, por me përparimin e romakëve dhe krishterimit ata ishin të mbyllur në Britani, Irlandë dhe Britani e Madhe.

Gjuhët gjermanike janë të ndara në tri grupe perëndim, lindje dhe veri shih degëzimin në skemen b.

## Përfundim

Në fund mund të themi se sa i përket numrit të madh të folësve, sot gjuhët indo-evropiane njihen si familja më e madhe gjuhësore. Në fakt, familja indo-evropiane përfshin shumicën e gjuhëve evropiane dhe disa prej gjuhëve aziatike. Prandaj mund të themi se gjatë shekujve të fundit, ato gjuhë janë përhapur në pesë kontinentet dhe fliten sot nga gjysma e popullsisë së planetit.

Mund të konfirmojmë se të gjitha rrjedhin nga pararendësi hipotetik i quajtur Proto-indo-evropian apo thjesht indo-evropian e folur gjashtë apo shtatë mijë vjet më parë diku në Azi.

Megjithatë vështirësitë serioze qëndrojnë në identifikimin e hollësive dhe marrëdhënieve aktuale

mes familjeve gjuhësore; nga që është shumë vështirë për të gjetur prova konkrete që tejkalojnë ngjajshmërit.

Vëretjet ndaj disa teorive të tilla nuk janë të bazuara në ndonjë pretendim specifik teorik për ekzistencën e mundshëm historike apo mos ekzistencën e familje të tilla të mëdha; megjithatë është krejtësisht e arsyeshme të supozojmë se këto gjuhë me bazë indo-evropiane mund të kenë ekzistuar.

Një tjetër temë shumë e rëndësishme është se gjuhët indo-evropiane mbizotërojnë në të gjithë kontinentet amerikane dhe evropiane me përjashtimet të vetme të Finlandës, Estonisë dhe Hungari ku fliten gjuhët Uralike.

## Bibliografia:

- AUROUX, Sylvain (2000). History of the Language Sciences. Berlin, New York: Walter de Gruyter. p. 1156. ISBN 3-11-016735-2. a b c d e f g h i j k Anthony 2007, fq. 100. Britannica botimi i 15-të, "Indo-Hittite hypothesis", fq 22 , fq 594,
- BLACK WELL Basil (2004) Oxford, (He erroneously included Egyptian, Japanese, and Chinese in the Indo-European languages, while omitting Hindi.
- BLENCH Roger (2006) Archaeology and Language: methods and issues at the Wayback In: A Companion To Archaeology. J. Bintliff ed. 52-74.
- FINE, John ,( 1985) "The ancient Greeks: a critical history". Harvard University Press. fq. 72; ISBN 0674033140.
- HOLM, Hans J. (2008). "The Distribution of Data in Word Lists and its Impact on the of Languages". In Preisach, Christine; Burkhardt, Hans; Schmidt-Thieme, Lars et al. Data Analysis, Machine Learning, and Applications. Proc. of the 31st Annual Conference of the German Classification Society (GfKl), University of Freiburg. Studies in Classification, Data Analysis, and Knowledge Organization. Heidelberg-Berlin: Springer- Verlag. ISBN 978-3-540-78239-3.
- HOUWINK . Philo H.J , H. Craig Melchert and Theo P.J. van den Hout, 586 "Indo-European languages, The parent language Laryngeal theory, W.C , fq. 589, 593, "Anatolian languages", Britanika 15.  
<http://www.leidenuniv.nl/en/researcharchive/index.php3-c=178.htm>  
[http://oi.uchicago.edu/pdf/ar/61-70/65-66/65-66\\_CHD.pdf](http://oi.uchicago.edu/pdf/ar/61-70/65-66/65-66_CHD.pdf)  
[https://web.cn.edu/kwheeler/IE\\_Main2\\_Centum.html](https://web.cn.edu/kwheeler/IE_Main2_Centum.html)
- LEAKE .William Martin,( 1814) Of the Albanian Language. London.
- LOMONOSOV. M. V. (1952) Në: Edicionin Komplet Moskë , vol. 7, fq. 652–659; S.George Lane, Douglas Q. Adams, Britannica botimi i 15-ët edition 22:667, "The Tocharian problem".
- SCHLEICHER ( 1861), Szemerényi 1957, Collinge 1985, and Beekes 1995. The supposed autochthony of Hittites, the Indo-Hittite hypothesis and migration of agricultural "Indo-European" societies became intrinsically linked together by C. Renfrew. (Renfrew, C 2001a The Anatolian origins of Proto-Indo-European and the autochthony of the Hittites. In R. Drews ed., Greater Anatolia and the Indo-Hittite language. family: fq.36-63. Washington, DC: Institute for the Study of Man).

# LINGUISTIC FEATURES OF ÇAJUPI'S POETIC DISCOURSE VEÇORI TË LIGJËRIMIT POETIK TË ÇAJUPIT

GRETA JANI

Departamenti i Gjuhës Shqipe  
Universiteti "Aleksandër Moisiu"  
Durrës, SHQIPËRI  
greta\_jani@yahoo.com

## Përmbledhje

Punimi ynë synon të analizojë disa aspekte të gjuhës së veprës së Çajupit, një prej autorëve më të shquar të letërsisë artistike të shekullit XX. Duke vëzhguar gjuhën e poezisë dhe veprës së tij dramatike do të nxjerrim në pah disa veçori në aspektin leksikor, stilistik, fjalëformues etj., me qëllim që vlerësimi për këtë figurë të ndritur të letërsisë sonë të jetë i plotë, jo vetëm në aspektin letrar, por edhe në atë gjuhësor. Metodologjia e përdorur në realizimin e kësaj analize është e një karakteri kompleks, pasi do të zbatohet kombinimi i metodës përshkruese me atë analizuese e sintetizuese. Shembujt që janë vjelë nga lënda e autorit do të shërbejnë për të konkretizuar çështjet teorike. Punimi është rezultat i një analize të thellë dhe shumëplanëshe të gjuhës së Çajupit ku objekt studimi janë bërë një pjesë e konsiderueshme e poezive të tij, komedive e dramave. Vëmendje të veçantë do t'u kushtohet mjeteve të shprehjes, mënyrës se si janë formuar ato, funksionit stilistik të tyre. Një vend të veçantë do të zërë studimi i ironisë e satirës, figura të cilat autori i përdor shpesh për të fshikulluar ato fenomene negative që ai vuri re në shoqërinë e kohës në të cilën jetoi. Ky stil e kjo gjuhë e dalloi ndjeshëm nga paraardhësit e bashkëkohësit e vet krijues dhe njëkohësisht i siguroi jetëgjatësinë në kujtesën e lexuesve të të gjitha kohëve. Studimi i gjuhës së veprave të Çajupit në disa aspekte do të na japë mundësinë të njohim atë kulturë të pasur materiale e shpirtërore të cilën autori e shpreh përmes kësaj gjuhe. Gjithashtu ky hulumtim do të na japë një pasqyrë të qartë mbi nivelin e zhvillimit të gjuhës shqipe në këtë periudhë.

## Abstract

Aim of investigation. Our study intends to analyze some aspects of the language of Çajupi's work, one of the most prominent authors of the artistic literature of the twentieth century. Based on the language of his poetry and dramatic work, we will highlight some features in the lexical, stylistic and word-formation aspect, in order to appreciate this distinguished figure of our literature completely, not only in the literary aspect, but even in the linguistic one. The methodology used in this analysis has a complex character, combining the descriptive method with the analytical and the synthetic one. The examples collected from the author's material will serve to make the theoretical issues concrete. The study is the result of a deep and multiple-plan analysis of Çajupi's language, where the main study objective is a considerable part of his poems, comedies and dramas. A special attention is paid to the expression means, to the way they are composed and to their stylistic function. We are specifically focused even on the irony and satire, figures which were used very often by the author to whip those negative phenomena he noticed in the society of the time where he lived. This style and language distinguished him significantly from the predecessors and the contemporary authors and at the same time guaranteed his longevity in the memory of the readers of all the times. The study of the language Çajupi used in his works, considered in several aspects, will give us the opportunity to know that rich material and spiritual culture which is expressed via this language by the author. Furthermore, it will also provide us with a clear vision on the development level of Albanian language during this period.

**Fjalë çelës:** leksik, stilistik, ironi, satirë, poezi, drama.

**Keywords:** lexical, stylistic, irony, satire, poetry, dram.

## Hyrje

Në ditët e sotme, vëmendje të veçantë gjuhëtarët po i kushtojnë studimit të gjuhës së letërsisë artistike, jo vetëm për autorë të rinj e bashkëkohës me ne, por edhe për autorë më të hershëm të letërsisë sonë, që me veprat e veprimtarinë e tyre kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori. Një prej këtyre figurave të ndritura është edhe Andon Zako Çajupi, poet dhe mendimtar i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare.

Kontributi i Çajupit në letërsinë shqiptare është mjaft i çmuar. Ai shkroi dhe botoi vëllime me poezi, komedi e tragjedi, shkroi prozë e publicistikë, si edhe shqipëroi fabula shumë të bukura nga poeti i njohur francez, La Fonteni e nga letërsia hinduse. "Këto vjersha që dolën sot në dritë janë shkruar për

*të rrëfyer që shqipja është gjuhë si gjithë të tjeratë, simos më e mirë. Gjuha shqipe, o vëllezër shqipëtarë, është gjuhë e Shqipërisë; ajo që na flet mëma në djep; ajo e Skënderbeut dhe e stërgjyshërve tanë që kanë nderuar atdhenë..." - shprehet Çajupi (Çajupi 1902).*

Vlerësimin e lartë për këtë gjuhë ai e shprehu përmes një krijimtarie origjinale, që dalloi për tingëllimin e veçantë dhe forcën e madhe të shprehjes gjuhësore. Vargjet e tij janë shprehje e drejtëpërdrejtë e problematikave më të mprehta të kohës kur poeti jetoi e punoi.

Gjuha e veprës së Çajupit, pothuaj e pastudiuar deri tani do të jetë edhe objekti i këtij punimi. Analiza gjuhësore do të konkludojë në zbulimin e disa

veçorive të saj për të kuptuar më mirë kontributin e poetit në drejtim të çështjes së gjuhës shqipe, çështje me rëndësi kombëtare për identitetin e një kombi.

Lënda e pasur, e vjelë nga veprat e tij, do të na shërbejë për të ilustruar këto veçori.

Vepra e Çajupit në brendi e në formë, është thellësisht popullore, sepse pasqyroi hallet e shqetësimit e popullit, shpirtin dhe ëndrrat e tij me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të (Xhaxhiu 1981: 28).

### **Tingëllim i veçantë dhe forcë e madhe e shprehjes gjuhësore**

Lidhja dhe ndikimi nga folklori u bë parim krijues që ndihet në të gjitha veprat e Çajupit. Leksiku dhe frazeologjia popullore i kanë dhënë bukuri, thjeshtësi e sinqeritet shprehjes së ndjenjave dhe mendimeve të poetit. Fjalë e shprehje të leksikut popullor, si p.sh.: *sos, kuvendoj, qas, të piqemi, më të mëngjër, kandiset, fiqiri, qederi, sëra, ca petka vëra-vëra, të vdeç, të lëvdonjë, gjegja etj.*, kanë fituar vlerë poetike në vargjet e tij, si edhe tregojnë qartë lidhjen e poetit me traditën popullore. P.sh.: *Mike pse më prish fiqirë/përvëlon si zjarri?*

Qartësia, thjeshtësia natyrshmëria e shprehjes, figuracioni i pasur gjuhësor e stilistik janë tipare të veçanta që mbart gjuha e popullit. Këto tipare që jetonin në gjuhën e tij, duheshin pohuar, sipas Çajupit, përmes veprash të shkruara. Duke ndjekur këtë rrugë, Çajupi solli një kontribut të çmueshëm për pasurimin e shqipes me frazeologjinë e pasur popullore, me shprehje të freskëta dhe të gjalla (Bulo 1966: 109). Njësitë frazeologjike i japin ngjyrim emocionues vargut, si edhe shprehin edhe qëndrimin e poetit. Të tilla njësi janë: *bëj këmbët bigë; këput qafën; lë shëndenë!; si buka që ha; heq shpirt; nuk kërren asnjë fjalë; fjalët i merr era; si dy e dy bëjnë katër; u pjell mendja; s'më dërsin veshi për botë; nga hunda s'më heq dot kurrë; u hante koka për brirë; nuk pa ditë të bardhë; s'ia diti kimenë; i ka marrë koka erë; për të pirë në kupë etj.*

*Mendja ju turbullua*

*Mua të më vënë brirë!*

Vë brirë është e barasvlershme me *turpëroj*, frazeologji që përdoret në rastet kur gruaja tradhton burrin, por në ndryshim nga fjala, njësia frazeologjike ka ngjyrim keqësues, tallës e ironik dhe parapëlqehet për t'u përdorur nga autori në këto vargje.

Çajupi ishte pasardhës i menjëhershëm i Naimit. Veprat e tyre janë brumosur e ushqyer me përfytyrimet, idetë e figurat e krijimtarisë poetike gojore. Por një forcë të madhe shprehëse vargjeve u japin edhe figurat e kuptimit, fjalëve dhe shprehjeve, si edhe figurat tingullore. Të tilla figura, si p.sh.: metafora, krahasime, epitete, antiteza,

hiperbola, pasthirrma, përsëritje etj., gjejmë pafund në ligjërimin e tij poetik e dramatik.

### **Metafora, similituta e krahasimi i zgjatur**

Metaforat, *fluturon dashuria, ma paske gjuhën bilbil, zemra bëhet behar, zemëra jote u bë gur për mua etj.*, janë shprehje të bukura e të goditura që tregojnë ndjeshmërinë e pasurinë e botës shpirtërore të poetit. Jeta e fshatit me gjithë bukuritë e saj natyrore, me gjithë hallet e shqetësimit e njerëzve që banojnë aty, do të zërë vendin e duhur në krijimtarinë e Çajupit. Çajupi aq sa është poet i ëmbël i fshatit, aq është edhe i qytetit (Bulo 1991: 110). Me detaje nga kjo natyrë e mrekullueshme ai do të stolisë vargjet e tij përmes figurës së krahasimit. P.sh.: *shket si ngjalë, nusia si zog deti, faqekuqe si një shegë, koka më digjet si furrë, të ëmbël si shqerrë, zë si shpellë, paske trutë si hirrë, si një zog në kafaz, si burim i venë lotë, si sokadhe, si mollë e pabërë, si hënz e plotë, leshërat prapa krahëve hedhur si kurorë, e bardhë si borë, goja jote si qershia, etj.*

Me figurën e krahasimit ndërtohen edhe vargje të lirikës erotike, ku përshkruhet bukuria e vajzës së dashur, ndjenjat e heroit lirik që janë shumë njerëzore e konkrete. Kjo lirikë edhe sot është e freskët, e këndshme dhe me forcë komunikuese. P.sh.: *Leshërat e tua posi pendë korbi/Ballëtë si diell, faqetë si mollë/Sisetë si shegë, dhëmbët si thëlpënjë/Buzët si burbuqe, sytë si gështenjë/Dora si dëborë, fjala jote mjaltë.*

Jo rrallë gjejmë në vargje figurën e similitudës, krahasimit të zgjatur që shtrihet në më shumë se një varg duke e gjallëruar e pasuruar mendimin. P.sh.: *Si dallëndyshja vete në vend tjetër/Dhe kthehetë prapë në fole të vjetër/Ashtu zemra jote mundet të kujtojë/Mikn'e djalërisë dhe prapë të dojë...*

Problemet shoqërore që u trajtuan në poezinë e Çajupit nisnin me gjendjen e skllavëruar të gruas shqiptare, tek kurbeti si plagë e hidhur e kohës, tek zbulimi i kontrastit midis pakicës së privilegjuar dhe shumicës së varfër, midis pasurisë dhe injorancës, midis bollëkut të prodhimeve e varfërisë etj. (Haxhijaj 1978: 9). Për t'i pasqyruar drejt këto autori përdor fjalë me kuptim të kundërt, antonime si p.sh.: *zhvish-vish, lerë-vdesëm, pleqtë-të ritë, i zi-i bardhë, të pasur-të varfër, korr-mbjell, dit'-nat' etj.*, të cilat shërbejnë edhe për ndërtimin e antitezës dhe kontrastit duke bërë ligjërimin e tij poetik më të fuqishëm. P.sh.: **Zhvish** rrobat e robërisë mëmëdhe/**Vish** armët e trimërisë se ke ne!; **Kemi lerë e do të vdesëm; Të rrojnë pleqtë/Të vdesin të ritë; Kasap i zi/ me zemër të bardhë; S'kish të pasur e të varfër; Kur të korr e kur të mbjell; Turpëronem dit' e nat'; Moj mike kush të gënjeu/ Dhe të shiti a të bleu?**

Një tjetër figurë, që zbukuron vargun dhe e bën më mbresëlënëse, është edhe figura e hiperbolës, e cila përftohet më shpesh në lirikën atdhetare e erotike për të dhënë me tepri situata, cilësi, gjendje. P.sh.: *Treqind lebër qimeverdhë/Te Gryk'e Kuçit u derdhë; Trimërinë s'ia nxë dheul; Po thërret sa tundet vendi etj.*

Brenda poetikës së Çajupit gjejmë qëndrimin ironik ndaj zakoneve të prapambetura, ndaj fesë e ndaj perëndisë, kur ai ndërton fjali pyetëse të tilla që mbeten pa përgjigje. P.sh.: *Pse u bë nga Perëndija?/Mirësia, ligësia/Që të vuaj njerëzia/Gjithë këto të këqia?*

Edhe grotesku i përfutur në vargje të emocionon e të mallëngjen. P.sh.: *Gjithë jetën nën urdhër/Qeseja si kokërr udhër.*

### **Ironia dhe dhembja**

Vjershat e Çajupit përshkohen nga keqardhja e dhembja e thellë për popullin, mbi supet e të cilit rëndonte gjithë pesha e padrejtësisë shoqërore. P.sh.: *Oh, të zestë punëtorë!/duke punuar qanin/se sa me kamçik në dorë/i qërtinin e i rrahnin/Dhe mos i godisnin pak!/bobo arapët e mjerë!/i rrahnin sa u del gjak/dhe sa vdisnin ca të tjerë.*

Këtë ndjenjë, si edhe ndjenjën e dashurisë, me bipolaritetin e saj, gëzimin dhe dhimbjen që shkakton humbja e saj, Çajupi i ka shprehur mjaft bukur përmes pasthirmave. Ky shpërthim i drejtëpërdrejtë intonativ lind si pasojë e gjendjes së rëndë në të cilën ndodhet Shqipëria, herë të tjera ai është shprehje e shqetësimit nga ikja e rinisë, dashurisë etj. P.sh.: *O moj Shqipëri e mjerë?; O pëllumb i shkruar!; O moj portë, moj e shkretë/Mos rri mbyllurë përjetë!; O kaur o këthatë!; O korrik, o faqezjarr!; O patrik o kryerëndë!; Obobo sytë ç'më panë!; O lum e përrua?; O mik të kam gjetur!; O ju të ra dhe të ri!; Moj e mjera grua/Ç'e do burrë zinë!; Obobo e ububu/Mikia ndër mënd u vu/Në shtëpi të saj më shpu...etj.*

Siç shihet nga shembujt e mësipërm pasthirmat në vargjet e Çajupit janë të llojeve të ndryshme: a) **të thjeshta**: *o, a, oh, ah etj.* b) **të prejardhura** prej fjalësh të tjera të thjeshta (me konversion nga pjesë të ndryshme të ligjëratës): *o burra, e zeza, lum etj.* c) **të përngjitura** janë edhe pasthirmat e formuara nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të veçanta: *obobo, ububu, tungjatjeta etj.*

Gjuha e ligjërimit poetik të Çajupit është organizuar bukur e ritmike edhe përmes përsëritjeve të fjalëve a togjeve të tyre në vargje për të përforcuar shprehjen artistike apo për përcjellë e theksuar gjendje të veçanta emocionale e psikologjike.

Anafora e përfutur në vargjet e mëposhtme e thekson më mirë mendimin. P.sh.:

*Bëre pemëtë me fletë/Bëre dimër e beharë/Bëre arinë dhe denë; Qani pyje, fusha, gurë/Qani male*

*me dëborë!; Me zë të madh si shkëmbi/Me zë të madh si gjëmimi.*

Po kaq me ritëm janë edhe vargjet ku përftohet epanalepsa. P.sh.: *Mbeta more shokë mbeta; Kurbeti shokë kurbeti; Duro, varfëri duro; U tretë, Gjon Lek', u tretë!; Bariu, shokë bariu etj.*

Hijeshi e gjallëri ka në vargjet e Çajupit edhe për shkak të figurës së elipsës që përftohet aty. P.sh.: *Malet me gurë,/fushat me bar shumë,/arat me grurë, më tutje një lumë.; Pika-pika bie shiu/dhe dëbora flokë-flokë,/vetëtin e fryn veriu,/breshëri kërcet mbi tokë; Mor zot, pse dëm fjalët? etj.*

### **Fenomeni i elipsës**

Fenomeni i elipsës është i natyrshëm, ose më mirë të themi, i rregullt për gjuhën, i përcaktuar nga arsye të ndryshme, subjektive dhe objektive, prandaj ai s'mund të lidhet çdo herë me gradën e vetëdijshmërisë, sepse si gjuha, si mendimi, të realizuara në një subjekt kanë edhe ekzistencë objektive (Prifti 1966: 133). Ashtu siç thotë populli ynë "i bie shkurt", edhe njeriu, e për më tepër, poeti ynë, bën kapërcime duke lënë mënjanë, me ose pa vetëdije çka mund të nënkuptohet. Ndaj nuk e shikojmë si një varfëri stili të Çajupit, por dukuri që vjen për shkak të një *parimi ekonomik* ku lihet mënjanë çdo gjë që nuk është esenciale për mendimin.

Trajta u që del në vargje është reduktim i formës së plotë të përemrit vetor *unë*, formë eliptike. P.sh.: *nga u ç'të ligë ke parë?; hëngra dhe u mish njeriu; apo shkrimi jo i plotë i foljes qan, emrave revole, telefon etj., p.sh.: ç'ke që qa prapë taninë?; nga një revol!; mund të na vijë një tel; apo reduktimi i bashkëtingëllores j si në shembujt: mbai për vete, vi rrotull etj.* Reduktimi fonologjik është rrjedhojë e ekonomizmit gjuhësor i cili më i përhapur del në gjuhën poetike (Islamaj 2008: 257).

Është vërtetuar se kompozimi në gjuhën shqipe përbën një tip mjaft të zhvilluar e popullor (Thomai 2006: 182). Kompozitat e përdorura nga Çajupi janë formime popullore me ngjyrim emocional të theksuar e me shprehësi të lartë. Të tilla janë: *dorështrënguar, mustaqemath, meshollë, syzezë, gushëbardhë, kokëshinik, rrënjëdalë, mendjeprishur, zemërlig, zemërmirë, qimeverdhë, zemërderr, mendjelart, zemërtrim, punëbardhë, punëmarë, fuqplotë etj.*

Përgjithësisht kompozitat e Çajupit janë formuar nga bashkimi i një teme emërore dhe një temë mbiemërore si p.sh.: *dorë+ e shtrënguar, mes+ i hollë, sy+ e zezë, gushë+ e bardhë, zemër+ e ligë, punë+ e bardhë etj.*, ku gjymtyra e dytë përcakton të parën. Por ka edhe kompozita që ndërtohen nga gjymtyrë emër+emër si p.sh.: *kokë+derr, kokë+shinik, zemër+trim etj.*



Sipas vlerës leksiko-gramatikore, këto fjalë kanë vlerë mbiemërore me funksion cilësues e karakterizues për njerëz të dashur e të shquar si Naim Frashëri. P.sh.: *Vdiq Naimi, vdiq Naimi, /moj e mjera Shqipëri! / Mendjelarti, zemërtrimi/vjershëtori si ai!*; Por edhe kur do të ironizojë, godasë e fshikullojë apo të vetëdemaskojë si në rastin e sulltanit, Çajupi përdor kompozita me ngjyrim keqësues si p.sh.: *...gjakatar e zemërderr/nga frika më bëjnë nder; Naum kokëshiniku; Adhami dhëmbëdali; Qysh të flerë punëlumi? etj.*

Me interes në veprën e Çajupit janë edhe formimet me përngjitje nga të cilat kemi veçuar ndajfoljen *tërvit* që është rrjedhojë e njëfjalësimit të togut emëror *tërë vitin*, gjë që tregon qartë prirjen drejt sintezimit të mjeteve leksikore të shprehjes në gjuhën shqipe. P.sh.: *Tërvit kishi t'ëmën me ethe etj.* Një veçori tjetër e gjuhës së Çajupit është se në rasën kallëzore të shquar të emrave me zanore mbizotëron forma më e vjetër me mbaresën **-në** e cila i shtohet temës së emërores. P.sh.: *gjaknë, shkrimnë, helmnë, synë, shëndenë, çifutnë, mbretnë, shoknë, denë, dhenë, cinë?(cilën?) etj.*

#### **Fjalët e shprehjet dialektore**

Fjalë e shprehje dialektore të jugut, që tregojnë dhe lidhjen e tij të fortë me vendlindjen, Sheperin, Zagorinë, i kanë vënë vulën e origjinalitetit veprës së poetit. E folmja e labërishtes si dhe ndikimi nga folklori, veç të tjerash, shprehjen më të qartë e gjejnë te format e foljeve. Ato zënë një vend të konsiderueshëm në vargje dhe i përkasin kohëve dhe mënyrave të ndryshme.

Kuptimi themelor i kohës së tashme të mënyrës dëftore është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë, që përfshin edhe çastin e ligjërit. Por kjo kohë përdoret edhe me një kuptim kohor të pacaktuar e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes dhe të së shkuarës. E shoqëruar me pjesëzën *po*, folja në kohën e tashme të dëftores shpreh një veprim të veçuar me aspekt vazhdimësie (Demiraj 1971: 49). P.sh.: *gratë për punë po janë etj.*

Foljet e mënyrës dëftore të kohës së tashme në formën joveprore janë trajta dialektore. P.sh.: *zemëronem, turpëronem, mendonesh, tmerronet, bënet etj.*

Po kështu, ndodh edhe me foljet në kohën e kryer të thjeshtë të cilat janë tipike dialektore e popullore. P.sh.: *u munduash, arçë, keshë, njofta, fleta, përdredhën, presën etj.*

Ngjyrim të veçantë kanë foljet që dalin në formë dialektore në kohën e ardhme të mënyrës dëftore. P.sh.: *A do të çjerç artikullin?; Do të shoç...; Do të humbsh edhe ti të ritë; Ç'vajzë do t'i apëm grua?; Nuk do të më ndëgjoç?; Ço të shoç? etj.*

Në mënyrën lidhore në kohën e tashme foljet dalin në trajtat: *të shomë, të vdesën, të flasëm, të vdeç,*

*të sheç, të munç, të preç, të apç, të flaç etj.* Në formën joveprore kemi: *të lëvdonet, të kthenem, të luftonem etj.* Ndërsa në kohën e pakryer tërheqin vëmendjen trajtat: *të lëvdonjë, të këndonjë, të ngrenë, të dëgjojë, të shojë etj.*

#### **Topika e urimeve dhe mallkimeve**

Veçori përbën edhe përdorimi i foljes në mënyrën dëshirore me anë të së cilës shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi dhe mallkimi. Përgjithësisht ato janë në kohën e tashme. P.sh.: *Rrofsh e qofsh e gëzofsh!; Qofsh zonjë e madhe!; Ti që vure sot kurorë /Pagëzofsh edhe me dorë!; O prift, mirë se urdhërove/ Rrofsh e qofsh që më nderove!; I zoti i shtëpisë rroftë/Dhe djali ju trashëgoftë/ Si bleta të shtonen! / O liri të qofsha falë! / T'u bëftë balta ergjënd; Lanet paç moj dashuri / se më trete si qiri! etj.*

Vargjet që mbartin mallkime, tipike popullore, ndërtohen me folje në mënyrën dëshirore. P.sh.: *I marroft zoti!; U djektë gjithë Shqipëria!; Po të mos më dalç përpara tjetër herë!; I kripsha trutë!; I dalçin që të dy!; E gjetë nga perëndia; I vaftë shpirti në ferra!; Fjala mos na daltë e marrtë dhenë etj.*

Për sa u përket foljeve në mënyrën urdhërore Çajupi pëlqen trajta dialektore duke e bërë të larmishëm ligjërimin e tij poetik. P.sh.: *ëndërrit, le mor vëlla këto fjalë..., merr e kqyr dorëshkrimet, le moj grua ta thërresë, përpiaqi për Shqipërinë! etj.*

Nuk do të lëmë pa përmendur këtu edhe pjesoret e foljeve *sjell, lë, bie, hyj, rroj, vuaj, pandeh, vij*, të cilat janë forma dialektore e të vjetra të fjalës. P.sh.: *sjellur, lënur, rënur apo rarë, rytur, ruar, vuar, pandyer, ardhë etj.*

Një rol të rëndësishëm në vargjet e Çajupit luan edhe përdorimi i ndajfoljeve. Të bie në sy përdorimi i shpeshtë i ndajfoljes *fort*, por edhe i lokucioneve ndajfoljore të formuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë. P.sh.: *fort mirë, fort bukur, një abetar fort të mbaruar, në je i gjatë fort, gëzohem fort ose dora me dorë ...themi se, bar i mirë një me një, motë mot që rrojtëm bashkë etj.*

Një tjetër veçori e ligjërit poetik të Çajupit janë edhe ndërtimet me parafjalë. Parafjala më e përdorur është *ndë* p.sh.: *ndë mes tënë!; ndë kishë e ndë mulli...; s'ke qime ndë krye; ndë vështë të jem a nd'arë? etj.* Kjo parafjalë del edhe në trajtën *nër* p.sh.: *Eja nër mënde, ose e përngjitur me parafjalën për, ndëpër, ose me parafjalën në, ndënë.* Gjithashtu gjejmë të përdorur në vargje edhe parafjalët *më* p.sh.: *më tetë dhe përmi* p.sh.: gjithë punët *përmi* mua etj., ku kemi dhe bjerrje të tingullit *b*.

Edhe gjuha dialektore e përdorur prej Çajupit, lufta e tij kundër purizmit (që është një meritë që s'duhet shikuar me keqardhje ) janë shprehje e lidhjes së tij me traditën popullore, e vlerësimit të lartë që ai i bëri gjuhës popullore. Përpara

rilindasve çasti historik shtroi si detyrë të ngutshme ruajtjen e gjuhës si shenjë, luftën për pastrimin dhe pasurimin e saj. Ashtu si për rilindasit e tjerë, për Çajupin “gjuha është një element i fuqishëm, i domosdoshëm për ruajtjen e racës”. “*Gjuha shqipe-shkruan ai- është e pamjaftueshme si gjuhë letrare dhe shkencore, po ajo ka mbetur e kulluar, ekspresive*” (Çajupi 1957: 319-320).

Është theksuar shpesh në studimet letrare rëndësia që luajti krijimtaria e Çajupit në zhvillimin e letërsisë së rrymës demokratike, e cila siç dihet do të formohet si e tillë në vitet ‘30 të këtij shekulli (Haxhijaj 1973: 192). E rëndësishme ishte kjo krijimtari edhe nga pikëpamja e lëvrimin të gjuhës shqipe, gjuhë që po zhvillohej e po plotësonte më së miri kërkesat e shqiptarëve për shprehësi dhe që shumë shpejt po shkonte drejt normëzimit e kodifikimit falë punës së tyre të përkushtuar.

#### **BIBLIOGRAFIA**

- BULO, Jorgo (1991), “Andon Zako Çajupi”, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr.1.
- BULO, Jorgo (1966), “Rreth ndikimit të folklorit në veprën e Çajupit”, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr. 2.
- ÇAJUPI, Andon (1902), “Baba Tomorri”, *Parathënie*, Kairo.
- ÇAJUPI, Andon (1957), *Vepra*, Tiranë.
- DEMIRAJ, Shaban (1971), “Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe”, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr.4.
- HAXHIAJ, Floresha (1978), *Andon Zako Çajupi Poezi, Parathënie*, “Naim Frashëri”, Tiranë.
- HAXHIAJ, Floresha (1973), “Motivet sociale në krijimtarinë letrare të A. Z. Çajupit”, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr. 2.
- ISLAMAJ, Shefkije (2008), *Gjuha dhe identiteti*, TOENA, Tiranë.
- PRIFTI, Stefan (1966), “Elipsa në sintaksën shqipe”, *Studime Filologjike*, Tiranë, nr. 1.
- SHUTERIQI, Dhimitër, (1973), *Nëpër shekujt letrarë*, NAIM FRASHËRI, Tiranë.
- THOMAI, Jani (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, TOENA, Tiranë.
- XHAXHIU, Myzafer, (1981), “Shkrimtarë, vepra dhe dukuri letrare”, *A. Z. Çajupi-poet i shquar dhe mendimtar i Rilindjes sonë kombëtare*, Tiranë.

**Si përfundim**, theksojmë se Çajupi ligjërimin e tij poetik e jo vetëm, e përcolli te lexuesi shqiptar përmes një shqipeje të pastër e të pasur. Ai mban larg gjuhës së tij fjalët e huaja dhe ndërtimet e ndërlukuara të vargut. *Me fjalët si mjaltë* të kësaj gjuhe, Çajupi monumentalizoi në vargje dashurinë për atdhenë, heroizmin, nderin, besnikërinë, trimërinë e mbi të gjitha dashurinë njerëzore për t’ia transmetuar brezave si vlerë kombëtare. Ai e pasuroi këtë gjuhë me mjete shprehëse, lëvdoi shqip, urreu e shau po shqip, gjithmonë origjinal në shprehje e kuptime. Në fund të fundit, kjo ishte ajo çfarë ka dashur dhe synuar Çajupi përmes veprës së tij, kur shprehej: “...*të formojmë gjuhën tonë, ta përsosim, ta shkruajmë, ta flasim që të oshëtijë.*” (Shuteriqi 1973: 390).